

PËR MËSUESIN/EN

duk gjini
shtëpia botuese publishing house

**Njomza Lila-Babuni, Katarina Gojani,
Majlinda Haxhikadrija-Ramadani,
Valdete Gjakova**

NJERIU DHE NATYRA

Për klasën e tretë të arsimit fillor

3



PËRMBAJTJA

Udhërrëfyes.....	6
Hyrje.....	8
Planifikimi vjetor.....	17
Plani dymujor: shtator—tetor.....	18
Plani dymujor: nëntor—dhjetor.....	21
Plani tremujor: janar—shkurt—mars.....	25
Plani tremujor: prill—maj—qershor.....	29
Mësimi 1: Materialet dhe lëndët e para.....	34
Mësimi 2: Materialet dhe lëndët e para - fletore pune.....	36
Mësimi 3: Lëndët e pastra dhe lëndët e përziera.....	38
Mësimi 4: Lëndët e pastra dhe lëndët e përziera - fletore pune.....	40
Mësimi 5: Klasifikimi i materialeve.....	42
Mësimi 6: Klasifikimi i materialeve - fletore pune.....	44
Mësimi 7: Gjendjet agregate të ujit.....	46
Mësimi 8: Gjendjet agregate të ujit - fletore pune.....	48
Mësimi 9: Cikli i ujit në natyrë.....	50
Mësimi 10: Cikli i ujit në natyrë - fletore pune.....	52
Mësimi 11: Uji dhe rëndësia e tij për organizmin e njeriut.....	54
Mësimi 12: Uji dhe rëndësia e tij për organizmin e njeriut - fletore pune.....	56
Mësimi 13: Temperatura.....	58
Mësimi 14: Temperatura - fletore pune.....	60
Mësimi 15: Përbërësit e ajrit dhe roli i oksigjenit në frymëmarrje.....	62
Mësimi 16: Përbërësit e ajrit dhe roli i oksigjenit në frymëmarrje - fletore pune.....	64
Mësimi 17: Ushqimi si burim i energjisë.....	66
Mësimi 18: Ushqimi si burim i energjisë - fletore pune.....	68
Mësimi 19: Përbërësit kryesorë të ushqimit.....	70
Mësimi 20: Përbërësit kryesorë të ushqimit - fletore pune.....	72
Mësimi 21: Prejardhja e ushqimit.....	74
Mësimi 22: Prejardhja e ushqimit - fletore pune.....	76
Mësimi 23: Ushqimi i shëndetshëm.....	78
Mësimi 24: Ushqimi i shëndetshëm - fletore pune.....	80
Mësimi 25: Piramida e ushqimit të njeriut.....	82
Mësimi 26: Piramida e ushqimit të njeriut - fletore pune.....	84
Mësimi 27: Ruajtja e ushqimit.....	86
Mësimi 28: Ruajtja e ushqimit - fletore pune.....	88
Mësimi 29: Efektet e lëndëve të dëmshme për organizmin.....	90
Mësimi 30: Efektet e lëndëve të dëmshme për organizmin - fletore pune.....	92
Mësimi 31: Higjiena dhe prodhimet higjienike.....	94
Mësimi 32: Higjiena dhe prodhimet higjienike - fletore pune.....	96
Mësimi 33: Ndërveprimet e organizmave të gjallë me mjedisin.....	98
Mësimi 34: Zinxhirët ushqimorë në ekosistem.....	100
Mësimi 35: Zinxhirët ushqimorë në ekosistem - fletore pune.....	102
Mësimi 36: Piramida ekologjike.....	104
Mësimi 37: Bimët dhe nevojat e tyre.....	106
Mësimi 38: Kafshët dhe nevojat e tyre.....	108
Mësimi 39: Nevojat e bimëve dhe të kafshëve - fletore pune.....	110

Mësimi 40: Familja.....	112
Mësimi 41: Emocionet, dëshirat dhe nevojat e anëtarëve të familjes.....	114
Mësimi 42: Emocionet, dëshirat dhe nevojat e anëtarëve të familjes - fletore pune.....	116
Mësimi 43: Fërkimi.....	118
Mësimi 44: Fërkimet mes trupave me gjendje të ndryshme agregate.....	120
Mësimi 45: Fërkimet e dobishme dhe të dëmshme.....	122
Mësimi 46: Fërkimet e dobishme dhe të dëmshme - fletore pune.....	124
Mësimi 47: Elektrizimi i trupave përmes fërkimit.....	126
Mësimi 48: Elektrizimi i trupave përmes fërkimit - fletore pune.....	128
Mësimi 49: Shtypja e trupit mbi sipërfaqe.....	130
Mësimi 50: Elektriciteti, magneti dhe magnetizmi.....	132
Mësimi 51: Elektriciteti, magneti dhe magnetizmi - fletore pune.....	134
Mësimi 52: Bashkëveprimi i trupave në lëvizje dhe në qetësi.....	136
Mësimi 53: Bymimi dhe tkurrja.....	138
Mësimi 54: Bymimi dhe tkurrja - fletore pune.....	140
Mësimi 55: Përhapja e zërit.....	142
Mësimi 56: Burimet e dritës.....	144
Mësimi 57: Përhapja e zërit - fletore pune.....	146
Mësimi 58: Llozi dhe përdorimi i tij.....	148
Mësimi 59: Përdorimi i makinave të thjeshta.....	150
Mësimi 60: Përdorimi i makinave të thjeshta - fletore pune.....	152
Mësimi 61: Planetët në Sistemin Diellor.....	154
Mësimi 62: Planetët në Sistemin Diellor - fletore pune.....	156
Mësimi 63: Toka dhe Hëna.....	158
Mësimi 64: Toka dhe Hëna - fletore pune.....	160
Mësimi 65: Harta, globi dhe plani.....	162
Mësimi 66: Harta, globi dhe plani - fletore pune.....	164
Mësimi 67: Format e relievit.....	166
Mësimi 68: Format e relievit - fletore pune.....	168
Mësimi 69: Ruajtja e mjedisit.....	170
Mësimi 70: Ajri dhe ndotja e tij.....	172
Mësimi 71: Ruajtja e mjedisit dhe e ajrit - fletore pune.....	174
Mësimi 72: Ndotja e ujit.....	176
Mësimi 73: Toka dhe ndotja e saj.....	178
Mësimi 74: Ndotja e tokës dhe e ujit - fletore pune.....	180

Të dashur mësues dhe mësuese,

Në duar keni librin tuaj, i hartuar për t'ju ardhur në ndihmë për zhvillimin e mësimit, mbështetur në metodologjitë më të përparuara bashkëkohore.

Sistemi arsimor në Kosovë ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme dhe në shkolla janë përdorur metoda tradicionale të mësimdhënies. Sot kemi mundësinë që arsimit t'i pajisë nxënësit me kompetencat që u nevojiten, për ta formësuar jetën e tyre dhe për të kontribuar në shoqëri. Për ta gjetur mënyrën më të mirë dhe për ta realizuar këtë synim, shtëpia botuese "Dukagjini" ka nisur projektin për përfshirjen e metodologjive të mësimdhënies ndërvepruese në librat e mësuesve, i cili ka për qëllim t'ju ndihmojë të gjeni përgjigje për pyetjen themelore: "Çfarë metodologjie do të përdorni për të ndërtuar e krijuar dije, shkathtësi, qëndrime dhe vlera që do t'u nevojiten nxënësve të Kosovës për ta formësuar të ardhmen e tyre?"

Integrimi në hapësirën arsimore të shekullit të 21-të kërkon, midis të tjerash, modernizimin e metodave ekzistuese të mësimdhënies dhe të të nxënësve, futjen e veprimtarive bashkëkohore në mësim, që mundësojnë përgatitjen e një individi aktiv, të pavarur dhe të lirë, të pajisur me shprehje të menduarit kritik, krijues, komunikues dhe bashkëpunues, i aftë për t'i përmbushur kërkesat e shoqërisë së sotme.


Cilësia e re e të nxënësve dhe mësimdhënies përbën përparësi absolute për arsimin. Ju nuk jeni vetëm burime informacioni, por lipset të përdorni metoda dinamike të mësimdhënies, të quajtura edhe metoda mësimore ndërvepruese, të cilat përbëjnë elementet bazë të këtij modeli, për t'i motivuar nxënësit që të angazhohen më shumë në mësim.

Modeli i këtyre librave po përdoret për herë të parë në Kosovë dhe mësimit janë hartuar nga kolegët tuaj, me profesionalizëm, përkushtim dhe përgjegjësi maksimale.

UDHËRRËFYES për konceptimin e mësimëve model

Faqja në të majtë

- Këto janë të dhëna identifikuese, të cilat orientojnë për mësimin.
- Mësimi synon që, përmes rezultateve të të nxënësit, të kontribuojë në një ose disa prej kompetencave.
- Rezultatet specifike janë në koherencë me ato të fushës.
- Të gjitha mjetet dhe materialit që ndihmojnë në konkretizim.
- Parashikimi, faza e parë e orës mësimore, e cila siguron përqendrimin dhe aktivizimin e nxënësve në mësim.



- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit ndihmon mësuesin/en.
- Rezultatet e të nxënëtit të temës janë në koherencë me ato orës mësimore, tema është më e gjerë.
- Rezultatet specifike të të nxënëtit janë ato mbi të cilat ndërtohet mësimi.
- Janë zërthim i rezultateve të të nxënëtit sipas niveleve të arritjes. Përcaktohen me nxënësit në klasë.
- Zakonisht mësimi ka lidhje me lëndë dhe fusha të tjera, të cilat evidentohen.

Faqja në të djathtë

- Paraqitja e faqes së librit të nxënësit, ndihmon mësuesin/en, gjatë përgatitjes.
- Vlerësimi formues në raport me rezultatet e të nxënëtit.
- Vetëreflektim dhe vetëvlerësim për orën mësimore në raport me arrijten e rezultateve të nxënësve.



- Përpunimi i përmbajtjes, faza e dytë e orës mësimore, e cila bën përzgjedhjen e materialit mësimor dhe organizimin metodologjik të tij.
- Përforcimi, faza e tretë e orës mësimore, e cila bën integrimin e dijeve dhe të shprehive dhe zbatimit të tyre.

Përshkrim i rubrikave kryesore të orës së mësimit

Rezultatet e të nxënëtit të temës: Janë hartuar mbi bazën e koncepteve të përgjithshme, të cilat janë pika referuese në përzgjedhjen e përmbajtjeve mësimore për lëndën dhe rezultateve të të nxënëtit për këtë temë. Në këtë rast mund të merren nga tabela e krahasimit të planeve dhe programeve ekzistuese me Kurrikulën Bërthamë, por edhe mund të hartohen vetë, mund të jenë një, dy a më shumë rezultate. Një rezultat i të nxënëtit të lëndës mësimore mund të shërbejë për një apo më shumë njësi mësimore - kjo varet nga përshkrimi i rezultatit të të nxënëtit dhe nga elementet përbërëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: Filluar nga klasa e tretë e më lart, zotërojnë operacionet mendore, të menduarit e tyre është konkret me elemente të të menduarit abstrakt, prandaj mësimi me këta nxënës kalon në tri faza dhe të të menduarit të nxënësve sipas proceseve njohëse. Zhvillimi i kompetencave, përkatësisht në rezultatet e tyre, bëhet përmes fushës kurrikulare, e cila kontribuon në arritjen e rezultateve të kompetencave. Të gjitha kompetencat kryesore të kurrikulës zërthehen në rezultate të të nxënësve. Ato janë pjesë e Kurrikulës Bërthamë dhe parashihen të përvetësohen nga nxënësit, me rastin e përfundimit të shkallës së kurrikulës.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: Shprehin kërkesat thelbësore të arritjes në fushën kurrikulare, drejt zotërimit të kompetencave kryesore, në përfundim të shkallës. Ato përshkruajnë atë se çfarë duhet të dijë, të besojë, të vlerësojë dhe të jetë i aftë për të bërë nxënësi në fund të shkallës a nivelit dhe shprehin një varg domenesh, duke përfshirë: njohuritë, shkathtësitë, qëndrimet dhe vlerat. Vendosen rezultatet e të nxënësve të fushës kurrikulare, vetëm ato që reflektohen në temën mësimore.

Rezultatet e të nxënësve: Rezultatet specifike të të nxënësve janë ato mbi të cilat ndërtohet ora e mësimin, të cilat përbëjnë detajimin e rezultateve të të nxënësve të temës, të cilat janë në koherencë me ato të fushës së kurrikulës.

Kriteret e vlerësimit/suksesit: Janë zërthim i rezultateve të të nxënësve sipas niveleve të arritjes dhe sigurojnë vlerësim të drejtë për shkallën e zotërimit. Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Metodologjia dhe veprimtaritë me nxënësit - hapat e zhvillimit të mësimin: Mësimi zhvillohet përmes hapave, duke nxitur të menduarit logjik e kritik të nxënësve, duke pasur parasysh fazat e zhvillimit sipas Piazhesë.

Çfarë simbolizon modeli me tri pamje të ndryshme të ciklit të jetës së bimës së grurit në tri fazat e mësimin?

Mbillet një farë në një truall pjellor. Pasi është bërë puna themelore e fillimit, mësuesi/ja vazhdon dhe fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Cikli i jetës së grurit, nga fara në tokë, në bimë, e prapë në farë, sugjeron, gjithashtu, ciklin e vazhdueshëm të shkollimit, përmes mbështetjes në njohuritë ekzistuese, për të ecur më tej përpara.



Parashikimi: Përgatitja për të nxënësve

Në fazën e parashikimit mbillet një farë në një truall pjellor. Mësimi duhet të mbështetet edhe në njohuritë ekzistuese të nxënësve, ashtu si fara merr ushqim nga trualli ku është mbjellë.

Kjo është faza e parë e strukturës për zhvillimin e të menduarit dhe të nxënësve, kryhen veprimtari të ndryshme njohëse, nxënësi është i përfshirë gjallërisht në rikujtimin e asaj çka di rreth temës së mësimin, bën lidhjen e njohurive të reja me ato që dihen. Nxënësit ndërtojnë njohuritë, konceptet, kuptimin e ri mbi dukuritë e caktuara nga bazat e njohurive të mëparshme.



Ndërtimi i njohurive: Përpunimi i përmbajtjes

Mësimi vazhdon me fazën e ndërtimit të njohurive; fara e grurit lëshon rrënjë dhe bima rritet. Kjo është faza e dytë e strukturës për zhvillimin e të menduarit të nivelit të lartë gjatë të nxënësve dhe nxënësi është i përfshirë në procesin e përfundimit të kuptimit të njohurive, gjithashtu ruan interesin dhe ritmin e vendosur gjatë fazës së parashikimit.



Përforcimi: Konsolidimi i të nxënësve

Mësimi përfundon me fazën e përforcimit. Kalliri i grurit është pjekur dhe përmban fara për shumë bimë të tjera; po kështu, edhe mësimi mund të çojë në shumë veprimtari të tjera. Në këtë fazë, nxënësit konsolidojnë të nxënësve e ri dhe, në mënyrë të gjallë, ristrukturojnë skemën e tyre për të përshtatur konceptet e reja dhe për t'i zbatuar ato.

HYRJE

Konceptimi dhe ndërtimi i librit për mësuesin

NJERIU DHE NATYRA 3

Përderisa përgatitja për jetë dhe për punë theksohet në tërë kurrikulën si një çështje e rëndësishme, fusha e kurrikulës “Shkencat e natyrës” synon të kontribuojë veçanërisht si një fushë “mbartëse” në zhvillimin e kompetencave për jetë dhe për punë. Në shkallët 1 dhe 2 të kurrikulës, ajo përqendrohet në shkathtësitë për jetë, krahas shkathtësive që kanë të bëjnë me artizanatet dhe amvisërinë. Përmes kësaj fushe të kurrikulës, nxënësit do të njihen me rolet e ndryshme të individëve në jetë dhe në punë, si: anëtarët e familjes, qytetarët, prodhuesit, konsumuesit, punëdhënësit dhe punëmarrësit. Nxënësit do të zhvillojnë vetëdijësimin dhe vetëbesimin, duke qenë po ashtu të vetëdijshëm për ekzistimin e të tjerëve dhe nevojës për t’u mbështetur në marrëdhënie ndërpersonale në jetë dhe në punë për sa i përket tolerancës dhe respektit të ndërsjellë. Ata do të zhvillojnë shpirtin për iniciativë dhe përgjegjshmëri; të hartojnë dhe të respektojnë planet e punës dhe afatet kohore, si dhe të njihen me cilësinë e proceseve dhe të rezultateve të tyre.


Udhëzime metodologjike

Për realizimin e përmbajtjeve që përcaktohen në fushën kurrikulare “Shkencat e natyrës”, mund të përdoren metodat e ndryshme të punës, me qëllim të përmbushjes së kërkesave që ka kjo fushë, por edhe për shkak të specifikave që bart në vete. Disa prej metodave që e lehtësojnë zhvillimin e suksesshëm janë metodat e mësimdhënies që në qendër kanë nxënësin.

Metodologjia ndërvepruese në mësimdhënie dhe të nxënëtit

Ky libër është hartuar për t’ju pajisur me metodologjinë ndërvepruese në ndërtimin e dijeve dhe formimin e shkathtësive. Ai i trajton temat mësimore në përputhje me “Kurrikulën bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor të Kosovës” (2016), si edhe të gjitha dokumentet dhe udhëzimet administrative në fuqi, ku është mbështetur metodologjia me të gjitha elementet përbërëse, duke filluar me kontributin në kompetencat kryesore dhe rezultatet e të nxënëtit të fushës, rezultatet specifike të të nxënëtit të njësisë mësimore, mjetet e punës, ecuria metodologjike e orës së mësimi e deri te vlerësimi i nxënësve. Një nga risitë e këtij libri është se përmban edhe një rubrikë: *Reflektim për rrjedhën e orës mësimore*. Qëllimi i kësaj rubrike është që t’ju ndihmojë të mbani shënime për punën tuaj në klasë, arritjet, por edhe mossuksesin, dhe më pas të reflektoni kur të bëni përsëritje, të kontrolloni dijet dhe të bëni vlerësimin e nxënësve, por edhe kur të zhvilloni mësimin një vit apo disa vjet më pas.

Në aspektin metodologjik të hartimit të modeleve orientuese për çdo orë mësimi, është treguar kujdes i veçantë në harmonizimin e të gjitha veprimtarive. Marrëdhëniet midis rezultateve të të nxënëtit - procedurave të mësimdhënies dhe të nxënëtit - vlerësimit, përbëjnë atë që në metodologjinë e sotme quhet “trekëndësh magjik”. Ky trekëndësh paraqet marrëdhënien koherente midis rezultateve të të nxënëtit, veprimtaritë e mësimdhënies/të nxënëtit dhe vlerësimit. Këta tre komponentë janë në koherencë me njëri-tjetrin, me qëllim që nxënësit të inkurajohen për të mësuar, të jenë pjesëmarrës aktivë në ndërtimin e dijes dhe të shkathtësive.



Burimi: *Metodologji e mësimdhënies*, (faqe 102), B. Musai, 2014. Botuar në Tiranë: CDE


Zgjeroni dhe thelloni dijet
 Për më shumë lexoni në: Musai, B. (2014) *Metodologji e mësimdhënies*. Tiranë: CDE, faqe 101-128.

Metodologjia e çdo teme zhvillohet në mënyrë pamore rreth mësimit të librit të nxënësit, e cila ju ndihmon ta shikoni atë pa pasur nevojën që ta kenë pranë. Përdorimi i kësaj mënyre të paraqitjes metodologjike të mësimit ka dhënë rezultate mjaft të mira.

Metodologjia ndërvepruese ka si qëllim përfshirjen aktive të nxënësve në ndërtimin e dijes dhe formimin e shprehive. Zhvillimi i nxënësve që mendojnë në mënyrë kritike e që janë krijuar është në qendër të metodave të mësimdhënies, të mënyrave të të nxënit e të çdo veprimtarie tjetër, me synim zhvillimin e shprehive të të menduarit të nivelit të lartë. Por, nga ana tjetër, jemi mbështetur edhe në parimet e psikologjisë së edukimit, kryesisht të zhvillimit njohës sipas moshave, me konsideratë të veçantë Zonën e zhvillimit proksimal të Vigotskit, e cila është zona midis nivelit aktual të zhvillimit të fëmijës sipas përcaktimit të aftësive për zgjidhjen e pavarur të problemeve dhe nivelit të zhvillimit që fëmija është në gjendje të arrijë, përmes orientimit të të rriturve apo në bashkëpunim me bashkëmoshtarët e tij më të aftë. Kjo është një hapësirë dinamike ku mësimdhënia mund të japë rezultate e ndodhet diku midis asaj që nxënësi di dhe asaj që nxënësi nuk është gati të mësojë. Zona e zhvillimit proksimal është hapësira e mësimit midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi apo nga një bashkëmoshtar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.

Zgjeroni dhe thelloni dijet
 Për më shumë lexoni në: Woolfolk, A. (2011) *Psikologji edukimi*. Tiranë: CDE, faqe 47-51.

hapësira e mësimit midis së mërzitshmes dhe së pamundurës. Në këtë hapësirë, mbështetja nga mësuesi apo nga një bashkëmoshtar mund të bëjë që mësimi të japë rezultate.



Burimi: *Psikologji edukimi*, (faqe 47), A. Woolfolk, 2011. Botuar në Tiranë: CDE



Zgjeroni dhe thelloni dijet

Për më shumë lexoni në: Woolfolk. A. (2011) Psikologji edukimi. Tiranë: CDE, faqe 32-36.

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës 2

I Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv	
1.	Lexon me zë drejt një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.
2.	Shkruan një tekst deri në një faqe (500 fjalë) e më shumë për një temë të caktuar.
3.	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
4.	Shpreh qëndrimin për ngjarjen apo për performancën dhe emocionet e veta që i ka përjetuar gjatë shikimit të një filmi, të një dokumentari të përshtatshëm për moshën e vet, gjatë leximit të një libri, një interpretimi muzikor, një ekspozite, një recitimi apo dramatizimi, në njërën nga format shprehëse, si: me të folur, me shkrim, me vizatim, me mimikë, me lëvizje etj.
5.	Merr pjesë në organizimin e një shfaqjeje artistike në harmoni me moshën e vet, duke përdorur forma të ndryshme të të shprehurit.
6.	Identifikon personazhet kryesore të një tregimi, drame, filmi, kënge apo ndonjë ngjarjeje nga jeta, bën dallimin e tyre duke bërë një listë me vetitë që i pëlqejnë dhe që nuk i pëlqejnë tek ata, diskuton rreth tyre, performon rolin e njërit prej personazheve në bashkëveprim me moshatarë.
7.	Shpreh, në formë verbale dhe të shkruar, fjali të thjeshta në gjuhë të huaj dhe përkthen në gjuhë amtare fjali të tjera të thjeshta që i dëgjon nga mjetet auditive, audiovizuale apo nga mësuesi/ja në gjuhë të huaj të dhëna si detyrë.
8.	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta, duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

II. Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ	
1.	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse.
2.	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera).
3.	Paraqet për diskutim argumentet për pajtueshmërinë ose kundërshtimin për një mendim e qëndrim të shprehur apo sjellje të manifestuar nga një apo më shumë persona (në klasë/shkollë apo jashtë saj).
4.	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.
5.	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.
6.	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, historiko-shoqërore) në njërën nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.
7.	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.
8.	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

III. Kompetenca e të nxënës – Nxënës i suksesshëm	
1.	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.
2.	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.
3.	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuara, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme).
4.	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.
5.	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar.
6.	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.
7.	Identifikon cilësitë e veta që i posedon dhe cilësitë e nevojshme që duhet t'i zhvillojë për të nxënë një detyrë apo aktivitetet të caktuara dhe për të bashkëpunuar me të tjerët.
8.	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.
9.	Përdor dhe zbaton në mënyrë efektive informatën/njohurinë për zgjidhjen e një problemi/detyre të caktuar përmes shfrytëzimit të TIK-ut apo teknologjisë tjetër, prezanton përvojën e vet para të tjerëve për 6-10 minuta.

IV. Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv	
1.	Përgatit një autobiografi në të cilën prezanton veten me të dhënat personale dhe me prirjet për fusha të caktuara, duke i gjetur të përbashkëta me profesionet e dëshiruara.
2.	Përgatit një plan pune për një javë dhe specifikon aktivitetet më me prioritet, duke arsyetuar përzgjedhjen e tyre.
3.	Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupon atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen/kryerjen e tyre etj.
4.	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.
5.	Debaton me moshatarë për mënyrën e sjelljes së nxënësve në klasë/laborator, në shkollë dhe në mjedise të tjera apo për një grup të caktuar njerëzish për një situatë të caktuar, duke mbrojtur idetë e veta me shembuj konkretë.
6.	Identifikon ushqimet më të shpeshta, materialet e tjera shpenzuese të familjes apo harxhimet vetjake dhe llogarit shpenzimet për një javë, të dhënat e gjetura i paraqet në formë tabelare/grafike apo në një formë tjetër.
7.	Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimi të drejtë.
8.	Paraqet në formë tabelare, grafike, të vizatimit apo në një formë tjetër, aktivitetet e kujdesit që i bën ndonjë qenieje të gjallë, të cilat i mundësojnë zhvillimin, rritjen apo ruajtjen e shëndetit të tij/saj.

V. Kompetenca personale – Individ i shëndoshë	
1.	Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit, ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes.
2.	Merr pjesë në aktivitete fizike, lojëra lëvizore dhe në lojëra sportive, bën përpjekje për arritjen e standardeve të përcaktuara, luan fer, menaxhon emocionet e veta dhe prezanton para të tjerëve gjendjen fizike dhe shpirtërore pas realizimit të një aktiviteti fizik apo loje sportive.
3.	Përgatit një listë (me njërën nga format e shprehjes, shkrim, vizatim etj.) me ushqimet që i konsumon familja, duke i renditur ato sipas kalorisë dhe më pas i klasifikon në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme.
4.	Lexon të dhënat në paketim të ushqimit dhe diskuton në grup për këto të dhëna (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj.).
5.	Identifikon përparësitë dhe mangësitë e personalitetit të vet dhe jep mendime për mënyrën e përmirësimit, në forma të ndryshme shprehëse.
6.	Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konflikti ndërpersonal duke i analizuar paraprakisht me kujdes rrethanat që kanë shkaktuar konfliktin, ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit.
7.	Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.
8.	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkollë apo jashtë saj).
9.	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtja e rregullt e sendeve që e rrethojnë etj.).

VI Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm	
1.	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni.
2.	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
3.	Propozon vlera shoqërore, që janë të rëndësishme të kultivohen në klasë, në shkollë apo në familje (si p.sh., besimi i ndërsjellë, toleranca, solidariteti, respekti, mirësjellja etj.) dhe me shembull konkret përshkruan ndonjë situatë ku gjen shprehje ndonjëra nga ato.
4.	Manifeston veprime që shprehin mirësjellje në situata të ndryshme dhe me shembull konkret tregon përdorimin e tyre në klasë/shkollë, në familje e në komunitet.
5.	Propozon dhe ndan mendimin me shokët/shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.
6.	Merr pjesë në hartimin e rregullave të lojës, në klasë, në shkollë (p.sh., si propozues rregullash, menaxhues i propozimeve nga të tjerët etj.) dhe argumenton rëndësinë e respektimit të ndonjërit rregull të propozuar në forma të ndryshme të shprehjes, duke parashikuar pasojat e moszbatimit të saj.
7.	Identifikon dy e me shumë organizime shoqërore dhe përshkruan (në formë të shkruar apo në ndonjë formë tjetër) mënyrat/mundësitë se si njerëzit e ndryshëm me përvoja të ndryshme mund të organizojnë diçka të përbashkët.
8.	Prezanton në mënyrë kronologjike ndryshimet e familjes dhe të rrethit në aspekte të ndryshme (si: objektet e banimit, festat, veshjet, ushqimet, mënyrat e të ushqyerit, menaxhimi i ekonomisë familjare, të drejtat, përgjegjësitë dhe vendimmarrja në familje etj.) ose disa nga personalitetet dhe ngjarjet kryesore të popullit të vet, duke e dalluar të tashmen nga e kaluara.
9.	Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhen manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

REZULTATET E TË NXËNIT TË FUSHËS SHKENCAT E NATYRËS - Shkalla 2

I. NJOHURITË, TË KUPTUARIT, SHKATHTËSITË që zhvillohen	
1. Ushtrimi i punës praktike në shtëpi, në shkollë dhe në komunitet Nxënësi/ja:	
1.	Përshkruan ndryshimet ndërmjet aktiviteteve që bëhen individualisht dhe në grup,
2.	Ndërmerr aktivitete praktike bazuar në vetiniciativë dhe në qasje të pavarura për të finalizuar produkte të ndryshme punëdoreje, duke u nisur nga një model i dhënë, fotografi a vizatim.
2. Ngritja e cilësive personale për jetë dhe punë	
Nxënësi/ja:	
1.	Demonstron gatishmëri dhe vetiniciativë për pjesëmarrje dhe organizime të aktiviteteve të ndryshme grupore në shkollë dhe në komunitet, duke respektuar rregullat e ndërveprimit dhe të punës në grup.
3. Përdorimi i teknologjisë për jetën dhe punën e përditshme	
Nxënësi/ja:	
1.	Përdor vegla dhe pajisje shtëpiake në situata të përditshmërisë.
2.	Përdor veglat, mjetet dhe materialet adekuate për të punuar prodhime të thjeshta bazuar në udhëzimet e mësuesit/es.
4. Përdorimi i TIK-ut për të avancuar nxënien dhe cilësinë e jetës së përditshme	
Nxënësi/ja:	
1.	Përdor kompjuterin personal për të reflektuar ide dhe krijimtari fillestare.
2.	Përdor i sigurt TIK-un për të krijuar projekte të ndryshme, planifikim të aktiviteteve, krijim të detyrave, hulumtim dhe zhvillim të shkathhtësive praktike.
5. Ushtrimi i zhvillimit të ndërmarrësisë dhe planit të biznesit	
Nxënësi/ja:	
1.	Drejtëpërdrejt hulumton dhe përfshihet në aktivitete të ekonomisë familjare dhe ushtron përgjegjësi elementare organizative-buxhetore.
6. Promovimi i kushteve të sigurta për jetë dhe për punë	
Nxënësi/ja:	
1.	Përshkruan rregullat për mbrojtje dhe siguri, nga rreziqet në jetën e përditshme: në shtëpi, në shkollë dhe në mjedis.

7. Përgatitja për jetën profesionale dhe karrierën e ardhshme

Nxënësi/ja:

1. Demonstron përmes veprimeve të veta nevojën për marrjen e përgjegjësisë, ndarjen e aktiviteteve që zhvillohen në shtëpi, shkollë dhe komunitet.

8. Komunikimi në/për jetë dhe punë

Nxënësi/ja:

1. Është i vetëdijshëm për ekzistimin e diversitetit individual në klasë, në shkollë dhe në jetë për të përmirësuar të kuptuarit, dëshirat dhe aspiratat e të tjerëve, duke menaxhuar situatat dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë konstruktive dhe paqësore.

9. Edukimi për zhvillim të qëndrueshëm - mbrojtja dhe ruajtja e natyrës dhe e mjedisit

Nxënësi/ja:

1. Përpunon materiale ricikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtëse për ruajtjen e mjedisit.
2. Zhvillon njohuri dhe shkathtësi për shoqërinë, mbrojtjen e mjedisit, ekonominë familjare dhe përdorimin e TIK-ut.

II. QËNDRIMET DHE VLERAT që zhvillohen

- Toleranca;
- Respektimi i diversitetit;
- Përkushtimi;
- Qëndrim pozitiv;
- Bashkëpunimi;
- Respektimi i kodit të mirësjelljes;
- Respektimi rregullor;
- Gatishmëria;
- Siguria;
- Pavarësia në mendime dhe në veprime;
- Iniciativa dhe interesi për qasje të ndryshme;
- Besimi në përdorimin e TIK-ut;
- Formimi human dhe zhvillimi i personalitetit;
- Gatishmëria për bashkëpunim.

III. AFTËSITË DHE SHKATHTËSITË që zhvillohen

- Njeh veten dhe të tjerët;
- Tregon për veten, për familjen dhe për mjedisin;
- Identifikon rreziqet e ndryshme;
- Kupton ndikimin e veprimeve pozitive dhe negative;
- Shkëmben përvojat;
- Demonstron sjellje, veprime, shprehje;
- Praktikton ushtrime;
- Ndërton bashkëpunim;
- Shfaq vendosmëri.

**Planifikimi vjetor i temave mësimore për fushën e kurrikulës: Shkencat e natyrës
- Klasa III**

TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE						
Lëndët e fushës kurrikulare	Gjysmëvjetori i parë		Gjysmëvjetori i dytë		Rezultatet e kompetencave (Rezultatet e të nxënit për shkallë)	
	PERIUDHA I		PERIUDHA II	PERIUDHA III		
	shtator—tetor	nëntor—dhjetor	janar—shkurt—mars	prill—maj—qershor		
NJERIU DHE NATYRA	Lëndët dhe vetitë e tyre	Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale	Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale	Bashkëveprimi i trupave	I	Komunikues efektiv I-1, 3, 8
		Ndërveprimet e organizmave të gjallë	Edukimi seksual	Vendi dhe hapësira	II	Mendimtar kreativ II-1, 2, 4, 5, 6, 7, 8
			Fërkimi dhe shtypja	Sistemet fizike	III	Nxënës i suksesshëm III-1, 2, 3, 4, 5, 6, 8
			Bashkëveprimi i trupave	Bashkëveprimi i njeriut me natyrën	IV	Kontribues produktiv IV-3, 4, 6, 7
					V	Individ i shëndoshë V-1, 3, 4, 6, 7, 8, 9
					VI	Qytetar i përgjegjshëm VI-1, 2, 4, 8
	Gjithsej 18 orë	Gjithsej 17 orë	Gjithsej 21 orë	Gjithsej 18 orë		

PLANI DYMUJOR: SHTATOR—TETOR

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: III

Temat mësimore: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv*

I.1	Lexon me zë një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës nga format shprehëse;
II.4	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkencat e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme;
II.5	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.
II.6	Përkrah dukuritë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërin nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie;
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore, të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitive në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimet) të tyre.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj.
III.5	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar;
III.8	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.4	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.
-------------	---

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në klasë, në shkollë apo jashtë saj).
------------	--

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
VI.4	Propozon dhe ndan mendimin me shokët a shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.1	Identifikon dhe hulumton materialet natyrore dhe artificiale që përdoren në jetën e përditshme sipas vetive dhe shndërtimeve të tyre;
1.4	Mat me instrumente përkatëse dhe sqaron ndërrimin e temperaturës gjatë ditës, natës, stinëve të vitit dhe gjendjen agregate të lëndëve;
1.5	Përshkruan bashkëveprimin e trupave, të lëndëve dhe të qenieve të gjalla;
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij dhe ndërlidhjen mes tyre;
2.3	Kryen vëzhgime sistematike dhe mban shënime gjatë matjeve me njësi standarde përmes pajisjeve (veglave) të ofruara nga mësuesi/ja.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Lëndët dhe vetitë e tyre</p> <ul style="list-style-type: none"> - Tregon për nocionet materiale, lëndët e para, lëndët e pastra dhe lëndët e përziera; - Dallon lëndët në bazë të gjendjeve agregate, në bazë të origjinës dhe nga përbërja; Përkrahuan tri gjendjet agregate të ujit; - Kupton gjendjet agregate të ujit; Kupton gjendjen e gaztë të ujit përmes ciklit në natyrë; - Përmend rolin e ujit të pijshëm për organizmin e njeriut; - Përkrahuan matjen e temperaturës me termometër; - Tregon për përbërësit kryesorë të ajrit dhe për rolin e oksigjenit në frymëmarrje. 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Materialet dhe lëndët e para 2. Materialet dhe lëndët e para - fletore pune 3. Lëndët e pastra dhe lëndët e përziera 4. Lëndët e pastra dhe lëndët e përziera - fletore pune 5. Klasifikimi i materialeve 6. Klasifikimi i materialeve - fletore pune 7. Gjendjet agregate të ujit 8. Gjendjet agregate të ujit - fletore pune 9. Cikli i ujit në natyrë 10. Cikli i ujit në natyrë - fletore pune 11. Uji dhe rëndësia e tij për organizmin e njeriut 12. Uji dhe rëndësia e tij për organizmin e njeriut - fletore pune 13. Temperatura 14. Temperatura - fletore pune 15. Përbërësit e ajrit dhe roli i oksigjenit në frymëmarrje 16. Përbërësit e ajrit dhe roli i oksigjenit në frymëmarrje - fletore pune 17. Ushqimi si burim i energjisë 18. Ushqimi si burim i energjisë - fletore pune 	18	<ul style="list-style-type: none"> - Organizuesi grafik - Stuhi mendimesh - Pyetja sjell pyetjen - Tabela e koncepteve - Imagjinatë e drejtuar - RAFT - DI - DUA TË DI - MËSOVA - Ruaje fjalën e fundit për mua - Rrjeti i diskutimit - Diagrami i Venit - Kubimi - Parashikim me terma paraprakë - Shqyrtim i përbashkët - Shënime mbi shënime - Lexim i drejtuar - Ditaret e të nxënit - Rishikim në dyshe - Të nxënësit me këmbime - Shpjegimi i përparuar 	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja në veprimtari - Listë e kontrollit - Semafori - Informata kthyesë - Vlerësimi i ndërsjellë - Dy yje, një dëshirë - Vëzhgimi - Kontrolli para fluturimit - Test 	<p>Gjuhë amtare Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti Shkathtësi për jetë Edukatë figurative Çështje ndërkurrikulare Arsimi për zhvillimin e qëndrueshmërisë Edukim për paqe Globalizimi dhe ndërmarrësia</p>	<p>“Njeriu dhe natyra 3” “Njeriu dhe natyra 3 - fletore pune” Enciklopedi Atlase Burime nga interneti (Filma, dokumentarë, videoeksperimente)</p>	

PLANI DYMUJOR: NËNTOR—DHJETOR

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: III

Temat mësimore: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale
Ndërveprimet e organizmave të gjallë

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv*

I.1	Lexon me zë një tekst letrar apo joletrar, të palexuar më parë.
I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njërës nga format shprehëse;
II.2	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeve të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera);
II.4	Zgjidh problemin a detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkencat e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme;
II.5	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij a saj;
III.6	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme;
III.8	Menaxhon sjelljet e veta, materialet a mjetet dhe kohën që ka në dispozicion, gjatë kryerjes së një detyre a veprimtarie individuale apo të përbashkët në klasë a shkollë apo jashtë saj.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.3	Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupon atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për bërjen a kryerjen e tyre etj.;
IV.6	Identifikon ushqimet më të shpeshta, materialet e tjera shpenzuese të familjes apo harxhimet vetjake dhe llogarit shpenzimet për një javë; të dhënat e gjetura i paraqet në formë tabelare/grafike apo në një formë tjetër;
IV.7	Lexon etiketën, udhëzuesin e produkteve të ndryshme (rrobave, ushqimit, barnave apo të teknikës) dhe jep sqarim për prejardhjen, përmbajtjen, përdorimin, mënyrën e mirëmbajtjes apo për rreziqet në rast mospërdorimi të drejtë - adekuat.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.1	Prezanton para të tjerëve mënyrën e zbatimit të rregullave themelore të higjienës personale (fizike, të veshmbathjes, të gjësendeve personale) dhe të higjienës së mjedisit ku jeton dhe vepron, përmes formave të ndryshme të shprehjes;
V.3	Përgatit një listë (me njërën nga format e shprehjes: shkrim, vizatim etj.) me ushqimet që i konsumon familja, duke i renditur ato sipas kalorisë dhe më pas i klasifikon në ushqime të shëndetshme dhe më pak të shëndetshme;
V.4	Lexon të dhënat në paketim të ushqimit dhe diskuton në grup për këto të dhëna (vlerat ushqyese, afatet e prodhimit etj.);
V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në klasë/shkollë apo jashtë saj).
V.9	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të gjërave që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët.
VI.4	Propozon dhe ndan mendimin me shokët a shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.

Rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.2	Përshkruan dhe hulumton tiparet themelore të ndërtimit dhe funksionit të organizmit të njeriut dhe qenieve të tjera të gjalla, ciklin jetësor të qenieve të gjalla, proceset riprodhuese të bimëve dhe shtazëve, zinxhirët e ushqimit dhe rolin e mikroorganizmave në mjedis;
1.3	Shpjegon mënyra të ruajtjes së ushqimeve, konsumimin e sigurt të tyre dhe efektet e substancave të dëmshme për organizmin (duhani, alkooli, pijet energjike);
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij dhe ndërlihdjen mes tyre.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxëniet për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kupton dhe interpreton rolin e ushqimit si burim energjie për funksionet jetësore të njeriut, si dhe rolin e ushqimit për jetën e shëndetshme; - Identifikon dhe përshkruan përbërësit kryesorë të ushqimit të njeriut (nutrienteve): ujin, sheqernat, yndyrat, proteinat, mineralet, vitaminat, përfshirë rolin e secilit nga ta për organizmin; - Dallon dhe liston produktet ushqimore me bazë bimore dhe shtazore që përdor në jetën e përditshme, përfshirë ushqimet me shenjat <i>bio</i> dhe <i>eko</i>; - Hulumton dhe dallon produktet ushqimore të shëndetshme dhe ato jo të shëndetshme për moshën specifike; - Ndërton piramidën e thjeshtë të ushqimit të njeriut sipas vlerave ushqimore dhe për shëndetin; - Shpjegon rolin e ushqimeve të shëndetshme dhe higjienike për një jetë të shëndetshme; - Aplikon në jetë udhëzimet për ruajtjen e ushqimeve nga mikrobet dhe ndotja, njëh atëherë e përdorimit në etiketa dhe kushtet e higjienës së tyre për përdorim; - Shpjegon dhe liston produktet higjienike që përdoren në jetën e përditshme. 	<ol style="list-style-type: none"> 19. Përbërësit kryesorë të ushqimit 20. Përbërësit kryesorë të ushqimit - fletore pune 21. Prejardhja e ushqimit 22. Prejardhja e ushqimit - fletore pune 23. Ushqimi i shëndetshëm 24. Ushqimi i shëndetshëm - fletore pune 25. Piramida e ushqimit të njeriut 26. Piramida e ushqimit të njeriut - fletore pune 27. Ruajtja e ushqimit 28. Ruajtja e ushqimit - fletore pune 29. Efektet e lëndëve të dëmshme për organizmin 30. Efektet e lëndëve të dëmshme për organizmin - fletore pune 31. Higjiena dhe prodhimet higjienike 32. Higjiena dhe prodhimet higjienike - fletore pune 33. Ndërveprimet e organizmit me gjallë me mjedisin 34. Zinxhirët ushqimorë në ekosistem 	17	<ul style="list-style-type: none"> - Organizuesi grafik - Stuhi mendimesh - Pyetja sjell pyetjen - Tabela e koncepteve - Imagjinatë e drejtuar - RAFT - DI - DUA TË DI - MËSOVA - Ruaje fjalën e fundit për mua - Rrjeti i diskutimit - Diagrami i Venit - Kubimi - Parashikim me terma paraprakë - Shqyrtim i përbashkët - Shënime mbi shënime - Lexim i drejtuar - Ditarët e të nxëniet - Rishikim në dyshe - Të nxëniet me këmbime - Shpjegimi i përparuar 	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja në veprimtari - Listë e kontrollit - Semafori - Informata kthjese - Vlerësimi i ndërsjellë - Dy yje, një dëshirë - Vëzhgimi - Kontrolli para fluturimit - Test 	<p>Gjuhë amtare</p> <p>Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti</p> <p>Shkathësi për jetë</p> <p>Edukatë figurative</p> <p>Çështje ndërkurrikulare</p> <p>Arsimi për zhvillimin e qëndrueshëm</p> <p>Edukim për paqe</p> <p>Globalizimi dhe ndërmarrësia</p>	<p>“Njeriu dhe natyra 3”</p> <p>“Njeriu dhe natyra 3 - fletore pune”</p> <p>Enciklopedi</p> <p>Atlase</p> <p>Burime nga interneti (Filma, dokumentarë, videoeksperimente)</p>
<p>Ndërveprimet e organizmave të gjallë</p>							

	<p>- Definon përbërësit e piramidës ushqimore në ekosistemet e gjalla, sipas rolit të tyre: prodhues, konsumues dhe zëbrëthyes, dhe lidhjen e tyre në zinxhirët ushqimorë;</p> <p>- Shpjegon dhe interpreton nevojat e organizmave bimorë për jetë, siç janë: uji, drita, dheu, materiet minerale dhe gazet: dyoksid karboni dhe oksigjeni;</p> <p>- Shpjegon dhe interpreton nevojat e organizmave shtazorë për jetë: nevojat për ushqim me bazë bimorë dhe shtazore, ujë, strehim, riprodhim etj.</p>	<p>35. Zinxhirët ushqimorë në ekosistem - fletore pune</p>			<p>Tekstet shkollore;</p> <p>Librat e aktiviteteve dhe të ushtrimeve;</p> <p>Librat e punës;</p> <p>Broshura; Atlase;</p> <p>Enciklopedi;</p> <p>Gazeta;</p> <p>Revista;</p> <p>Doracakë;</p> <p>https://emesimi.rks-gov.net/shq/</p>
--	---	--	--	--	--

PLANI TREMUJOR: JANAR—SHKURT—MARS

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Temat mësimore: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale
Edukimi seksual
Fërkimi dhe shtypja
Bashkëveprimi i trupave

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv*

I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë.
I.8	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve në kohëzgjatje deri në 10 minuta duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Identifikon veçoritë e përbashkëta dhe dalluese ndërmjet objekteve, qenieve të gjalla, dukurive apo ngjarjeve, të dhëna në detyrë; i paraqet ato para të tjerëve përmes njëres nga format shprehëse.
II.2	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera);
II.4	Zgjidh problemin dhe detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme.
II.5	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna.
II.6	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, historiko-shoqërore) në njërin nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie.
II.7	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi/detyrë të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore... etj.) në kohëzgjatje prej 6-10 minutash.

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njërës nga format e shprehjes.
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar.
III.3	Identifikon dhe krahason informatat e njohura me ato të panjohura për një temë, çështje apo ngjarje të caktuar, duke përdorur teknika të ndryshme (p.sh., duke i shenjuar me shenja të ndryshme).
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;
III.5	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar;
III.6	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.3	Përgatit një projekt të vogël duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupon atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre etj.
IV.4	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes.

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.6	Propozon alternativa për zgjidhjen konstruktive të një konflikti ndërpersonal, duke i analizuar paraprakisht me kujdes rrethanat që kanë shkaktuar konfliktin, ndan përvojat, mendimet dhe ndjenjat e veta me anëtarët e grupit;
V.7	Dallon dhe përshkruan rolet e personave dhe shërbimeve të nevojshme për kërkimin e ndihmës në situata të caktuara të rrezikut të shëndetit të vet, fizik dhe mendor.
V.9	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të gjërave që e rrethojnë etj.).

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.1	Paraqet në forma të ndryshme të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëtarëve të familjes së vet dhe i diskuton ato me të tjerët, më pas i krahason me të drejtat dhe përgjegjësitë e nxënësve, mësuesve dhe stafit menaxhues në shkollë apo me pjesëtarët e ndonjë institucioni;
VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një veprimtarie të përbashkët;
VI.4	Propozon dhe ndan mendimin me shokët a shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësimor, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre.

Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

--	--

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e mësimdhënies	Metodologjia e vlerësimit	Ndërlidhja me lëndët e tjera mësimore, ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
<p>Karriera</p> <p>ime</p> <p>Planifikimi</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Shpjegon dhe interpreton nevojat e organizmave bimorë për jetë, siç janë: uji, drita, dheu, materiet minerale dhe gazet: dyoksid karboni dhe oksigjeni; - Shpjegon dhe interpreton nevojat e organizmave shtazorë për jetë: nevojat për ushqim me bazë bimorë dhe shtazore, ujë, strehim, riprodhim etj.; - Ndërton piramidat ushqimore në ekosistem dhe klasifikon organizmat që njihen sipas këtyre kategorive ekologjike dhe përfshirë njeriun si pjesë e tyre. - Defnon konceptin e familjes dhe strukturat e ndryshme (me dy prindër, me një prind...); - Përkrauan nevojat dhe rolet e antarëve brenda familjes; - Shpreh emocionet, dëshirat dhe nevojat e saj/tij; - Dallon relacionet e ndryshme në raport me miqësinë dhe dashurinë në familje dhe në shoqëri; - Dallon sipërfaqet e lëmuara nga sipërfaqet e vrazhda të trupave dhe gjen shembuj për varshmërinë e fërkimit nga lloji i materialit të sipërfaqeve takuese; - Vë në dukje shembuj të zmadhimit të temperaturës me fërkim të sipërfaqeve takuese; 	<p>36. Piramida ekologjike</p> <p>37. Bimët dhe nevojat e tyre</p> <p>38. Kafshët dhe nevojat e tyre</p> <p>39. Nevojat e bimëve dhe kafshëve - fletore pune</p> <p>40. Familja</p> <p>41. Emocionet, dëshirat dhe nevojat e antarëve të familjes</p> <p>42. Emocionet, dëshirat dhe nevojat e antarëve të familjes - fletore pune</p> <p>43. Fërkimi</p> <p>44. Fërkimet mes trupave me gjendje të ndryshme agregate</p> <p>45. Fërkimet e dobishme dhe të dëmshme</p> <p>46. Fërkimet e dobishme dhe të dëmshme - fletore pune</p> <p>47. Elektrizimi i trupave për mes fërkimit</p> <p>48. Elektrizimi i trupave për mes fërkimit - fletore pune</p> <p>49. Shtypja e trupit mbi sipërfaqe</p> <p>50. Elektriciteti, magneti dhe magnetizimi</p>	21	<ul style="list-style-type: none"> - Organizuesi grafik - Stuhi mendimesh - Pyetje sjell pyetjeve - Tabela e koncepteve - Imagjinatë e drejtuar - RAFT - DI - DUA TË DI - MËSOVA - Ruaje fjalën e fundit për mua - Rrjeti i diskutimit - Diagrami i Venit - Kubimi - Parashikim me terma paraprakë - Shqyrtim i përbashkët - INSERT - Pyetje e autorit - Përvijim i të menduarit - Shënime mbi shënime - Lexim i drejtuar - Ditarët e të nxënit - Rishikim në dyshe - Të nxënë të këmbime - Shpjegimi i përparuar 	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja aktive në veprimtari - Listë e kontrollit - Semafori - Informata - kthyes - Vlerësimi i ndërsjellë - Dy yje, një dëshirë - Vëzhgimi - Kontrolli para fluturimit - Test 	<p>Gjuhë amtare</p> <p>Edukatë fizike, sportet dhe shëndeti</p> <p>Shkathësi për jetë</p> <p>Edukatë figurative</p> <p>Çështje ndërkurrikulare</p> <p>Arsimi për zhvillimin e qëndrueshëm</p> <p>Edukim për paqe</p> <p>Globalizmi dhe ndërmarrësia</p>	<p>“Njeriu dhe natyra 3”</p> <p>“Njeriu dhe natyra 3 - fletore pune”</p> <p>Enciklopedi</p> <p>Atlase</p> <p>Burime nga interneti (Filma, dokumentarë, videoeksperimente)</p>
<p>Mjedisi dhe shëndeti</p>							

	<ul style="list-style-type: none"> - Demonstron dallimin e fërkimit të qetësisë, të lëvizjes dhe të rrokullisjes, me ndihmën e kanaçes së mbushur me një pije freskuese; - Demonstron shembuj të fërkimit të vogël apo të madh dhe të zvogëlimit apo të zmadhimit të tij; - Tregon vetitë e dëmshme dhe të dobishme të fërkimit në jetën e përditshme; - Paraqet shembuj të shtypjes së trupit në jetën e përditshme, me ndihmën e pesës dhe sipërfaqes së vendosjes së tij; - Demonstron vartësinë e shtypjes që bën i njëjti trup kur vendoset në sipërfaqe me vlera të ndryshme dhe kur trupat e ndryshëm vendosen në sipërfaqe me vlera të njëjta dhe nxjerr përfundime; - Gjen shembuj të tjerë për vërtetimin e varësisë së shtypjes nga pesha e trupit dhe sipërfaqes së vendosjes së tij; - Dallon me shembuj lloje të bashkëveprimit të trupave në natyrë që takohen; - Gjen shembuj të ngjashëm me rendjen e mollës, dardhës apo foit nga pema si bashkëveprim të trupave pa u takuar; - Dallon forma të magnetëve, demonstroi tërheqjen e limaturës së hekurit me ta dhe gjen metale që nuk tërhiqen me magnetët; - Demonstron dëbimin dhe tërheqjen e poleve të njëjta apo të kundërta të magnetëve, si bashkëveprim të trupave pa u takuar. 	<p>50. Elektriciteti, magneti dhe magnetizmi - fletore pune</p> <p>51. Bashkëveprimi i trupave në lëvizje dhe në qetësi</p> <p>52. Bymimi dhe tkurrja</p> <p>53. Bymimi dhe tkurrja - fletore pune</p> <p>54. Përhapja e zërit</p> <p>55. Burimet e dritës</p>				
--	--	--	--	--	--	--

PLANI TREMUJOR: PRILL—MAJ—QERSHOR

Lënda mësimore: Njeriu dhe natyra

Fusha e kurrikulës: Shkencat e natyrës

Klasa: III

Temat mësimore: Bashkëveprimi i trupave
Vendi dhe hapësira
Sistemet fizike
Bashkëveprimi i njeriut me natyrën

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave: *Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – Komunikues efektiv*

I.3	Dëgjon në mënyrë aktive prezantimin e tjetrit dhe merr pjesë në diskutim, duke u paraqitur me të paktën dy ndërhyrje; pyetje, komente apo sqarime për temën e dhënë;
I.8	Prezanton një temë të caktuar para të tjerëve, në kohëzgjatje deri në 10 minuta, duke përdorur TIK-un apo teknologji tjetër, u përgjigjet pyetjeve të bëra nga të tjerët, si dhe bën pyetje gjatë dhe pas prezantimit, për të vazhduar më tej me kërkimin e informatave të tjera.

Kompetenca e të menduarit – Mendimtar kreativ

II.1	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera);
II.2	Identifikon çështjet e njëjta, dalluese ose kryesore të një teme apo ngjarjeje të njëjtë, por të nxjerra nga dy a më shumë burime të ndryshme të informacionit (tekst mësimor, gazetë, internet, burime njerëzore apo burime të tjera);
II.4	Zgjidh problemin a detyrën e dhënë nga gjuha, aritmetika, gjeometria, shkenca e natyrës, shoqëria ose fusha të tjera dhe jep një shembull e më shumë nga jeta e përditshme kur një qasje e tillë mund të përdoret në situata të ngjashme;
II.5	Ndërton tekste, objekte, animacione apo gjëra të tjera në bazë të imagjinatës, duke përdorur me kujdes udhëzimet dhe elementet apo materialet e dhëna;
II.6	Përshkruan dukurinë e caktuar (natyrore, shoqërore - historike) në njërin nga format shprehëse, duke veçuar ndryshimet që ndodhin apo kanë ndodhur në mjedisin që e rrethon e që janë rrjedhojë e kësaj dukurie;
II.7	Paraqet dhe arsyeton me argumente mënyrën e zgjidhjes së një problemi a detyre të caktuar të fushave të ndryshme (matematikore, gjuhësore, të shkencave të natyrës, shoqërore, të arteve, shëndetësore etj.), në kohëzgjatje prej 6-10 minutash;
II.8	Dallon lëndët, trupat, objektet, dukuritë natyrore apo shoqërore, të dhëna në detyrë sipas karakteristikave (përbërjes, vetive, shndërrimeve apo pozitave në kohë e hapësirë dhe bashkëveprimi të tyre.).

Kompetenca e të nxënit – Nxënës i suksesshëm

III.1	Parashtron pyetje që nxisin debat për temën/problemin e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes njëres nga format e shprehjes;
III.2	Shfrytëzon burime të ndryshme të informacionit me rastin e përgatitjes së një teme të caktuar;
III.4	Ndjek udhëzimet e dhëna në libër apo në burime të tjera për të realizuar një veprim, aktivitet apo detyrë konkrete që kërkohet prej tij/saj;
III.5	Krahason përparimin e vet me përvojën paraprake, gjatë kryerjes së një detyre apo një aktiviteti të caktuar;
III.6	Përdor dosjen personale si mjet për identifikimin e përparësive dhe mangësive të veta në fusha të caktuara dhe bën një plan për mënyrën e korrigjimeve të nevojshme;
III.8	Menaxhon sjelljet e veta, materialet/mjetet dhe kohën që ka në dispozicion gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti individual apo të përbashkët në klasë/shkollë apo jashtë saj;

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – Kontribues produktiv

IV.3	Përgatit një projekt të vogël, duke veçuar aktivitetet kryesore për një çështje që e preokupon atë, shkollën apo lagjen dhe përcakton elementet e tjera, që e bëjnë më të zbatueshëm, si: kohën, vendin, materialet, mjetet e nevojshme për kryerjen e tyre etj.;
IV.4	Diskuton në grup për gjendjen e mjedisit që e rrethon, të incizuar më parë (si: vëzhgim, fotografim etj.) dhe bën një listë në bashkëpunim me anëtarët e grupit për aktivitetet e mundshme për mbikëqyrjen dhe përmirësimin e gjendjes;

Kompetenca personale – Individ i shëndoshë

V.8	Bashkëpunon në mënyrë aktive me të gjithë moshatarët (pavarësisht prejardhjes së tyre, aftësive dhe nevojave të veçanta) për arritjen e një qëllimi të përbashkët (projekti/aktiviteti në klasë/shkollë apo jashtë saj);
V.9	Përkujdeset për mjedis të shëndoshë në rrethanat në të cilat realizon një aktivitet të caktuar, duke i krijuar vetes dhe pjesëmarrësve të tjerë kushte të përshtatshme të punës (ajrosje, shfrytëzim të dritës, shfrytëzim maksimal të hapësirës, mbajtje të pastërtisë, mbajtje të rregullt të gjërave që e rrethojnë etj.);

Kompetenca qytetare – Qytetar i përgjegjshëm

VI.2	Shpreh, dëgjon dhe respekton mendimin e secilit anëtar dhe bashkërisht vendos për mënyrat e përfundimit të një aktiviteti të përbashkët;
VI.4	Propozon dhe ndan mendimin me shokët a shoqet e klasës për procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të grupeve të aktiviteteve të ndryshme me karakter mësues, të këshillave në klasë apo në shkollë, përbërjen dhe rolin e tyre;
VI.8	Paraqet me shembuj konkretë sjelljet që duhen manifestuar në rast rreziku nga fatkeqësitë natyrore apo të krijuara nga njeriu, si: zjarri, vërshimi, tërmeti, komunikimi me njerëz të panjohur etj.

Rezultatet e të nxënimit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/temave:

1.1	Identifikon dhe hulumton materialet natyrore dhe artificiale që përdoren në jetën e përditshme, sipas vetive dhe shndërrimeve të tyre;
1.6	Përshkruan pozitën e Tokës në Sistemin Diellor, lëvizjet e Tokës, Diellit, Hënës dhe të trupave të tjerë të këtij sistemi, elementet e hartës, përmbajtjen e hartës, legjendën e hartës, shenjat hartografike, skicën, planin, globin, veçoritë e elementeve natyrore të mjedisit natyror (relievin, klimën, ujërat, botën bimore dhe shtazore), bashkëveprimin njeri-natyrë, rreziqet natyrore, resurset natyrore e objektet e trashëgimisë natyrore, në veçanti ato të Republikës së Kosovës;
2.1	Formulon pyetje për objektet, gjallesat dhe ndodhitë në mjedisin rreth tij dhe ndërlihdjen mes tyre;
2.5	Prezanton të dhënat (të gjeturat) dhe konkluzionet, duke përdorur shpjegimet me gojë dhe me shkrim, diagramet, grafikët apo TIK-un.

Temat mësimore	Rezultatet e të nxënit për temat mësimore	Njësitë mësimore	Koha mësimore (orë mësimore)	Metodologjia e vlerësimit	Metodologjia e vlerësimit	Nërlidhja me lëndët e tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore	Burimet
Bashkëprimi i trupave	<ul style="list-style-type: none"> - Demonstron ngritjen sa më të lehtë të barrës me lloz, duke zmadhuar krahun e veprimit të forcës F (duart) ndaj krahut të barrës Q nga pika mbështetëse O; - Demonstron punën me gërshtë dhe me darë dhe identifikon në tokë krahun e barrës, pikën mbështetëse dhe krahun e veprimit të forcës (duarve); - Demonstron tërheqjen e trupit të lidhur nëpër rrafsh të pjerrët dhe hulumton vartësinë e tërheqjes më të lehtë nga lartësia e tij (dërrasë e vendosur në disa libra, spango, tullë, dinamometër); - Demonstron baraspeshimin mes dy trupave të vendosur në krahët e kundërt të llozit dykrahësh, ndaj pikës mbështetëse të tij. 	<ul style="list-style-type: none"> 57. Përhapja e zërit - fletore pune 58. Llozi dhe përdorimi i tij 59. Përdorimi i makinave të thjeshta 60. Përdorimi i makinave të thjeshta - fletore pune 61. Planetët në Sistemin Diellor 62. Planetët në Sistemin Diellor 63. Toka dhe Hëna 64. Toka dhe Hëna - fletore pune 65. Harta, globi dhe plani - fletore pune 66. Harta, globi dhe plani - fletore pune 67. Format e relievit 68. Format e relievit - fletore pune 69. Ruajtja e mjedisit 70. Ajri dhe ndoia e tij 71. Ruajtja e mjedisit dhe e ajrit - fletore pune 72. Ndoia e ujit 73. Toka dhe ndoia e saj 74. Ndoia e tokës dhe e ujit - fletore pune 	18	<ul style="list-style-type: none"> - Organizuesi grafik - Stuhi mendimesh - Pyetja sjell pyetjen - Tabela e koncepteve - Imagjinatë e drejtuar - RAFT - DI - DUA TË DI - MËSOVA - Ruaje fjalën e fundit për mua - Rrjeti i diskutimit - Diagrami i Venit - Kubimi - Parashikim me terma paraprakë - Shqyrtim i përbashkët - Shënime mbi shënime - Lexim i drejtuar - Ditarët e të nxënit - Rishikim në dyshe - Të nxënë të këmbime - Shpjegimi i përparuar 	<ul style="list-style-type: none"> - Pjesëmarrja në veprimtari - Listë e kontrollit - Semafori - Informata kthyesë - Vlerësimi i ndërsjellë - Dy yje, një dëshirë - Vëzhgimi - Kontrolli para fluturimit - Test 	<ul style="list-style-type: none"> - "Njeriu dhe natyra 3" - "Njeriu dhe natyra 3 - fletore pune" - Enciklopedi - Atlase - Burime nga interneti (Filma, dokumentarë, video, eksperimente) 	
Vendi dhe hapësira							

<p>Sistemet fizike</p>	<ul style="list-style-type: none"> - Kupton se objektet, pjesët e sipërfaqes dhe Toka mund të paraqiten në letër, në glob, të zvoqëluara dhe me shenja të veçanta, si dhe pse shërben hartimi i planit të një vendi ose ndërtese. - Përshkruan, identifikon, dallon dhe krahason elementet natyrore në mjedisin ku jeton: format kryesore të relievit (malet, fushat, lumenjtë, liqenet etj.) në mjedisin ku jeton; udhëtimin nga shtëpia në shkollë, ose nga vendi i banimit në piknik dhe anashjellas; motin (me diell, shi, erë, etj.). - Tregon për mënyrat e ndikimit të njeriut në natyrë (si të ruhet cilësia e ajrit, ujit dhe tokës) dhe rëndësinë e ruajtjes së mjedisit (me figura, me shenja të informimit etj.). 						
<p>Bashkëveprimi i njeriut me natyrën</p>							

Mësimi 1

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për nocionet materiale, lëndët e para, lëndët e pastra dhe lëndët e përziera.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, II.5, II.7, II.8, III.1, V.2, V.8, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.5, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Materialet dhe lëndët e para

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon materialet e ndryshme;
- Identifikon materialet;
- Përshkruan lëndët e para të materialeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Karrige, çantë, laps, çadër, syze.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Edukatë fizike, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim për njohuritë paraprake

Ftohen nxënësit të shikojnë objekte në klasë (të përbëra prej një lënde). Drejtohen pyetje:

- Çfarë është kjo? (P.sh.: karrigia.)
- Përmendni disa gjëra dhe thoni prej çfarë lënde përbëhen ato.

Kur nxënësit gjejnë emrin e lëndës prej nga përbëhet ajo, nxiten të japin arsytime.

Kërkohej nga nxënësit t'i hapin librat dhe të lexojnë, më pas diskutojmë rreth figurave në libër:



LËNDËT DHE VETITË E TYRE

1.1. MATERIALET DHE LËNDËT E PARA

Fjalët kyçe

lënda e parë, druri, sintetike, minerale, bimë, kafshë, thëngjilli.

Materialet janë lëndë (materie) nga të cilat ndërtohen objektet ose trupat e ndryshëm. P.sh. lapsi, fletorja, tavolina, karrigia etj. mund të jenë të ndërtuar nga i njëjti material (druri).



Produkte nga druri



Bankë

Kemi lloje të ndryshme të materialeve. Secili i ka vetitë e veta, në bazë të të cilave dallohet nga materialet e tjera. Varësisht prej vetive dhe gjendjes agregate, materialet dallohen mes vete dhe përdoren për të ndërtuar gjëra të ndryshme. P.sh. hekuri është i fortë, prandaj përdoret për të ndërtuar objekte shumë të forta (p.sh. këmbët e bankës), ndërsa druri është më pak i fortë, por më i ngrohtë se hekuri, prandaj e përdorim për ndërtimin e pjesës së sipërme të bankës.

Objektet janë të ndërtuara nga materiale të ndryshme, p.sh. nga druri, pambuku, plastika, hekuri, alumini, minerale të ndryshme etj. Të gjitha materialet që përdoren për ndërtimin e objekteve të tjera quhen lëndë të para. Lënda e parë mund të jetë me prejardhje bimore, shtazore, nga mineralat (p.sh., thëngjilli) ose e krijuar nga njeriu (sintetike, artificiale).



Prejardhja e lëndëve të para

Materia, vetitë dhe shndërrimet

6

Vendi ynë është mjaft i pasur me lëndë të para, si p.sh.: thëngjill, zink, plumb, argjend, ari, krom etj.
Në figurat më poshtë, shikoni përpunimin e lëndës së parë dhe përfitimet e prodhimeve.

**Pyetje**

1. Trego se çfarë janë materialet.
2. Në bazë të cila vetive dallohen materialet?
3. Cilat lëndë quhen të para? Shpjego se nga mund ta kenë prejardhjen.

Të mbajmë mend

- Materialet janë lëndë nga të cilat janë të ndërtuara objektet ose trupat e ndryshëm.
- Secili nga materialet ka vetitë e veta dhe dallohet nga materialet e tjera.
- Të gjitha materialet që përdoren për ndërtimin e objekteve të tjera quhen lëndë të para.

Materia, vetitë dhe shndërrimet

7

- Çfarë materialesh do të përdornit për të bërë një bankë, laps, karrige etj.?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Lojë

Kërkohet nga nxënësit të ndahen në dyshe dhe i vendosim disa gjëra të ndryshme në një çantë ose në një kuti. Nxënësit duhet ta futin dorën brenda, t'i prekin dhe t'ua përshkruajnë karakteristikat e tyre nxënësve të tjerë, të cilët duhet të përpiqen ta gjejnë se për çfarë bëhet fjalë, duke treguar se nga e ka prejardhjen ose cila është lëndë e parë nga e cila përpunohet ajo gjë.

(Kjo lojë mund të zhvillohet në dyshe ose në grup.)

**Përforcimi:****Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**

Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i vendosim përpara një objekt dhe kërkojmë që atë objekt ta përshkruajnë duke filluar nga çfarë është, çka e përbën atë dhe në bazë të cila vetive dallohen materialet. Në 5 minutat e fundit të orës, nxënësit do të shkruajnë shumë shkurt dhe shpejt në lidhje me temën "Lëndë e parë". Në këtë shkrim, ata do t'i përmbledhin mendimet në lidhje me temën dhe informacionin që morën.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim, për analizimin, identifikimin e materialeve dhe lëndëve të para.

Detyrë:

Përgjigjiuni pyetjeve në fund të mësimi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi | 2

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për nocionet materiale, lëndët e para, lëndët e pastra dhe lëndët e përziera.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, II.5, II.7, II.8, III.1, V.2, V.8, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.5, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Materialet dhe lëndët e para - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon materialet e ndryshme;
- Përforcon njohuritë e marra.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Shami, ngjyra etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Edukatë fizike, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Diskutim për njohuritë paraprake

Vendosim në qendër fjalën *materia* dhe shkruajmë çfarë dimë për të.




LËNDËT DHE VETITË E TYRE

1.1. MATERIALET DHE LËNDËT E PARA

1. Identifiko dhe shëno objektet e ndërtuara nga druri në klasën tënde.


2. Shkruaj materialin nga i cili vjen lënda e parë, sipas figurës.



1.1. MATERIALET DHE LËNDËT E PARA

1. Identifiko dhe shëno objektet e ndërtuara nga druri në klasën tënde.

2. Shkruaj materialin nga i cili vjen lënda e parë, sipas figurës.






**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

Pyeten nxënësit nëse mund të gjejnë sende të tjera që përbëhen nga i njëjti material?
Cilat mund të jenë ato?
Çfarë vetish mund të thoni për to?

U kërkohet nxënësve t'i hapin librat dhe fillojnë të plotësojnë në fletore pune, faqe 6.


**Përforsimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Lojë**

Njëri nga nxënësit do t'i mbulojë sytë me shami dhe do të përshkruajë një send, ndërkohë që nxënësit e tjerë mund ta shohin atë. Nxënësi me sy mbyllur do ta përshkruajë sendin vetëm duke e prekur dhe më pas do të përpiqet ta gjejë se për çfarë sendi bëhet fjalë. Të tjerët mund ta ndihmojnë duke përshkruar sendin ose duke i dhënë atij ndonjë detaj ndihmës, p.sh., i shndritshëm, i zbehtë, ngjyra që ka, ndjesia kur e prek, p.sh., i ashpër, i butë, i ftohtë, me gunga: ose të qenët i punueshëm, i vrazhdë, i butë, i përkulshëm, i fortë, i ngurtë.


Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përforsimin dhe diskutimin e njohurive të marra.

Detyrë:

Zgjidhni një nga materialet që keni në shtëpi dhe shkruani për të.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për nocionet materiale, lëndët e para, lëndët e pastra dhe lëndët e përziera.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, II.8, III.1, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.5, 2.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lëndët e pastra dhe lëndët e përziera

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon rolin e lëndës së parë;
- Identifikon lëndët e pastra dhe të përziera;
- Strukturon informacionet në tabelë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

DI

Nxënësve u drejtohen pyetje dhe në kolonën DI do të shkruajnë njohuritë që kanë për lëndët.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Materialet janë lëndë nga të cilat janë të ndërtuara objektet ose trupat e ndryshëm. Secili nga materialet ka vetitë e veta dhe dallohet nga materialet e tjera. Të gjitha materialet që përdoren për ndërtimin e objekteve të tjera.		



1.2. LËNDËT E PASTRA DHE LËNDËT E PËRZIERIA

Fjalët kyçe

materialet e pastra, lëndët e përziera.



Diamanti



Kripa



Ari

Materialet e pastra

shtoni sheqer, krijoni sherbet. Sherbeti është përzierje e krijuar nga dy lëndë të pastra (uji dhe sheqeri). Pjetet dhe ushqimet nga lëndë të përziera janë: lëngjet e frutave, sallatat, ëmbëlsirat etj. Lëndë të përziera janë edhe ajri, uji i detit, materialet ndërtimore etj.



Lëngje i frutave



Sallata



Ëmbëlsira

Lëndët e përziera



Materialet ndërtimore



Materialet ndërtimore



Materialet ndërtimore

Të mbajmë mend

- Shumica e lëndëve të përziera janë të domosdoshme për jetën, si p.sh. ajri, uji, ushqimet, lëngjet freskuese, ilaçet, veshmbathjet etj.
- Hapësirat më të rëndësishme të pasura me lëndë të pastra dhe të përziera janë Toka, uji dhe ajri.

Materia, vetitë dhe shndërrimet

8



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DUA TË DI

Lexojmë me kujdes tekstin dhe ndërtojmë pyetje për të plotësuar rubrikën DUA TË DI.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
	Çfarë janë materialet e pastra? Çfarë janë materialet e përziera? Pse sallata dhe lëngjet e frutave janë materie të përziera? Për çka janë të domosdoshme lëndët e përziera?	



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit MËSOVA

Para nxënësve paraqesim dy lëndë të pastra (ujin dhe sheqerin). Hedhim sheqerin në ujë dhe e përzierim. Nga kjo përzierje fitojmë sherbetin ose lëndën e përzier. Më pas, plotësojmë rubrikën MËSOVA.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
		Materialet janë të pastra kur përbëhen vetëm nga një lloj material. Materiali mund të përbëhet nga dy ose më shumë lëndë të pastra. Në këto raste, kemi materiale të përziera. Sepse përbëhen nga dy ose më shumë lëndë. Shumica e lëndëve të përziera janë të domosdoshme për jetën, si p.sh.: ajri, uji, ushqimet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në identifikimin e lëndëve të pastra dhe të përziera, strukturimin e saktë të informacioneve në tabelë, si dhe në shpjegimin e rëndësisë së lëndës së parë.

Detyrë:

Përgjigjuni pyetjes së mësimin në faqen 8.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për nocionet materiale, lëndët e para, lëndët e pastra dhe lëndët e përziera.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, II.8, III.1, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.5, 2.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Lëndët e pastra dhe lëndët e përziera - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon lëndët e pastra dhe të përziera;
- Analizon eksperimentet rreth lëndëve;
- Përforcon njohuritë e marra.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ujë, sheqer, kripë, gotë, lugë etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Matematikë, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Kërkojmë nga nxënësit të ndahen në katër grupe dhe para secilit grup vendosim një lëndë të pastër ose të përzier. Më pas, ata do të përshkruajnë ato lëndë, duke treguar se a është lëndë e pastër apo e përzier; nëse është lëndë e përzier, atëherë nga cilët përbërës përbëhet dhe kështu me radhë.

Në fund, secili grup del para klasës duke treguar se cilën lëndë kanë pasur për ta përshkruar.




LËNDËT DHE VETITË E TYRE


1.2. LËNDËT E PASTRA DHE LËNDËT E PËRZIERA

1. Plotëso tabelën më poshtë, duke listuar lëndët e pastra dhe të përziera në kolonat përkatëse.

Lëndë të pastra	Lëndë të përziera

2. Shkruaj më poshtë lëndën e cila është e pastër dhe atë që është e përzier, pastaj lidhe me vizë figurën që përshatet.

Lënda e pastër: _____ 

Lënda e përzier: _____ 

Materia, vetitë dhe shndërrimet

7

1.2. LËNDËT E PASTRA DHE LËNDËT E PËRZIERIA

1. Plotëso tabelën më poshtë, duke listuar lëndët e pastra dhe të përziera në kolonat përkatëse.

Lëndë të pastra	Lëndë të përziera

2. Shkruaj më poshtë lëndën e cila është e pastër dhe atë që është e përzier, pastaj lidhe me vizë figurën që përshatet.

Lënda e pastër: _____



Lënda e përzier: _____



Materia, vetitë dhe shndërrimet

7



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive: Përpunimi i përmbajtjes Eksperiment

Ndajmë nxënësit në dy grupe dhe eksperimentojmë së bashku. Të dyja grupet do të bëjnë përzierjen e dy lëndëve të pastra, duke formuar lëndë të përziera. Vëzhgoji gotat me kujdes. A dallojnë ato nga njëra-tjetra? Tani provo që t'i dallosh.



Përforsimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Vendosim para nxënësve tri lëndë: dy që përzihen me ujë nga eksperimenti i kaluar dhe një që nuk përzihet me ujë (vajrat). Fillojmë dhe bëjmë përzierjet për të kuptuar më saktë.

Shkruajmë përfundimet:

U përzie me ujë.....

Nuk u përzie me ujë.....

U kërkohet nxënësve t'i hapin librat dhe fillojnë të plotësojnë në fletore pune, faqe 7.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Nxënësit vlerësohen për analizimin dhe përforsimin e njohurive të marra nga eksperimentet e bëra.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon lëndët në bazë të gjendjeve agregate, në bazë të origjinës dhe nga përbërja.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.8, III.3, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 5.1, 2.2, 2.3, 2.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Klasifikimi i materialeve

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Klasifikon materiale të ndryshme;
- Strukturon informacionet në tabelë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Gur, balonë, shishe uji etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Para nxënësve vendosim tri sende: një gur, një shishe me ujë dhe një balonë të mbushur me ajër. Nxësim diskutimin, duke pyetur nxënësit:

Çfarë gjendje agregate kanë?

Cili është dallimi mes tri gjendjeve që shihni?

Më pas, u kërkojmë nxënësve që të përmendin nga një trup tjetër që gjendet në klasë dhe që është në gjendje të ngurtë, të lëngët apo të gaztë.



1.3. KLASIFIKIMI I MATERIALEVE

Materialet mund të klasifikohen në forma të ndryshme, p.sh. në bazë të gjendjes agregate, origjinës apo edhe përbërjes së tyre. Materialet ndërtohen nga grimca shumë të vogla, të cilat janë të padukshme për syrin tonë. Varësisht nga renditja e këtyre grimcave në trup, materiali mund të jetë në gjendje agregate të ngurtë, të lëngët ose të gaztë.

Fjalët kyçe

gjendjet agregate, origjina, përbërja.



Cjendjet e ndryshme agregate të lëndës

Trupat e ngurtë e kanë formën e tyre dhe janë të fortë, sepse grimcat që i ndërtojnë këta trupa janë të renditura shumë afër njëra-tjetrës, të lidhura fort mes vete dhe nuk ndërrojnë vend.

Lëngjet nuk kanë formë të caktuar, por e marrin formën e enës ku gjenden. Kjo ndodh sepse grimcat që përbëjnë lëngjet janë të vendosura afër njëra-tjetrës, nuk janë të lidhura fort mes vete dhe lehtë mund ta ndryshojnë pozitën e tyre.



Format e lëngjeve në gotë

Materia, vetitë dhe shndërrimet



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DI - DUA TË DI - MËSOVA

Kërkojmë nga nxënësit që ta plotësojnë kolonë DI, duke shkruar të gjitha ato që dinë për materialet.

Më pas, në kolonën DUA TË DI, të shkruajnë pyetjet se çfarë duan të dinë për materialet dhe klasifikimin e tyre.

Hapim librat, lexojmë tekstin dhe iu përgjigjemi pyetjeve në kolonën MËSOVA.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
Materialet mund të klasifikohen në forma të ndryshme.	Çfarë prejardhjeje mund të kenë materialet?	Materialet mund të kenë prejardhje nga natyra jo e gjallë dhe ajo e gjallë.



Përforsimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Rrjedhshmëria gojore e dyshe

Punë në dyshe: Kërkojmë nga nxënësit të ndahen në dyshe për të përmbledhur atë që lexojnë e mësojnë. Nxënësi 1, për 60 sekonda, do t'i tregojë shokut diç-

ka që ka mbajtur mend nga pjesa që lexoi. Për 1 minutë, nxënësit ndërrojnë rolet. Tani, nxënësi 2 do t'i tregojë shokut çgjë interesante mësoi, por duke u kujdesur të mos përsëriten ato që ka thënë shoku. Vazhdohet kështu deri në fund. E rëndësishme është që nxënësit ta rishikojnë materialin dhe të pyesin nëse kanë ndonjë paqartësi.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim, për klasifikimin e materialeve dhe strukturimin e saktë të të dhënave në tabelë.

Detyrë:

Vizato dhe përshkruaj tri materiale që ke në shtëpi, duke i klasifikuar ato në bazë të gjendjes agregate, prejardhjes dhe përbërjes.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Mësimi | 6

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon lëndët në bazë të gjendjeve agregate, në bazë të origjinës dhe nga përbërja.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, II.8, III.3, III.4, V.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 5.1, 2.2, 2.3, 2.6.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Klasifikimi i materialeve - fletore pune


Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon materialet e ndryshme;
- Përcakton përbërësit e materialeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kuti, top etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Edukatë fizike, Shkathësi për jetë.




METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Harta e konceptit




1.3. KLASIFIKIMI I MATERIALEVE

1. Lidh me vizë llojin e materialit në bazë të gjendjes agregate, përbërjes dhe origjinës.

Gjendja agregate

Përbërja

Origjina



2. Bisedoni me mësuesin/in dhe shokët e shoqet e klasës për lëndët që mund të përfitohen nga organizmat e gjallë dhe shënoni më poshtë këto lloje të lëndëve.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Në një kuti, kemi vendosur fletëza me emrat e disa materialeve (p.sh., shishe plastike, çanta, guri, balona etj.) dhe nxënësit, të organizuar në dyshe, nga kutia 2 do t'i zgjedhin emrat e materialeve. Ata do të analizojnë duke klasifikuar sipas prejardhjes, gjendjes agregate dhe përbërjes së tyre. Më pas, u kërkojmë nxënësve që t'i hapin librat dhe fillojnë të plotësojnë në fletore pune, faqe 8.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Lojë

Kërkojmë nga nxënësit të ngrihen në këmbë dhe të formojnë një rreth. Secili nga ta do të mendojë një trup në natyrë. Loja luhet përmes një topi prej letre, që do t'ia hedhë një nxënës nxënësit tjetër në rreth, duke i kërkuar që ta thotë prejardhjen e trupit që nxënësi i parë e ka përmendur. Kështu veprohet brenda rrethit, ku nxënësi që e ka topin e letrës e thotë emrin e materialit dhe atij që ia hedh topin për ta kapur, e thotë prejardhjen e materialit. Vazhdohet kështu deri në përfundim të orës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësi në identifikimin e materialeve dhe përcaktimin e përbërësve të tyre.

Detyrë:

Përgjigjiuni pyetjeve të mësimin në faqen 10.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan tri gjendjet agregate të ujit;
Kupton gjendjet agregate të ujit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, II.6, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Gjendjet agregate të ujit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon tri gjendjet agregate të ujit;
- Përshkruan gjendjen agregate të ujit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Edukatë figurative, Edukatë fizike.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Dil rrotull - fol rrotull

U kërkojmë nxënësve të ngrihen në këmbë dhe të lëvizin në pjesët më të lira të klasës dhe u drejtohen këto pyetje:

Çfarë dini për ujin?

Çfarë gjendje agregate mendoni se ka uji?


Duke lëvizur, mendojnë për pak çaste. Në momentin kur përplasim pëllëmbët e duarve një herë, ata ndalen në vend dhe i tregojnë shokut se çfarë dinë rreth pyetjes. Lihen të bisedojnë për pak kohë.

Kur përplasim pëllëmbët dy herë, ata ndërpresin bisedën dhe fillojnë të lëvizin. Më pas, ulen në vendet e tyre dhe me radhë tregojnë se çfarë i ka thënë shoku-shokut për ujin dhe gjendjen agregate të tij. Ato i shkruajnë në tabelë, diskutojnë rreth tyre dhe ndalemi në çështjet kryesore.



LËNDËT DHE VETITË E TYRE

Te gazet grimcat janë të vendosura larg njëra-tjetres dhe janë të lidhura dobët mes vete, prandaj gazet nuk kanë formë dhe e ndryshojnë lehtë vëllimin.



Renditja e grimcave në një trup përcakton gjendjen agregate të tij



Materialet nga bota e gjallë dhe jo e gjallë

Materialet mund të klasifikohen sipas prejardhjes. Ato mund të kenë prejardhje nga natyra jo e gjallë dhe ajo e gjallë. Lëndët nga natyra e gjallë kanë prejardhje nga organizmat e gjallë (bimët, shtazët, kërpudhat dhe bakteret), ndërsa lëndët nga natyra jo e gjallë kanë prejardhje nga pjesa jo e gjallë e natyrës (p.sh.: toka, ajri, uji etj.).

Të mbajmë mend

- Klasifikimi i materialeve mund të bëhet në bazë të gjendjes agregate, origjinës apo edhe përbërjes së tyre.
- Vërejtje nga renditja e grimcave në një trup, materiali mund të jetë në gjendje agregate të ngurtë, të lëngët ose të gaztë.
- Materialet mund të kenë prejardhje nga natyra jo e gjallë dhe ajo e gjallë, ndërsa në bazë të përbërjes mund të jenë të pastra dhe të përziera.

Materialet mund të klasifikohen edhe sipas përbërjes së tyre. Në mësimin e mëhershëm, mësuar që materialet mund të përbëhen nga një material (materiale të pastra) ose nga dy e më shumë materiale (materiale të përziera).

Pyetje


1. Si mund të klasifikohen materialet?
2. Shpjego se çfarë përcakton renditja e grimcave në një trup.
3. Trego natyrën e prejardhjes së materialeve.

Materia, vetitë dhe shndërrimet



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Harta e konceptit**

U kërkohet nxënësve t'i hapin librat dhe ta lexojnë tekstin. Më pas, u kërkohet nxënësve të ndahen në dyshe dhe të fillojnë ta punojnë hartën e konceptit.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Shkrim i shpejtë**

Nxënësve u tregohen disa mënyra se si ndërrohet gjendja agregate e ujit. Ata punojnë në mënyrë individuale për rreth 5-7 minuta. Veçojmë disa prej tyre dhe i shkruajmë në tabelë. Në fund, vizatojmë gjendjet agregate të ujit, duke u bazuar në libër.

Gjendjet agregate të ujit



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim, për përshkrimin dhe identifikimin e gjendjes agregate të ujit.

Detyrë:

Përgjigjiuni pyetjeve në libër, në faqen 11.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Përshkruan tri gjendjet agregate të ujit;

Kupton gjendjet agregate të ujit.

Kontributi në rezultatet për kompetencat

kryesore të shkallës: II.2, II.6, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së

kurrikulës: 1.1, 1.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Gjendjet agregate të ujit - fletore pune

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Diskuton rreth gjendjes agregate të ujit;
- Përforcon njohuritë e marra.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto, projektori etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë amtare, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësve


Përmbledhje e strukturuar

Paraqesim para klasës pamje të tri gjendjeve agregate të ujit dhe ngjallim kureshtjen e tyre duke parash-truar pyetje:

Çfarë paraqesin ato?

Çfarë kemi mësuar për gjendjet agregate të ujit?

Bëjmë një përmbledhje të shkurtër, duke përsëritur atë se çfarë dimë për ujin dhe gjendjen agregate të tij.



1.4. GJENDJET AGREGATE TË UJIT

1. Cilat janë tri gjendjet agregate të ujit? Shënoji në vendet e zbrazëta në figurën më poshtë.



2. Ta bëjmë një eksperiment me ujin!

Shembulli 1:
Merr një enë me ujë e vëre mbi shporet dhe lëre ujin të vlojë, pastaj përcille me vëmendje ngritjen e avullit. Me termometër matë temperaturën. (Vetëm në prani të mësueses/it në shkollë ose prindërve në shtëpi.)



Bisedoni me mësuesen/in në klasë dhe rrethoni përgjigjet e sakta: Uji vlon në temperaturë prej: a) 0 °C, b) 100 °C, c) 2 °C. Kur uji avullohet, kalon në gjendje: a) të ngurtë; b) të lëngët; c) të gaztë.

Shembulli 2:




Mbusheni enën me ujë dhe vendoseni në frigorifer.

3. Bisedoni me mësuesen/in në klasë dhe rrethoni përgjigjet e sakta:

Në temperaturën a) 5 °C, b) 1 °C, c) -2 °C uji ngrihet dhe bëhet _____.

1.4. GJENDJET AGREGATE TË UJIT

1. Cilat janë tri gjendjet agregate të ujit? Shënoji në vendet e zbrazëta në figurën më poshtë.



2. Ta bëjmë një eksperiment me ujin!

Shembulli 1:
Merre një enë me ujë e vëre mbi shporet dhe lëre ujin të vlojë, pastaj përcille me vëmendje ngritjen e avullit. Me termometër mate temperaturën. (Vetëm në prani të mësueses/fit në shkollë ose prindërve në shtëpi.)



Bisedoni me mësuesen/in në klasë dhe rrethoni përgjigjet e sakta: Uji vlon në temperaturë prej: a) 0°C, b) 100°C, c) 2°C. Kur uji avullohet, kalon në gjendje: a) të ngurtë; b) të lëngët; c) të gaztë.

Shembulli 2:



Mbusheni enën me ujë dhe vendoseni në frigorifer.

3. Bisedoni me mësuesen/in në klasë dhe rrethoni përgjigjet e sakta:

Në temperaturën a) 5°C, b) 1°C, c) -2°C uji ngrihet dhe bëhet _____.

Materia, vetitë dhe shndërrimet



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Pyetja sjell pyetjen

U kërkohet nxënësve t'i hapin librat dhe ta lexojnë tekstin. Më pas, u kërkohet nxënësve të ndahen në dyshe dhe të fillojnë ta punojnë hartën e konceptit.


?	+	=
Çfarë mësojmë në këtë moment?	Çfarë di që më parë rreth kësaj?	Marrëdhënia shkak-pasojë e mundshme
Cilat janë gjendjet agregate të ujit?	Uji në natyrë gjendet në tri gjendje agregate: të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë.	Shkaku - ndryshimi i temperaturës. Pasojë - qarkullimi i ujit.



Përfundimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Rrjeti i diskutimit

Në mes të tabelës shkruajmë pyetje. U kërkohet nxënësve të ndahen në dyshe dhe të japin argumentet e tyre për pyetjen e dhënë.

Në fund, kërkojmë nga nxënësit t'i hapin librat dhe të fillojnë të plotësojnë në fletore pune, faqe 9.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përfundimin dhe diskutimin e njohurive të marra.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Kupton gjendjen e gaztë të ujit, përmes ciklit në natyrë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, II.6, III.1, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Cikli i ujit në natyrë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Analizon qarkullimin e ujit në natyrë;
- Përshkruan me fjalë ciklin e ujit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, qese plastike, marker, ujë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Edukatë figurative, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Nxënësit i mbyllin sytë dhe dëgjojnë me vëmendje: “Pa mua Toka do të dukej si Hëna. Unë jam i pastër, jam pa ngjyrë, pa erë dhe pa shije. Unë përbëj më shumë se gjysmën e trupit tënd. Unë mbuloj $\frac{3}{4}$ e Tokës. Unë bie nga qielli. Çfarë jam unë?”

Nxitim diskutimin duke bërë pyetje:

Ku shohim ujë?

Çka mendoni ju, si do të ishte jeta në tokë pa ujë?

Pse duhet ta kursejmë ujin?

Si mendoni, a kanë qasje në ujë të pijshëm krejt fëmijët e botës? Nëse jo, si mund t’i ndihmojmë ata?

UJI DHE GJENDJET AGREGATE TË TIJ


1.5. CIKLI I UJIT NË NATYRË

Fjalët kyçe

cikli i ujit, avulli.

Në natyrë, uji vazhdimisht kalon nga një gjendje agregate në tjetrën. Dielli e ngroh ujin në oqeanë, liqene dhe lumenj, si dhe nga toka e lagësht dhe e avullon atë. Avulli ngrihet lart në atmosferë, sepse është më i lehtë se ajri. Kur ngrihet lart, avulli bie në kontakt me shtresa të ftohta të ajrit.

Kjo bën që avulli të lëngëzohet në pika të shiut. Kur pikat e ujit kalojnë përmes ajrit, temperatura e të cilët është nën zero, uji ngrihet dhe formohen fjalat e borës. Bora pastaj në tokë shkrihet në ujë të lëngshëm. Uji, përmes lumenjve, shkon përsëri në liqene, dete dhe oqeanë nga ku përsëri avullohet dhe ky proces përsëritet vazhdimisht në formë cikli.



Analizoni figurën dhe bisedoni me mësuesin/in për format e kalimit të ujit nga një gjendje në gjendjen tjetër. Shpjegoni se si ndodh kjo.

Të mbajmë mend

- Uji në natyrë vazhdimisht kalon nga një gjendje agregate në tjetrën.
- Dielli është ndikuesi i ciklit - qarkullimit të ujit në natyrë.

Pyetje

1. Përshkruaj ndikimin e diellit në qarkullimin e ujit në natyrë.
2. Si krijohen pikat e shiut dhe ato të borës?
3. Çfarë ndodh me reshjet (shiun, borën, breshrin etj.) kur bien në tokë?
4. Shpjego arsyen pse gjatë verës ka më pak ujë në lumenj dhe liqene.

Materia, vetitë dhe shndërrimet

1.5. CIKLI I UJIT NË NATYRË


Fjalët kyçe

cikli i ujit, avulli.

Në natyrë, uji vazhdimisht kalon nga një gjendje agregate në tjetrën. Dielli e ngroh ujin në oqeanë, liqene dhe lumenj, si dhe nga toka e lagësht dhe e avullon atë. Avulli ngrihet lart në atmosferë, sepse është më i lehtë se ajri. Kur ngrihet lart, avulli bie në kontakt me shtresa të ftohta të ajrit.

Kjo bën që avulli të lëngëzohet në pika të shiut. Kur pikat e ujit kalojnë përmes ajrit, temperatura e të cilit është nën zero, uji ngrihet dhe formohen fllorat e borës. Bora pastaj në tokë shkrirhet në ujë të lëngshëm. Uji, përmes lumenjve, shkon përsëri në liqene, dete dhe oqeanë nga ku përsëri avullohet dhe ky proces përsëritet vazhdimisht në formë cikli.

Analizoni figurën dhe bisedoni me mësuesin/in për format e kalimit të ujit nga një gjendje në gjendjen tjetër. Shpjegoni se si ndodh kjo.



Cikli i ujit në natyrë

Të mbajmë mend

- Uji në natyrë vazhdimisht kalon nga një gjendje agregate në tjetrën.
- Dielli është ndikuesi i ciklit - qarkullimit të ujit në natyrë.

Pyetje

1. Përshkruaj ndikimin e diellit në qarkullimin e ujit në natyrë.
2. Si krijohen pikat e shiut dhe ato të borës?
3. Çfarë ndodh me reshjet (shiu, borën, breshrin etj.) kur bien në tokë?
4. Shpjego arsyen pse gjatë verës ka më pak ujë në lumenj dhe liqene.

Materia, vetitë dhe shndërrimet



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

U kërkohet nxënësve t'i hapin librat dhe, për pak minuta, ta lexojnë tekstin.

Më pas, para tyre paraqesim një video ku tregohet cikli i ujit. Shpjegohet procesi i qarkullimit të ujit, duke përdorur termat si: ngrohja, avullimi, reshjet, grumbullimi.

<https://www.youtube.com/watch?v=ncORPos-DrjI>

Cikli i ujit



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Eksperiment

Në qese, nxënësit me anë të vizatimit paraqesin ciklin e ujit, duke vendosur diellin, retë dhe ujin në vendin e duhur në material. Më pas, e mbushim qesen me ujë, e mbyllim dhe e vendosim në dritare për ta ngrohur dielli. Nxënësit japin parashikime për rezu-

ltatet e eksperimentimit, duke u bazuar në njohuritë e fituara.

<https://www.youtube.com/watch?v=8pYsY0C5ymE>



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, në analizimin dhe përshkrimin e ciklit të ujit.

Detyrë:

Trego me fjalë të tua ciklin e ujit në natyrë dhe vizatoje.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

Mësimi | 10

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Kupton gjendjen e gaztë të ujit përmes ciklit në natyrë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, II.6, III.1, III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Cikli i ujit në natyrë - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon rëndësinë e ciklit të ujit;
- Shpjegon qarkullimin e ujit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Në mes të tabelës, shkruajmë titullin:


Avullimi	Pikat e ujit	Shiu
Temperatura	Cikli i ujit	Ajri
Retë		Uji

U kërkojmë nxënësve të mendojnë dhe të gjejnë sa më shumë fjalë që lidhen me temën dhe t'i shkruajnë në fletë. Fjalët do t'i lexojmë dhe do t'i shkruajmë në tabelë. Më pas, fillojmë të diskutojmë rreth fjalëve të shkruara, ku dhe zbulojmë se çfarë dimë për temën e lartpërmendur.

UJI DHE GJENDJET AGREGATE TË TIJ

1.5. CIKLI I UJIT NË NATYRË


1. Plotëso, sipas numrave, tekstin për ciklin e ujit në natyrë.



2. Çka e ndihmon zhvillimin e ciklit të ujit në natyrë?

1.5. CIKLI I UJIT NË NATYRË

1. Plotëso, sipas numrave, tekstin për ciklin e ujit në natyrë.



2. Çka e ndihmon zhvillimin e ciklit të ujit në natyrë?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Lexim i drejtuar

Të ulur në çifte, kërkojmë nga nxënësit t'i dëgjojnë me vëmendje pjesët që do t'i lexojmë dhe, për t'i kuptuar fjalitë, japim edhe komente:

1. Po sikur pikëzat e ujit të flitnin, ato do të na tregonin neve për udhëtimet që ato bëjnë.

Koment: Trupat përbëhen nga grimcat më të vogla. Uji përbëhet nga pikat e ujit. Uji qarkullon në natyrë.

2. Rreth meje pashë edhe shumë shoqe të tjera, të cilat, ashtu si mua, i rrëmbeu era e ngrohtë dhe të gjitha nxitonin të ngjiteshin lart.

Koment: Kur uji nxehet (ngrohet), ai shndërrohet në avull. Pra, ai avullohet.

3. Dalëngadalë të ftohtët po bëhej gjithnjë e më i madh.

Komentet: Kur uji ftohet, ai kthehet në ujë.

4. Mirëpo, të bashkuar ajri nuk e mban dot.

Koment: Nga retë bie shi.

5. Në fillim si rrëke, më pas në përrua dhe... hop-hop në lumë.


Koment: Rrëketë e ujit bashkohen dhe formojnë përrenj, përrenjtë formojnë lumenj.

6. Vrapimi në lumë vazhdon, por, në fund, të gjitha erdhëm në det.

Koment: Lumenjtë derdhen në det.



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit



Kërkojmë nga nxënësit t'i hapin librat dhe të plotësojnë në fletore pune, faqe 10.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim, si dhe për shpjegimin e rëndësisë së ciklit të ujit.

Detyrë:

Përgjigjiuni pyetjeve në libër, faqe 12.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përmend rolin e ujit të pijshëm për organizmin e njeriut.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1,II.6,II.8,III.4,IV.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1,1.4,3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Uji dhe rëndësia e tij për organizmin e njeriut

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Vlerëson rolin e ujit;
- Tregon rëndësinë e ujit për njeriun.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Vendosim fotografinë e ujit në mes të tabelës dhe u kërkohet nxënësve që, për tri minuta, të shkruajnë se çfarë dinë për ujin. Më pas, fillojmë dhe diskutojmë për ujin dhe rëndësinë e ujit për organizmin tonë.



1.6. UJI DHE RËNDËSIA E TIJ PËR ORGANIZMIN E NJERIUT

Uji është i domosdoshëm për funksionimin normal të organizmit. Rreth 70% e trupit tonë përbëhet nga uji. Ai gjendet në të gjitha organet tona: në gjak, në muskuj, po ashtu edhe në eshtra. Njeriut gjatë ditës i nevojiten 1 deri 1,5 litra ujë e nganjëherë edhe më shumë, varësisht prej aktivitetit fizik dhe temperaturës së mjedisit të jashtëm.

Fjalët kyçe
uji, organizmi, trupi, rëndësia.

Kur jemi duke punuar ose gjatë aktiviteteve sportive, kemi nevojë më shumë për ujë. Atë e marrim duke pirë ujë dhe përmes ushqimit. Gjaku i njeriut më së shumti përbëhet prej ujit dhe ai qarkullon pandërprerë nëpër trupin tonë, të cilin edhe e ushqen. Vazhdimisht ne e lirojmë ujin nga organizmi me urinim dhe djerstje. Gjatë lirimt të ujit, së bashku me të ne largojmë edhe helmët dhe produktet e panevojshme nga trupi ynë, pra, uji na ndihmon ta pastrojmë trupin.

Uji ndihmon:



- Tretjen
- Trurin
- Lëkurën
- Parandalimin e dhimbjeve të trupit dhe të kokës
- Energjinë
- Ushtrime më të mira

Rëndësia e ujit për organizmin

Çdoherë ne kemi nevojë për ujë. Përveç për pije, atë e përdorim edhe për larje, gatim dhe shumë gjëra të tjera, të cilat ndikojnë në vetë shëndetin e organizmit të njeriut.



Përdorimi i ujit për nevoja të ndryshme të njeriut

Të mbajmë mend

- Rreth 70% e trupit tonë përbëhet nga uji. Ai gjendet në të gjitha organet tona.
- Në ujë e lirojmë vazhdimisht nga organizmi me urinim dhe djersitje e së bashku me të largojmë nga trupi ynë edhe helmët dhe produktet e panevojshme.
- Përveç për pije, ujë e përdorim edhe për larje, gatim dhe shumë gjëra të tjera, të cilat ndikojnë në vetë shëndetin e organizmit të njeriut.

Detyrë: Bisedoni me shokët dhe shoqet e klasës, po edhe me mësuesen/in për rëndësinë e ujit, si dhe tregoni se nga vjen uji në shtëpinë/banesën tuaj.

Pyetje

1. Si e marrim ujin në organizëm?
2. Pse kemi nevojë më shumë për ujë gjatë verës?
3. Në çfarë mënyre e lirojmë ujin nga organizmi? Trego ku qëndron rëndësia e këtij lirimi.

Materia, vetitë dhe shndërrimet



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Udhëzuesit e të lexuarit ndërveprues

1. Fjala kryesore në leximin tuaj është rëndësia. Nxënësi A: Lexo me zë të lartë paragrafin 1 për grupin tënd.

Grupi: Vendosi çfarë do të thotë rëndësia e ujit dhe shkruaj atë. Çfarë është rëndësia e ujit për organizmin tonë, sipas paragrafit 1?

2. Paragrafi dy flet pse na nevojitet uji.

Grupi: Pa zë lexoni këtë paragraf dhe gjeni pse kemi nevojë më shumë për ujë gjatë verës?

3. Paragrafi tre është thelbi kryesor i artikullit tuaj. Nxënësi B: Lexo me zë të lartë paragrafin tre për grupin tënd.

Grupi: Çdoherë ne kemi nevojë për ujë. Përveç për pije, atë e përdorim edhe për larje, gatim dhe shumë gjëra të tjera, të cilat ndikojnë në vetë shëndetin e organizmit të njeriut.



Përforsimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Në fund, plotësojmë detyrën e dhënë në libër.

Detyrë: Bisedoni me shokët dhe shoqet e klasës, po edhe me mësuesen/in për rëndësinë e ujit, si dhe tregoni se nga vjen uji në shtëpinë/banesën tuaj.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim, për përshkrimin e rëndësisë që ka uji për njeriun.

Detyrë:

Si furnizohet me ujë qyteti apo fshati ku jetoni? Tregoni rrugën që përshkon uji.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përmend rolin e ujit të pijshëm për organizmin e njeriut.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, II.1, II.6, II.8, IV.2, V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1, 1.4, 3.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Uji dhe rëndësia e tij për organizmin e njeriut – fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përforcon njohuritë e marra;
- Ilustron rëndësinë e ujit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hamer, marker etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Harta e konceptit

Paraqesim para nxënësve një gotë me ujë dhe u kërkojmë që, të ndarë në dyshe, të krijojnë një hartë koncepti mbi ato që dinë për ujin dhe rëndësinë që ai ka për jetën tonë.



1.6. UJI DHE RËNDËSIA E TIJ PËR ORGANIZMIN E NJERIUT

1. Sa është sasia e ujit në trupin tonë?



2. Çfarë sasive e ujit i nevojitet njeriut gjatë ditës?

3. Përveç për pije, për çka tjetër e përdorim ujin?

4. Dihet se pa ujë nuk ka jetë. Secili prej nesh mund të bëjë diçka për ruajtjen e ujit. Bisedo në klasë me shokët dhe shoqet, si dhe në shtëpi me prindërit, se si mund ta kursejmë ujin. Shëno më poshtë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Ruaje fjalën e fundit për mua

Ndajmë nxënësit në grupe. Kërkohet nga nxënësit të krijojnë nga një mesazh për ujin dhe rëndësinë e tij për organizmin tonë. Atë do ta shkruajnë në një fletë. Në anën tjetër të fletës, çdo anëtar i grupit do të shkruajë nga një koment për këtë mesazh. Pra, nxënësi i parë e lexon mesazhin dhe nuk ka të drejtë ta komentojë atë përderisa të gjithë anëtarët e tjerë të grupit japin mendimet ose komentet e tyre. Nxënësi i parë lexon komentin e tij, pra, ka fjalën e fundit në diskutim. Kështu vazhdohet me radhë me të gjitha grupet.

Ja disa nga mesazhet e mundshme:

- Uji është i rëndësishëm për jetën;
- Mbrojeni ujin, ai u përket të gjithëve;
- Kujdesi për ujin është kujdes për jetën.




Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Në fund, shpërndajmë materialet te secili grup dhe u kërkojmë që në grupe të punojnë nga një poster me mesazhet e zgjedhura dhe ata postera do të përdoren

për ta informuar rrethin tuaj për ujin dhe rëndësinë e tij për organizmin e njeriut.

U kërkujmë nxënësve t'i hapin librat dhe të fillojnë të plotësojnë në fletore pune, faqe 11.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për pjesëmarrje aktive në diskutim, për përshkrimin e rëndësisë që ka uji për njeriun.

Detyrë:

Trego tri mënyra se si mund ta kursesh ujin.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Përshkruan matjen e temperaturës me termometër.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4, II.7, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4, 2.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Temperatura

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Shpjegon mënyrën e funksionimit të termometrit;
- Identifikon llojet e termometrave;
- Analizon eksperimentin e bërë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Termometër mjekësor, gotë me ujë etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Matematikë, Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:


Përgatitja për të nxënësit

Fillojmë duke pyetur nxënësit:

Kur ka qenë hera e fundit që e keni matur temperaturën e trupit?

Me çfarë e keni matur dhe a ju kujtohet sa ka qenë temperatura?


Në klasë, mësuesi apo mësuesja sjell termometrën me merkur dhe kërkon nga një nxënës që t'ia matë temperaturën trupore, duke treguar hap pas hapi se si matet temperatura dhe sa ka dalë temperatura e trupit të tij.



UJI DHE GJENDJET AGREGATE TË TIJ



Detyrë: Temperatura e ujit
Mjetet e nevojshme: gota dhe termometër uji.
Merr një termometër dhe një gotë të mbushur me ujë, mat temperaturën e ujit duke vendosur termometrin brenda gotës me ujë. Trego sa është temperatura e ujit.
Çfarë do të ndodhë nëse gotës i shtoni ujë të cilin e kemi mbajtur në frigorifer në temperaturë 0 °C. Shkruaj më poshtë rezultatin e arritur.



Uji në frigorifer

Të mbajmë mend

- Temperatura paraqet shkallën e nxehtësisë së trupit apo të atmosferës.
- Procesi i caktimit të temperaturës quhet matje e temperaturës.
- Për matjen e saktë të temperaturës përdoret termometri.

Pyetje

1. Çfarë paraqet temperatura?
2. Çfarë quhet matje e temperaturës dhe si quhet instrumenti që e bën këtë matje?
3. Ku gjejmë përdorim termometrat?

Materia, vetitë dhe shndërrimet

16



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive: Përpunimi i përmbajtjes Mësimdhënia e ndërsjellë

U kërkohet nxënësve të ndahen në grupe, ku secili grup merr përsipër rolin e mësuesit dhe do të ketë 4 detyra:

1. Ta lexojë tekstin;
2. Ta përmbledhë atë që lexon;
3. Të bëjë pyetje për të;
4. T'i sqarojë fjalët e vështira.

Së bashku përcaktojmë pjesët e tekstit, duke ia ndarë secilit nga një pjesë: nxënësi i parë - temperatura, i dyti - termometri e kështu me radhë.

Shembull:

1. Temperatura paraqet shkallën e nxehtësisë së trupit apo të atmosferës.
2. Procesi i caktimit të temperaturës quhet matje e temperaturës.
3. Ku gjejmë përdorim termometrat?
4. Sqarojmë fjalët e vështira.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit


Më pas u kërkohet nxënësve që përmbledhjen ta bëjë secili grup, duke treguar të përbashkëtat dhe dallimet në mes të termometrave. Plotësojmë detyrën në libër:



Detyrë: Temperatura e ujit
Mjetet e nevojshme: gota dhe termometër uji.
Merr një termometër dhe një gotë të mbushur me ujë, mat temperaturën e ujit duke vendosur termometrin brenda gotës me ujë. Trego sa është temperatura e ujit.
Çfarë do të ndodhë nëse gotës i shtoni ujë të cilin e kemi mbajtur në frigorifer në temperaturë 0 °C. Shkruaj më poshtë rezultatin e arritur.

Termometri mjekësor

Termometri meteorologjik



Të përbashkëtat

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në identifikimin e termometrave dhe shpjegimin e tij, si dhe analizimin e eksperimentit të bërë në klasë.

Detyrë:

Përgjigjiuni pyetjeve në libër, faqe 16.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënësve të temës:

Përshkruan matjen e temperaturës me termometër.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4, II.7, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.4, 2.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Temperatura – fletore pune

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Argumenton ndikimin e temperaturës në eksperimentet e bëra;
- Përshkruan rëndësinë e temperaturës;
- Përforcojmë njohuritë e marra.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Enë, lugë druri dhe metali etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Matematikë, Gjuhë amtare.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Marrim një enë me ujë të nxehtë (të sapovluar) dhe në të vendosim një lugë druri dhe një lugë metalike. I lëmë në ujë për 1 minutë. Ftojme një nga nxënësit që t'i prekë lugët dhe t'i krahasojë mes vete. Pyesim: Cila lugë është më e nxehtë?

Çfarë ka ndodhur, pse luga metalike është më e nxehtë se ajo e drurit? (Materialet e përbëra nga metali e përcjellin më shpejt nxehtësinë në krahasim me ato të drurit.)

Bëjmë një përmbledhje të shkurtër duke pyetur:

- Çfarë ndodh me ujin kur vendoset në temperatura të larta?
- Çfarë ndodh me makaronat kur i vëmë të zihen?

Vijmë në përfundim se trupat në natyrë, kur u nështrohen temperaturave të larta, mund ta ndryshojnë formën.

UJI DHE GJENDJET AGREGATE TË TIJ

1.7. TEMPERATURA

1. Me çka matet temperatura?

2. Si mund të informohemi në për motin dhe temperaturën? Shëno emrat e figurave.



3. Përcille motin e vendbanimit tënd gjatë javës dhe përshkruaje atë.

Vendbanimi	E hënë:

	E martë: _____
	E mërkurë: _____
Data	E enjte:

	E premte: _____
	E shtunë: _____
	E diel: _____

1.7. TEMPERATURA

1. Me çka matet temperatura?

2. Si mund të informohemi ne për motin dhe temperaturën? Shëno emrat e figurave.



3. Përcille motin e vendbanimit tënd gjatë javës dhe përshkruaje atë.

Vendbanimi	E hënë:

	E martë:

	E mërkurë:

Data	E enjte:

	E premte:

	E shtunë:

	E diel:



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

U kërkojmë nxënësve t'i hapin librat dhe fillojnë të plotësojnë në fletore pune, faqe 12.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Eksperiment

Marrim tri gota qelqi. (Është mirë ta përdorim qelqin nëse dëshirojmë një material që përçon mirë temperaturën.) Mbushni një gotë me ujë të nxehtë. Duhet të jetë i nxehtë, por jo aq i nxehtë sa për t'ju djegur. Gotën tjetër e mbushim me ujë në temperaturë dhome dhe gotën e tretë me ujë të ftohtë, duke përdorur akull. Më pas, ftohen nxë-nësit me radhë që të vendosin një dorë në gotën e nxehtë dhe tjetër dorë në gotën e ftohtë. Nxënësi duhet të sigurohet që e gjithë pëllëmba e dorës së tij ta prekë gotën, në mënyrë që ai të mund ta ndiejë temperaturën përmes lëkurës së tij. Lini nxënësit ta mbajnë secilën gotë për një minutë. Pas një minute, kërkonin nga ta që ta kapin gotën e temperaturës së dhomës me të dyja duart. Përsëri, sigurohuni që pëllëmbët e tyre të prekin sa më shumë qelq të jetë e mundur. U kërkojmë nxënësve t'i kushtojnë vëmendje duarve të tyre. Si duket gota e tretë për secilën dorë?



A ndihet temperatura e njëjtë me të dyja duart?

Nxënësit do të vërejnë se gota e tretë ndihet më e ftohtë për dorën, fillimisht në prekin e ujit të nxehtë, dhe më e ngrohtë për dorën, duke prekur fillimisht ujin e ftohtë.

Si përfundim: shqisa e të prekurit nuk na tregon temperaturën e saktë. Për këtë përdoret termometri.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për angazhimin në diskutim dhe për analizimin e eksperimenteve të bëra.

Detyrë:

Plotësojnë detyrën e 3-të në fletore pune, faqe 12, duke përcjellë motin gjatë një jave.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për përbërësit kryesorë të ajrit dhe për rolin e oksigjenit në frymëmarrje.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, II.6, III.1, III.4, VI.2, IV.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përbërësit e ajrit dhe roli i oksigjenit në frymëmarrje

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon përbërësit e ajrit;
- Përshkruan rolin e ajrit për jetën e njeriut;
- Strukturon informacionet në tabelë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

DI

Në fazën e parë të mësimt, nxënësit do ta plotësojnë kolonën DI me njohuritë që kanë rreth ajrit. Formojmë 4 grupe me nga 4 nxënës, u shpërndajmë fletët e bardha, të ndara në tri kolona sipas rendit. Përmbledhim atë se çfarë është shkruar në rubrikë.


DI	DUA TË DI	MËSOVA
Ajri është i padukshëm. Praninë e tij e ndiejmë kur fryn era.		

1.8. PËRBËRËSIT E AJRIT DHE ROLI I OKSIGJENIT NË FRYMËMARRJE

Ajri është gjithkund rreth nesh i pranishëm, edhe pse ne nuk e dallojmë, sepse ajrin nuk e shohim, nuk e dëgjojmë, nuk ka shije dhe nuk mund ta prekim ose kapim me dorë. Edhe pse ajri është i padukshëm, atë mund ta vëreni nëse ju e fryni një çamçakëz ose bëni një balonë.

Fjalët kyçe

ajri, oksigjeni, azoti, dyoksid karboni.



Fryja e balonës

Fryja e çamçakëzit

Përbërësit e ajrit

Ajri është përzierje e gazeve të ndryshme që rrethon planetin Tokë. Përbërësit kryesorë të ajrit janë: oksigjeni, azoti, dyoksid karboni, avulli i ujit. Gazet janë shumë të rëndësishme për jetën e organizmave të gjallë dhe pa to nuk mund të ketë jetë.

Azoti është përbërësi kryesor i ajrit (78%). Ai luan një rol kryesor në rritjen e bimëve, por është i domosdoshëm edhe për kafshët. Bimët e marrin azotin nga toka, ndërsa njerëzit dhe kafshët e marrin nga bimët përmes ushqimit.

Oksigjeni përbën rreth 21% të ajrit. Në natyrë ai prodhohet nga bimët, ndërsa kafshët e marrin përmes procesit të frymëmarrjes. Oksigjeni u ndihmon trupave tanë të lirojnë energjinë nga ushqimi, pastaj këtë energji trupi e përdor për të kryer funksionet e veta. Pa oksigjen organizmat vdesin brenda pak minutave.

Dyoksidi i karbonit është në sasi të vogël (0.038%) në ajër. Prodhohet gjatë frymëmarrjes së bimëve, shtazëve, njeriut dhe nga djegia e karburanteve (thëngjillit, naftës, benzinës) etj. Dyoksidi i karbonit është i domosdoshëm për bimët. Bimët e marrin atë dhe prej tij krijojnë ushqim.

Materia, vetitë dhe shndërrimet

UJI DHE GJENDJET AGREGATE TË TIJ



Përbërësit e ajrit

Roli i oksigjenit në frymëmarrje

Njeriu mund të jetojë disa javë pa ushqim dhe deri në tri ditë pa ujë, por pa ajër njeriu mund të mbijetojë vetëm pak minuta. Për këtë arsye, ne duhet të thithim ajër pandërprerë, në të cilin gjendet oksigjeni.



Frymëmarrja

Të mbajmë mend

- Ajrin nuk e shohim, nuk e dëgjojmë, nuk ka shije dhe nuk mund ta prekim ose kapim me dorë.
- Përbërësit kryesorë të ajrit janë: oksigjeni, azoti, dyoksid karboni.
- Pa ajër organizmi i njeriut nuk mund të ekzistojë. Pa të organizmi ynë vdes brenda pak minutash.

Pyetje

- Ajrin nuk e shohim, nuk e dëgjojmë, nuk ka shije dhe nuk mund ta prekim ose kapim me dorë. Trego me shembullin lart si mund ta vëreni atë.
- Shëno përbërësit kryesorë të ajrit.
- Pa cilin përbërës të ajrit njeriu dhe shumë organizma të tjerë mund të mbijetojnë për pak minuta?

Materia, vetitë dhe shndërrimet



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
DUA TË DI

Nxënësit vazhdojnë të qëndrojnë në grupe. Lexojnë me kujdes tekstin dhe ndërtojnë pyetjet që plotësojnë rubrikën DUA TË DI.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
	Çfarë është ajri? Cilët janë përbërësit e ajrit? Pa çka nuk mund të jetojë njeriu?	



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
MËSOVA

Së bashku, plotësojmë rubrikën MËSOVA.

DI	DUA TË DI	MËSOVA
		Ajri është përzierje e gazeve të ndryshme që rrethojnë planetin Tokë. Përbërësit kryesorë të ajrit janë: oksigjeni, azoti, dyoksid karboni. Njeriu mund të jetojë disa javë pa ushqim dhe deri në tri ditë pa ujë, por pa ajër njeriu mund të mbijetojë vetëm pak minuta.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë në identifikimin e përbërësve të ajrit, në strukturimin e saktë të informacioneve në tabelë, si dhe në përshkrimin e rolit të tij për jetën e njeriut.

Detyrë:

Argumento rëndësinë që ka oksigjeni për jetën e njerëzve. Sill shembuj nga jeta e përditshme.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Lëndët dhe vetitë e tyre

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për përbërësit kryesorë të ajrit dhe për rolin e oksigjenit në frymëmarrje.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, II.6, III.1, III.4, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5, 3.4.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përbërësit e ajrit dhe roli i oksigjenit në frymëmarrje – fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon rëndësinë e oksigjenit;
- Argumenton ndikimin e ajrit në eksperiment;
- Përforcon njohuritë e marra.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Qirinj, enë etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Dy gënjeshttra dhe një e vërtetë


U kërkojmë nxënësve të ndahen në 4 grupe të mëdha.

Grupi I - Në mënyrë individuale, do të shkruajnë në një fletë dy gënjeshttra dhe një të vërtetë për ajrin.

Grupi II- Në mënyrë individuale, do të shkruajnë në fletë dy gënjeshttra dhe një të vërtetë për përbërësit e ajrit.


Grupi III- Në mënyrë individuale, do të shkruajnë në fletë dy gënjeshttra dhe një të vërtetë për oksigjenin.

Më pas, ata do të lexojnë atë që kanë shkruar. Shokët do të diskutojnë për të gjetur cilat nga thëniet janë të vërteta, duke përsëritur mësimin e kaluar.



1.8. PËRBËRËSIT E AJRIT DHE ROLI I OKSIGJENIT NË FRYMËMARRJE


1. Cilët janë përbërësit kryesorë të ajrit?



2. Shkruaj për rolin e oksigjenit në frymëmarrje.

3. Eksperiment: A mundet një qiri të mbetet i ndezur dhe të ndriçojë pa ajër?

Këtë eksperiment mund ta bëni në prani të mësueses/it në klasë ose të prindërve në shtëpi. Për këtë ju duhet një qiri, një pjatë dhe një gotë. Kur ta ndizni qiriu, e vini gotën mbi të.




Çka do të ndodhë, a do të rrijë ende i ndezur qiri pas një kohe apo do të ndalet?
Tregoni rezultatit dhe shënoni pse ka ndodhur kjo.

Materia, vetitë dhe shndërrimet




Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Kërkojmë nga nxënësit që t'i hapin librat dhe t'i plotësojnë detyrat e dhëna. Më pas, së bashku bëjmë eksperimentin, për t'iu përgjigjur pyetjes: A mund të mbesë një qiri i ndezur dhe të ndriçojë pa ajër?



Përfundimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Rrjeti i diskutimit

Më pas, në tabelë paraqesim rrjetin e diskutimit, që në qendër ka pyetjen:



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për shpjegimin e rëndësisë së oksigjenit dhe argumentimin e eksperimenteve të bëra.

Detyrë:

Përgjigjuani pyetjeve në libër, faqe 18.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Kupton dhe interpreton rolin e ushqimit si burim energjie për funksionet jetësore të njeriut, si dhe rolin e ushqimit për jetë të shëndetshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.2, III.2, IV.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Ushqimi si burim i energjisë

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon rëndësinë e ushqimit në jetën tonë;
- Vlerëson përdorimin e shumëllojshëm dhe të rregullt të ushqimeve;
- Shpjegon shkaktarët që mund të helmojnë ushqimin.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4, mjete shkrimi, burime nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:


Përgatitja për të nxënësit

Pyetje - përgjigje

Pyeten nxënësit:

- Çka dini për ushqimin?
- Përse i shërben njeriut ushqimi?
- Si duhet të jetë ushqimi që ju hani?

Pranohen disa përgjigje, pavarësisht saktësisë së tyre, të cilat më pas plotësohen. Diskutohet me nxënësit rëndësia e ushqimit për funksionimin e trupit të njeriut.



Që të rritemi dhe t'i kryejmë aktivitetet tona, ne duhet të marrim ushqim të mjaftueshëm, cilësor dhe të llojlojshëm. Nëse nuk marrim ushqim të mjaftueshëm dhe cilësor, ne ndihemi të lodhur dhe sëmurëmi lehtë. Ushqimi duhet të jetë i pastër, pa helme dhe mikroba. Helmet dhe mikrobat, që gjenden në ushqim, po ashtu, shkaktojnë sëmundje.



Ushqimet e mykura dhe të prishura

**Pyetje**

1. Çfarë sigurojmë ne nga ushqimet për trupin tonë?
2. Shpjego çfarë mundëson ushqimi për trupin tonë.
3. Trego arsye pse duhet të marrim ushqim të mjaftueshëm, cilësor dhe të pastër.

Të mbajmë mend

- Nga ushqimi sigurojmë energjinë, që na mundëson të ecim, të luajmë, të mendojmë, të mësojmë etj.
- Ushqimin duhet ta marrim të mjaftueshëm, cilësor dhe të llojlojshëm.
- Ushqimi duhet të jetë i pastër, pa helme dhe mikroba.

BOTA E GJALLË

23



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Hulumtim, shqyrtim i përbashkët

Hapet libri dhe vëzhgohen figurat. Shpjegohet nevoja e njeriut për ushqim.

Përcaktohet roli i ushqimit në trupin e njeriut si më poshtë:

1. Nga ushqimi sigurojmë energjinë.
2. Energjia e ushqimit ia mundëson trupit të kryejë punë, të rritet dhe të jetë i shëndetshëm.
3. Ushqimi i shëndetshëm na ndihmon të përqendrohemi në mësim.
4. Ushqimi duhet të jetë i pastër, pa helme dhe mikroba.

Nxiten nxënësit të diskutojnë për rëndësinë e ushqimit për lojë dhe mësim.

Ata tregojnë nga përvoja e tyre se si ndihen kur janë të uritur dhe pas ngrënies. Theksohet domosdoshmëria e përdorimit të ushqimit të llojlojshëm dhe të pastër.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Pesëvargëshi

Kërkohet nga nxënësit të krijojnë një pesëvargësh me temë:

Ushqimi

Në rreshtin e parë e përshkruajnë ushqimin, duke përdorur dy mbiemra.

Në rreshtin e dytë tregojnë veprimin e ushqimit, duke përdorur tri folje.

Në rreshtin e tretë shkruajnë një fjali për rëndësinë e ushqimit.

Në rreshtin e fundit shkruajnë një sinonim për ushqimin.

Pasi të plotësohet pesëvargëshi, lexohen disa prej tyre. Vendosen në murin e klasës, që të lexohen nga të gjithë. Nxënësit vlerësohen me notë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përshkrimin e rëndësisë së ushqimit dhe për vlerësimin e përdorimit të ushqimit të llojlojshëm dhe të pastër.

Detyrë:

Të shkruajnë disa arsye përse duhet të marrim ushqim të mjaftueshëm, cilësor dhe të pastër.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Kupton dhe interpreton rolin e ushqimit si burim energjie për funksionet jetësore të njeriut, si dhe rolin e ushqimit për jetën e shëndetshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.4, IV.6, IV.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Ushqimi si burim i energjisë - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Liston ushqimet që i konsumon gjatë ditës;
- Shpjegon llojllojshmërinë e ushqimeve që i nevojiten atij për kryerjen e aktiviteteve;
- Harton dy-tri këshilla për kujdesin ndaj ushqimit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fruta të ndryshme, lëngje, ushqime të përgatitura në shtëpi, ngjyra, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Bashkëbisedim

Diskutohen me nxënësit detyrat e shtëpisë. Ata tregojnë arsyet përse duhet të marrim ushqim të mjaftueshëm, cilësor dhe të pastër. Mund të tregojnë raste nga përvoja e tyre ose që kanë dëgjuar në familje për sëmundjet që ju kanë ndodhur për shkak të ushqimit të prishur ose të papastër.

2.1. USHQIMI SI BURIM I ENERGJISË

1. Si duket plani i ushqimit tënd? Përkruaje në tabelën e mëposhtme.



Mëngjesi: _____
 Dreka: _____
 Darka: _____

2. Çfarë ushqime duhet të marrim për t'i kryer aktivitetet tona?

3. Plotëso fjalinë duke përdorur fjalët në kuti.

sëmundje, helmet, mikrobet

a) _____ dhe _____ që gjenden në ushqim shkaktojnë _____

2.1. USHQIMI SI BURIM I ENERGJISË

1. Si duket plani i ushqimit tënd? Përkrahje në tabelën e mëposhtme.



Mëngjesi: _____

Dreka: _____

Darka: _____

2. Çfarë ushqime duhet të marrim për t'i kryer aktivitetet tona?

3. Plotëso fjalinë duke përdorur fjalët në kuti.

sëmundje, helmet,
mikrobet

a) _____ dhe _____ që gjenden në ushqim
shkaktojnë _____

15

**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:****Përpunimi i përmbajtjes**

Veprimtari me lexim-mendim të drejtuar

Ushtrimi i parë: Lexohet kërkesa e ushtrimit të parë. Vëzhgohen dhe komentohen llojet e ushqimit. Nxënësit tregojnë disa ushqime që ata i konsumojnë gjatë ditës. Më pas, në fletore pune shkruajnë planin e ushqimit për mëngjes, drekë dhe darkë.

Ushtrimi i dytë:

- Çfarë ushqimesh duhet të marrim për t'i kryer aktivitetet ditore?

Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë llojin e ushqimeve që duhet të marrin për t'i kryer aktivitetet ditore.

Ushtrimi i tretë:

Plotësojnë ushtrimin me fjalët në kuti, të cilat mungojnë. Lexohen shkrimet e nxënësve, dy-tri variante për secilin ushtrim.

Theksohet se nga pakujdesitë e tyre rreth ushqyerjes, ju rrezikohet shëndeti. Shkruhen nga dy këshilla për kujdesin ndaj ushqimit, i cili duhet të jetë i pastër dhe cilësor.

**Përforsimi:****Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**

Lojë - gjëgjëzë

Përpara se t'i hanë frutat, nxënësit zhvillojnë një lojë - gjëgjëzë për të gjetur frutën që ka marrë shoku pranë. Ai u ndihmon duke u treguar formën, ngjyrën apo veti të tjera. Kujtohen ata se çfarë duhet të bëjnë në lidhje me higjienën.

Shkëmbejnë ushqime me njëri-tjetrin, duke treguar vlerat ushqimore të tyre.

Arrihet në përfundim se: energjia që i duhet njeriut për të kryer aktivitete, merret nga ushqimi.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në shpjegimin e llojllojshmërisë së ushqimit si burim energjie.

Detyrë:

Përgatit një shujtë mëngjesi dhe shpjego se cilat produkte ushqimore i ke përdorur.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon dhe përshkruan përbërësit kryesorë të ushqimit të njeriut (nutrientëve): ujin, sheqernat, yndyrat, proteinat, mineralet, vitaminat, përfshirë rolin e secilit nga ta për organizmin.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: III.1, IV.6, V.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përbërësit kryesorë të ushqimit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton përbërësit kryesorë të ushqimeve;
- Dallon ushqimet që janë të domosdoshme për rritje dhe zhvillim;
- Vlerëson përdorimin e shumëllojshëm dhe të rregullt të ushqimeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4 me alfabetin e njëpasnjëshëm, mjete shkrimi, fletore e nxënësit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Alfabeti i njëpasnjëshëm

U jepet nxënësve në grupe nga një fletë me alfabetin e njëpasnjëshëm (nga A - Zh). Nxënësit do të shkruajnë emra ushqimesh për çdo shkronjë. Nëse i mbarojnë shpejt, mund të kthehen përsëri për të shkruar më shumë se një fjalë. Lexohen fjalët sipas grupeve.

Pyeten nxënësit:

- Pse janë të rëndësishme ushqimet?
- Nga ndryshojnë ushqimet nga njëri-tjetri?
- A mund të grupohen ato dhe si?

NEVOJA E NJERIUT PËR USHQIM DHE HIGJENË PERSONALE

2.2. PËRBËRËSIT KRYESORË TË USHQIMIT

Fjalët kyçe
sheqernat, yndyrat, proteinat, vitaminat, mineralet.

Yndyrat gjenden në produktet shtazore (mishi, vezët, gjolpi, aqka, qumësht, djathi) dhe produktet bimore (ulliri, misri, luledielli, kikiriku etj.). Janë burim i rëndësishëm i energjisë.

Proteinat janë materiali kryesor ndërtues i trupit tonë dhe janë të domosdoshme për rritje. Ushqimet që kanë më së shumë proteina janë: mishi i vicit, mishi i shpendëve, peshku, qumështi dhe nënproduktet e tij (djathi, gjiza, kosi).

Mineralet janë të nevojshme në sasi të vogla, por të domosdoshme për trupin tonë. P.sh. kalciumi është i nevojshëm për rritjen e eshtrave dhe dhëmbëve, hekuri për transportimin e oksigjenit etj. Frutat dhe perimet janë të pasura me minerale.

Sheqernat (karbhidratet) janë burimi kryesor i energjisë për trupin tonë. Na mundësojnë që t'i kryejmë normalisht aktivitetet tona. Gjenden në bimë të ndryshme, si: grurë, oriz, miell, patate, si dhe produkte ushqimore që prodhohen prej tyre (bukë, makarona, biskota etj.).

Vitaminat nuk sigurojnë energji. Çdo vitaminë ka një funksion të veçantë në trupin tonë. Janë të rëndësishme sepse na mbrojnë nga sëmundjet. Me vitaminat janë të pasura frutat dhe perimet.

Të mbajmë mend

- Përbërësit kryesorë të ushqimeve janë: sheqernat, yndyrat, proteinat, vitaminat, mineralet dhe uji.
- Ushqimi që ne hamë duhet të jetë i mjaftueshëm, cilësor dhe i llojlojshëm. Nëse hamë vazhdimisht një lloj të ushqimit, rrezikojmë që të mbetemi pa ndonjërin prej përbërësve të ushqimit.

Pyetje

1. Emërto përbërësit kryesorë të ushqimeve.
2. Cilët nga përbërësit e ushqimeve janë material ndërtues i trupit tonë dhe janë të domosdoshëm për rritje?
3. Pse janë të rëndësishme vitaminat për trupin tonë? Tregoj ushqimet që janë të pasura me vitamina.

BOTA E GJALLË

24

2.2. PËRBËRËSIT KRYESORË TË USHQIMIT

Fjalët kyçe

sheqernat, yndyrat, proteinat, vitaminat, mineralet.

Yndyrat gjenden në produktet shtazore (mishi, vezët, gjalpi, oqja, qumështi, djathi) dhe produktet bimore (ulliri, misri, luledielli, kokërru etj.). Janë burim i rëndësishëm i energjisë.

Proteinat janë materiali kryesor ndërtues i trupit tonë dhe janë të domosdoshme për rritje. Ushqimet që kanë më së shumti proteina janë: mishi i vëçt, mishi i shpendëve, peshku, qumështi dhe nënproduktet e tij (djathi, gjiza, kasi).


Të mbajmë mend

- Përbërësit kryesorë të ushqimeve janë: sheqernat, yndyrat, proteinat, vitaminat, mineralet dhe uji.
- Ushqimi që ne hamë duhet të jetë i mjaftueshëm, cilësor dhe i llojllojshëm. Nëse hamë vazhdimisht një lloj të ushqimit, rrezikojmë që të mbetemi pa ndonjërin prej përbërësve të ushqimit.

BOTA E CJALLË

24

Ushqimi që ne hamë është i përbërë nga lëndë të ndryshme ushqyese. Grupet kryesore të lëndëve ushqyese janë sheqernat, yndyrat, proteinat, vitaminat, mineralet dhe uji. Mungesa e cilitdo prej këtyre përbërësve në ushqim mund të shkaktojë sëmundje. Secili produkt ushqimor ka sasi të caktuara të këtyre përbërësve. Prandaj, ushqimi që ne hamë duhet të jetë i mjaftueshëm, cilësor dhe i llojllojshëm. Nëse vazhdimisht hamë një lloj të ushqimit, rrezikojmë që të mbetemi pa ndonjërin prej përbërësve të ushqimit.



Sheqernat (karbohidratet) janë burimi kryesor i energjisë për trupin tonë. Na mundësojnë që t'i kryejmë normalisht aktivitetet tona. Gjenden në bimë të ndryshme, si grurë, oriz, misër, patate, si dhe produkte ushqimore që prodhohen prej tyre (bukë, makarona, biskota etj.).

Vitaminat nuk sigurojnë energji. Çdo vitaminë ka një funksion të veçantë në trupin tonë. Janë të rëndësishme sepse na mbrojnë nga sëmundjet. Me vitaminat janë të pasura frutat dhe perimet.

Mineralet janë të nevojshme në sasi të vogla, por të domosdoshme për trupin tonë. P.sh. kalciumi është i nevojshëm për rritjen e eshtrave dhe dhëmbëve, hekuri për transportimin e oksigjenit etj. Frutat dhe perimet janë të pasura me minerale.

Pyetje

1. Emërto përbërësit kryesorë të ushqimeve.
2. Cilët nga përbërësit e ushqimeve janë material ndërtues i trupit tonë dhe janë të domosdoshëm për rritje?
3. Pse janë të rëndësishme vitaminat për trupin tonë? Trego ushqimet që janë të pasura me vitamina.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes DI - DUA TË DI - MËSOVA

Te kolona e parë do të shkruajnë çfarë dinë për ushqimin, duke pasur parasysh dhe pyetjet e mësipërme.

Te kolona e dytë do të shkruajnë pyetjet që mund t'i kenë rreth ushqimeve.

Lexohen pyetjet që kanë shkruar nxënësit dhe ato që do të trajtohen në mësim shkruhen në tabelë.

Komentohen figurat e librit. Zhvillohet bashkëbisedim me nxënësit, për t'i trajtuar çështjet më të rëndësishme të mësimt. Pas shpjegimit dhe analizës së mësimt, plotësohen kolonat e tabelës. Në këtë fazë të orës, plotësohen dy kolonat e tabelës, ndërsa kolona e tretë plotësohet në fazën e tretë të orës.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit DI - DUA TË DI - MËSOVA

DI	DUA TË DI	MËSOVA
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pse janë të rëndësishme ushqimet? 2. A mund të grupohen ato dhe si? 3. Çfarë përmbajnë ushqimet? 4. A kanë të gjitha vlera të njëjta ushqimore? 5. Cilat ushqime janë më të shëndetshme? 6. Sa herë duhet të marrim ushqim gjatë ditës? 	<ol style="list-style-type: none"> 1. Ushqimet na rritin, na japin fuqi, na mbrojnë nga sëmundjet. 2. Ato ndahen: me prejardhje bimore dhe shtazore. 3. Ushqimet përmbajnë: karbohidrate, proteina, yndyra, vitamina, kripëra minerale. 4. Ushqime të ndryshme kanë vlera të ndryshme ushqimore. 5. Më të shëndetshme janë ushqimet me prejardhje bimore. 6. Është mirë që fëmijët të hanë 6 herë në ditë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për emërtimin e përbërësve kryesorë të ushqimit, si dhe për vlerësimin e përdorimit të ushqimit të llojllojshëm dhe të rregullt.

Detyrë:

Shkruajnë përgjigjet e pyetjeve të dhëna në libër, fq. 24.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon dhe përshkruan përbërësit kryesorë të ushqimit të njeriut (nutrientëve): ujin, sheqernat, yndyrat, proteinat, mineralet, vitaminat, përfshirë rolin e secilit nga ta për organizmin.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: III.1, IV.6, V.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përbërësit kryesorë të ushqimit - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon përbërësit kryesorë të ushqimit;
- Grupon ushqimet sipas përbërjes në pesë grupe kryesore;
- Argumenton rolin e ushqimit të shëndetshëm në organizëm.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kutitë ushqimesh të zbrazëta, figura me ushqime të prera nga gazetatat, mjete shkrimi, shumësia me ngjyra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake


Vendosen në tabelë ushqime të ndryshme dhe kërkohet nga nxënësit që t'i grupojnë ato ushqime sipas përmbajtjes. Shih tabelën më poshtë:

Yndyrat	Sheqernat	Vitaminat	Mineralet	Proteinat

NEVOJA E NJERIUT PËR USHQIM DHE HIGJENË PERSONALE

2.2. PËRBËRËSIT KRYESORË TË USHQIMIT

1. Në cilat grupe ndahen ushqimet? Plotëso vendet e zbrazëta në figurë.




2. Shkruaj fjalët në vendet e duhura.

- Proteinat
- Kalciumi
- Sheqernat
- Vitaminat
- Yndyrat

- a) _____ është i nevojshëm për rritjen e eshtrave dhe të dhëmbëve.
- b) _____ janë burimi kryesor i energjisë për trupin tonë.
- c) _____ janë të rëndësishme, sepse na mbrojnë nga sëmundjet.
- d) _____ janë materiali kryesor ndërtues i trupit tonë dhe janë të domosdoshme për rritje.
- e) _____ gjenden në produkte shtazore, si: mish, vezë, gjalpë, ajkë, qumësht, djathë dhe në produkte bimore, si: ullinj, misër, luledielli.

2.2. PËRBËRËSIT KRYESORË TË USHQIMIT

1. Në cilat grupe ndahen ushqimet? Plotëso vendet e zbrazëta në figurë.



2. Shkruaj fjalët në vendet e duhura.

Proteinat
Kalciumi
Sheqerant
Vitaminat
Yndyrat

- _____ është i nevojshëm për rritjen e eshtrave dhe të dhëmbëve.
- _____ janë burimi kryesor i energjisë për trupin tonë.
- _____ janë të rëndësishme, sepse na mbrojnë nga sëmundjet.
- _____ janë materiali kryesor ndërtues i trupit tonë dhe janë të domosdoshme për rritje.
- _____ gjenden në produkte shtazore, si: mish, vezë, gjalpë, ajkë, qumësht, djathë dhe në produkte bimore, si: ullinj, misër, luledielli.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Përmbledhje e strukturuar

Rëndësia:

Ai shërben për rritje, për t'i dhënë energji trupit, për t'u mbrojtur nga sëmundjet, për ta mbajtur ngrohtë trupin.

Çfarë përmban?

Karbohidrate, proteina, yndyra, vitamina, kripëra minerale, ujë.

Ushqimi

Si ndahet?

- Me prejardhje bimore;
- Me prejardhje shtazore.

Ushqimi më i shpeshtë:

me prejardhje bimore, fruta, perime.

Si duhet të konsumohet?

Ushqim i shumëllojshëm, sasia e duhur, ngrënie e shpeshtë, ushqim i freskët.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Rrjeti i diskutimit

Shkruhet pyetja në tabelë dhe nxënësit marrin një qëndrim të caktuar. Dëgjohen argumentet e kombinuara të secilës përgjigje (një PO, një JO).

PO

- Mua më shijojnë më shumë.
- Mendoj se kur ha me dëshirë diçka, të bëhet shëndet.
- Ne kemi të drejtat tona.
- Prindërit nuk e kuptojnë se çfarë na shijon më shumë.
- Atëherë pse tregtohen ato ushqime?

A duhet të hamë vetëm ushqimet që na pëlqejnë? Pse?

JO

- Fëmijëve iu pëlqejnë shumë ëmbëlsirat. Kur hahen me shumicë, ato dëmtojnë.
- Fëmijët nuk e kuptojnë rëndësinë e vërtetë të ushqimeve.
- Nuk mund të rregullojmë në të ardhmen problemet shëndetësore që kanë lidhje me ushqimin.
- Nuk kemi nevojë për shumë lloje lëndësh ushqyese.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në grupimin e ushqimeve sipas përmbajtjes dhe argumentimin e rolit të ushqimeve të shëndetshme.

Detyrë:

Të shkruajnë disa arsye përse duhen përdorur më shpesh ushqimet me prejardhje bimore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon dhe liston produktet ushqimore me bazë bimore dhe shtazore që përdor në jetën e përditshme, përfshirë ushqimet me shenjat *bio* dhe *eko*.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, IV.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Prejardhja e ushqimit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon ushqimet që përdor në menunë e tij ditore;
- Klasifikon ushqimet sipas prejardhjes;
- Krahason rëndësinë që ka konsumimi i ushqimit me prejardhje bimore me atë me prejardhje shtazore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, laptop, fletë A4, mjete shkrimi, fletore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Pyetje - përgjegje

Ju prezantohet nxënësve një video lidhur me ushqimin, në këtë link <https://youtu.be/YJhbëMXG27s>, ku tregohet prejardhja e ushqimit që konsumojnë në jetën e përditshme.

Pas shikimit të videos, diskutohet për rëndësinë e ushqimit për trupin e njeriut, si dhe për prejardhjen e tij. Pyeten nxënësit:

2.3. PREJARDHJA E USHQIMIT


Ushqimi mund të ketë prejardhje bimore dhe shtazore. Disa bimë mund të përdoren si të freskëta për ushqim (p.sh., frutat, perimet etj.), ndërsa të tjerat përpunohen para se të përdoren (gruri, patatet, orizi etj.). Nga bimët nxirren edhe shumë prodhime të tjera ushqimore, si p.sh., vajli i luledielli, i misrit, i ullirit, i kikirikut, pastaj reçelrat, marmelata etj. Bimët që më së shpeshti përdoren për ushqim janë: gruri, orizi, patatet, fasulja, frutat, perimet etj. Përpos bimëve, ne një pjesë të ushqimit e marrim edhe nga kafshët. Ushqimet më të shpeshta që marrim nga kafshët janë: mishi (i pulës, viçit, peshkut), qumështi, vezët etj. Qumështi mund të përpunohet dhe nga ai të përtohen prodhime të tjera, si: kosi, djathi, maza etj.

Fjalët kyçe

prejardhja, bimore, shtazore.



Detyrë: Shëno në tabelë ushqimet që ke ngrënë gjatë javës. Bisedo me shokët dhe shoqet se cila është prejardhja e tyre dhe si përgatiten ato.



Të mbajmë mend

- Ushqimi mund të ketë prejardhje bimore dhe shtazore.
- Bimët, siç janë frutat, perimet etj, mund të përdoren si të freskëta, por edhe si të përpunuara.
- Ushqimet që marrim nga kafshët kryesisht përpunohen dhe gatohen.

Pyetje

1. Nga e ka prejardhjen ushqimi?
2. Shëno disa nga prodhimet që përfitohen nga bimët.
3. Identifiko disa nga ushqimet më të shpeshta që marrim nga kafshët.

- Nga e marrim ushqimin?
- Cilat ushqime marrim nga bimët?
- Çfarë marrim nga kafshët?
- Pse duhet të marrim ushqim të llojllojshëm?



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Ditari dypjesësh**

Lexohet materiali i paraqitur në tekst. Pas leximit, diskutohet për çështjet më thelbësore të mësimit dhe komentohen figurat e librit. Ndahen ushqimet në dy grupe, sipas prejardhjes, së bashku me nxënësit në tabelë.

Ushqime me prejardhje bimore	Ushqime me prejardhje shtazore
1. Frutat	1. Mishi



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Shkrim i shpejtë**

Nxiten nxënësit të shkruajnë në fletoret e tyre për ushqimet që janë pjesë e menisë së tyre ditore, si dhe prejardhjen e ushqimeve që ata konsumojnë.

Shtrohet pyetja:

A konsumoni më tepër ushqime me prejardhje bimore apo shtazore?

Nxënësit numërojnë produktet ushqimore që ata konsumojnë dhe secili tregon përfundimet e nxjerra.

Arrihet në përfundim që:

Ushqimet me prejardhje bimore janë më të shëndetshme dhe duhen konsumuar më shpesh, ndërsa ushqimet me prejardhje shtazore duhen konsumuar më rrallë.

Vlerësohen nxënësit me notë për veprimtaritë e kryera.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në klasifikimin e produkteve bimore dhe shtazore, si dhe krahasimin e vlerës së tyre për organizmin.

Detyrë:

T'i shkruajë përgjigjet e pyetjeve në faqen 26.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon dhe liston produktet ushqimore me bazë bimore dhe shtazore që përdor në jetën e përditshme, përfshirë ushqimet me shenjat *bio* dhe *eko*.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, IV.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Prejardhja e ushqimit - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon prodhimet bimore nga ato shtazore;
- Shpjegon mënyrën e përpunimit të qumështit;
- Argumenton arsyen e përdorimit të bimëve në jetën e përditshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografi të bimëve të prera, prodhime shtazore dhe prodhime bimore të prera, kuti ushqimesh, fletë A4, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Paraqiten para nxënësve figura të bimëve të prera. Kërkohet nga nxënësit të identifikojnë bimët që i përdorin në jetën e përditshme. Nxiten të emërtojnë lloje të bimëve që ata i përdorin dhe i njohin. Pyeten nxënësit:

- Cilat lloje të bimëve i njihni?
- Pse përdoren ato?
- Pse duhet të përdorim më shumë prodhime bimore sesa shtazore?



2.3. PREJARDHJA E USHQIMIT

1. Shëno në tabelë prodhimet bimore dhe shtazore.

Prodhimet bimore	Prodhimet shtazore

2. Cilat produkte i përfitojmë nga përpunimi i qumështit?

3. Shëno bimët që më së shpeshti i përdorim në jetën e përditshme për ushqim.

BOTA E GJALLË

17

**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:****Përpunimi i përmbajtjes***Hulumtim - shqyrtim i përbashkët*

Ndahet klasa në grupe. Secili grup pajiset me kutitë e ushqimeve, laptopë dhe libra të ndryshëm. Kërkohe t'i hapin fletoret e punës, faqe 17.

Ushtrimi 1: Kërkohe të grupojnë prodhimet bimore dhe prodhimet shtazore. Nxënësit në grupe gjejnë informacione dhe plotësojnë në tabelë ushtrimin.

Ushtrimi 2: Kërkohe t'i shënojnë produktet që përfitohen nga prodhimi i qumështit. Marrin të dhëna nga interneti, të cilat i plotësojnë njohuritë e tyre.

Ushtrimi 3: Kërkohe t'i shënojnë bimët që më së shpeshti përdoren në jetën e përditshme për ushqim.

Pasi përfundojnë ushtrimet në grupe, nga një përfaqësues i secilit grup prezanton veprimtarinë para klasës.

**Përforcimi:****Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit***Sistemi ndërveprues i shënimeve*

Kërkohe nga nxënësit ta vlerësojnë të ushqyerit e tyre, duke shkruar dy gjëra të shëndetshme që ata konsumojnë dhe dy gjëra të pashëndetshme. Për

shembull: *Unë ha shumë fruta ose Unë pi ujë çdo vakt, Mua më pëlqejnë ëmbëlsirat.* Më pas, kërkohe prej tyre të shkruajnë fjali që fillojnë me: *Unë do të...*, për të treguar synimet e tyre për të ardhmen.

Për shembull: *Unë do të ha më pak ëmbëlsira ose Unë do të ha fruta të freskëta çdo ditë.*

Kontrollohen për veprimtarinë e kryer dhe vlerësohen me notë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në dallimin e produkteve bimore dhe shtazore dhe për argumentimin e arsyes së përdorimit të produkteve bimore më shpesh se atyre shtazore.

Detyrë:

Të shënojnë shujtat dhe meshujtat për disa ditë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Hulumton dhe dallon produktet ushqimore të shëndetshme dhe ato jo të shëndetshme për moshën specifike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, II.4, IV.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushqimi i shëndetshëm

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan produktet ushqimore të shëndetshme;
- Dallon ushqimet bio nga ushqimet artificiale;
- Vlerëson rolin e njeriut në kultivimin e ushqimeve të shëndetshme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Ushqim i vërtetë ose model ushqimi, paketim ushqimi ose fotografi ushqimesh, etiketa me emërtimet e grupeve ushqimore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Shkrim i shpejtë

Paraqitet para nxënësve pyetja:

- Cili ushqim quhet i shëndetshëm?

Lihen nxënësit t'i përmbledhin njohuritë e tyre rreth ushqimit të shëndetshëm. Pas përfundimit, zhvillohet një diskutim me tërë klasën rreth njohurive të tyre për ushqimet bio.

Vihet theksi te rëndësia e vendit në të cilin rritet ushqimi, i cili duhet të jetë i pastër dhe pa helme, sepse ushqimi me helme rrezikon shëndetin.

2.4. USHQIMI I SHËNDETSHËM

Ushqimi që ne marrim, pos që duhet të jetë i mjaftueshëm, duhet të jetë edhe i llojlojshëm dhe i shëndetshëm. Asnjë ushqim nuk i ka të gjithë përbërësit e nevojshëm ushqimorë, të cilët i duhen organizmit tonë, prandaj gjatë ditës duhet të hamë ushqime të ndryshme për t'i plotësuar nevojat tona me materie ushqyese.

Fjalët kyçe
i shëndetshëm, bio, eko.

Po ashtu, ushqimi duhet të jetë i shëndetshëm. Ushqimi është i shëndetshëm nëse ai rritet në vende të pastra dhe pa helme. Shumë bujq, për të prodhuar sa më shumë ushqim, përdorin plehra artificiale dhe helme (pesticide) në mënyrë që t'i luftojnë dëmtesit. Një sasi e këtyre helmeve mbetet në ushqim dhe dëmton shëndetin tonë. Sot, gjithnjë e më shumë, po i kushtohet rëndësi prodhimit të ushqimit të pastër pa plehra artificiale dhe helme. Këto lloje ushqimesh quhen ushqime bio (biologjike) ose eko (ekologjike). Me përdorimin e prodhimeve bio, ne e ndihmojmë edhe mbrojtjen e mjedisit, por edhe i ndihmojmë bujqit vendas.



Prodhimet që duhet t'i blejnë

Ushqimet bio



Shenja e ushqimeve bio dhe eko

Pyetje

1. Cili ushqim quhet i shëndetshëm?
2. Cilave prodhime ushqimore sot po u kushtohet rëndësi e veçantë?
3. Paraqit me ndonjë shembull ushqimet e pastra pa plehra artificiale dhe helme.

Të mbajmë mend

- Ushqimi që ne marrim duhet të jetë i mjaftueshëm, i llojlojshëm dhe i shëndetshëm.
- Ushqimi i shëndetshëm është ai që ka prejardhje nga bimët dhe kafshët, që rriten në vende të pastra dhe pa helme.
- Prodhimet e ushqimeve të pastra pa plehra artificiale dhe helme quhen ushqime bio.

2.4. USHQIMI I SHËNDETSHËM

Ushqimi që ne marrim, pos që duhet të jetë i mjaftueshëm, duhet të jetë edhe i llojlojshëm dhe i shëndetshëm. Asnjë ushqim nuk i ka të gjithë përbërësit e nevojshëm ushqimorë, të cilët i duhen organizmit tonë, prandaj gjatë ditës duhet të hamë ushqime të ndryshme për t'i plotësuar nevojat tona me materie ushqyese.

Po ashtu, ushqimi duhet të jetë i shëndetshëm. Ushqimi është i shëndetshëm nëse ai rritet në vende të pastra dhe pa helme. Shumë bujq, për të prodhuar sa më shumë ushqim, përdorin plehra artificiale dhe helme (pesticide) në mënyrë që t'i luftojnë dëmtuesit. Një sasi e këtyre helmeve mbetet në ushqim dhe dëmton shëndetin tonë. Sot, gjithnjë e më shumë, po i kushtohet rëndësi prodhimit të ushqimit të pastër pa plehra artificiale dhe helme. Këto lloje ushqimesh quhen ushqime bio (biologjike) ose eko (ekologjike). Me përdorimin e prodhimeve bio, ne e ndihmojmë edhe mbrojtjen e mjedisit, por edhe i ndihmojmë bujqit vendas.

Fjalët kyçe

i shëndetshëm, bio, eko.



Prodhimet që duhet t'i bljninë



Ushqimet bio



Shenja e ushqimeve bio dhe eko

Pyetje

1. Cili ushqim quhet i shëndetshëm?
2. Cilave prodhime ushqimore sot po u kushtohet rëndësi e veçantë?
3. Paraqit me ndonjë shembull ushqimet e pastra pa plehra artificiale dhe helme.

Të mbajmë mend

- Ushqimi që ne marrim duhet të jetë i mjaftueshëm, i llojlojshëm dhe i shëndetshëm.
- Ushqimi i shëndetshëm është ai që ka prejardhje nga bimët dhe kafshët, që rritet në vende të pastra dhe pa helme.
- Prodhimet e ushqimeve të pastra pa plehra artificiale dhe helme quhen ushqime bio.

BOTA E GJALLË

27



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Hulumtim - shqyrtim i përbashkët

Njihen nxënësit me problemin e ditës. Kërkohej t'i japin përgjigje së bashku. Vëzhgohen figurat e para dhe krahasohen ato. Nxënësit gjejnë të përbashkëtat dhe ndryshimet midis ushqimeve bio dhe ushqimeve artificiale.

Lexohet teksti në heshtje, shënohet B për ushqimet e pastra dhe A për ushqimet artificiale.

Pas kësaj veprimtarie, plotësohet tabela.

Ushqime bio - B	Ushqime artificiale - A
- pa plehra artificiale	- me plehra artificiale
- pa helme	- me helme
- janë të dobishme për shëndetin	- dëmtojnë shëndetin tonë
- mbrojnë mjedisin	- dëmtojnë mjedisin



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve

Ruaje fjalën e fundit për mua

Nxënësit punojnë në grupet e tyre. Një anëtar i grupit zgjedh një pjesë nga teksti që e ka tërhequr, habitur apo zemëruar më shumë. Këtë e shkruan në një skedë letre dhe fton shokët e grupit për ta

komentuar atë. Secili prej tyre i shkruan mendimet në skedën e vet. Pasi i lexojnë të gjithë komentet, fjalën e fundit e ka nxënësi që zgjedhi pjesën. Përpara se të fillojnë punën, udhëzohen ata që gjatë komentit të kenë parasysh rolin që luan njeriu në prodhimin e ushqimeve.

Në fund, paraqitet para klasës një video e shkurtër rreth ushqimit të shëndetshëm në këtë link https://youtu.be/Gmh_xMMJ2Pë. Në bazë të instruksioneve në video, përgatitin pjatën e shëndetshme ushqimore dhe dërgojnë me video ose foto.

Nxënësit vlerësohen me notë për angazhimin e tyre dhe përmbledhjen e mësimit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përshkrimin e ushqimeve të shëndetshme, si dhe për vlerësimin e rolit të njeriut në kultivimin e ushqimeve bio.

Detyrë:

Të përgatisë një pjatë të shëndetshme ushqimore për veten.

Reflektim për rrezultatin e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Hulumton dhe dallon produktet ushqimore të shëndetshme dhe ato jo të shëndetshme për moshën specifike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, II.4, IV.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ushqimi i shëndetshëm - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Diskuton rreth mënyrës së të ushqyerit;
- Përshkruan frutat dhe perimet në tekst;
- Interpreton me anë të lojës ushqimin e shëndetshëm dhe të dëmshëm për organizmin e njeriut.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, enciklopedi, fletë punuese, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë






Diskutim rreth njohurive paraprake


Nxiten nxënësit të diskutojnë rreth hulumtimit të tyre në lidhje me ushqimin e shëndetshëm dhe të dëmshëm. Ata i përmbledhin njohuritë e tyre rreth ushqimit, duke u ndihmuar nga pyetjet:


- Cili konsideroni ju që është ushqim i shëndetshëm?
- Pse duhet ta zgjedhim ushqimin që e konsumojmë?
- Sa duhet të konsumojmë ëmbëlsira? Pse?
- Cilat janë dëmet në organizëm nga ushqimi jo i shëndetshëm?


2.4. USHQIMI I SHËNDETSHËM


1. Gjeni brenda katrorit emrat e ushqimeve që shihen në figura.

	Z	L	D	A	M	W	J	F	P	D	N	
	Q	E	P	A	I	I	D	K	O	O	Z	
	I	V	F	I	R	X	O	Q	R	M	B	
	D	A	R	DH	A	D	R	Q	T	A	A	
	A	H	I	Y	L	I	I	S	O	T	N	
	R	M	I	S	R	I	Z	A	K	E	A	
	P	A	T	A	T	E	I	O	A	Z	N	
	H	B	K	N	D	M	K	E	L	L	J	E
	L	E	A	C	C	X	T	A	I	K	I	
	I	N	R	C	B	D	A	N	P	X	H	
	E	F	W	T	M	O	L	L	A	B	O	S

















2. Sipas teje, cilat prodhime janë të shëndetshme për ushqim?

2.4. USHQIMI I SHËNDETSHËM

1. Gjeneroni brenda katrorit emrat e ushqimeve që shihen në figura.

	Z Q I D A R M P A T H B L I N E	L E P V A R H I M I S R C F W	D P A R D H A D M C A C C T M	A I I A Y L I I C C B T	M D A D M K N D M O	W J F P D N	J F P D N	F P D N	P D N	D N							
---	--	---	---	--	--	----------------------------	-----------------------	------------------	-------------	--------	---	---	---	---	---	---	---

2. Sipas teje, cilat prodhime janë të shëndetshme për ushqim?

**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:****Përpunimi i përmbajtjes***Vëzhgo – diskuto – plotëso*

U prezantohen nxënësve lloje të ndryshme të ushqimeve nëpërmjet projektorit dhe kërkohet që të përshkruajnë dhe emërtojnë emrat e ushqimeve që njohin. Kërkohet t'i hapin fletoret e punës, faqe 17. Ushtrimi i parë: Nxënësit nxiten t'i emërtojnë frutat dhe perimet e paraqitura. Nxiten t'i përshkruajnë ato, duke shpjeguar rolin e tyre në organizmin e njeriut.

Gjejnë emërtimet e tyre në fletën punuese nga shkronjat e përziera.

Diskutohen gjetjet e tyre dhe prezantohen para klasës; ndihmohen ata që kanë vështirësi.

Ushtrimi i dytë: Nxënësit do të shkruajnë për prodhimet ushqimore të shëndetshme. Lexohen përgjigjet para klasës.

**Përforcimi:****Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit***Ruaje fjalën e fundit për mua*

Ndahet klasa në grupe me nga 4 nxënës. Brenda çdo grupi caktohen numrat 1-4. Secilit numër i jepet njëri prej këtyre roleve:

1. Biologu, i cili ka për detyrë të japë informacione për mënyrën e kultivimit të ushqimit.
2. Gjetësi i citimeve, i cili ka për detyrë të gjejë në tekst apo internet rolin e ushqimit të shëndetshëm dhe lexon me zë të lartë.
3. Interpretuesi i personazheve. Detyra e tij është të interpretojë rolin e ushqimit të shëndetshëm dhe atij artificial, përshkrimin e tyre, shpejtësinë e rritjes, duke u mbështetur nga të dhënat e biologut dhe citimeve të lexuara.

Loja në role e secilit grup do të votohet nga grupet e tjera. Fiton grupi që ka grumbulluar më shumë pikë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përshkrimin e frutave dhe perimeve, si dhe për interpretimin e tyre në role rreth mënyrës së të ushqyerit të shëndetshëm.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Ndërton piramidën e thjeshtë të ushqimit të njeriut sipas vlerave ushqimore dhe për shëndetin.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, III.4, IV.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Piramida e ushqimit të njeriut

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon dietën e duhur dhe të larmishme që nevojitet për të qenë i shëndetshëm;
- Mbledh prova të llojeve të ndryshme për t’iu përgjigjur pyetjeve dhe për të vërtetuar hipotezat;
- Argumenton për rëndësinë e ushqimit të shëndetshëm.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fruta dhe perime të ndryshme, pjata, thika dhe pirunë plastikë, dezinfektues.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:


Përgatitja për të nxënë

Përmbledhja e strukturuar


Prezantohet piramida ushqimore dhe si është e organizuar ajo. Diskutohet një situatë (e krijon mësuesja), në të cilën është vendosur Joni, i cili duket sikur nuk ka dëshirë ta provojë kavin, për shkak të pamjes së tij. Por, pasi e provon, e kupton që i pëlqen.

- A ka ndodhur të provoni fruta që nuk kanë pamje të bukur, por kanë shije të mirë?

Orientohen nxënësit të kuptojnë se gjatë kohës që ata rriten, edhe shijet ndryshojnë. Ju mund të filloni të pëlqeni gjëra të reja, prandaj është mirë që të provoni fruta dhe perime të reja, qoftë edhe në sasi të vogla.



Detyrë: Bazuar në shembullin më lart (piramida e ushqimit), ndërtoni një piramidë të thjeshtë me llojet e ushqimeve që ju përdorni në jetën e përditshme.



Pyetje

1. Çfarë ushqimi na duhet që të jemi të shëndetshëm, të kemi shumë energji dhe mos të sëmurim?
2. Duke analizuar piramidën e ushqimit lart, sqaro cilat ushqime duhen përdorur më shpesh e cilat më rrallë.

Të mbajmë mend

- Që të jemi të shëndetshëm dhe mos të sëmurim, duhet të ushqehemi me ushqim të shëndetshëm dhe në mënyrë të balancuar.
- Piramidat e ushqimit mund t'ju ndihmojnë se cilat ushqime t'i përdorni më shpesh e cilat më rrallë.

BOTA E GJALLË

29



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Pyetja sjell pyetjen

Pyeten nxënësit;

- Cilat janë frutat dhe perimet që ju pëlqejnë, ose cilat janë ato që nuk i keni provuar asnjëherë?

Prezantohet veprimtaria hulumtuese që do të zhvillojë nxënësit në dyshe. Pasi janë përgatitur në pjesa copa frutash e perimesh, nxënësit do të provojnë dhe do të hedhin në një tabelë rezultatet e provave.

Përfundimet e hulumtimit: Pas disa provave, diskutohet me të gjithë nxënësit e klasës mbi rezultatet e hulumtimit të tyre.

Drejtohen pyetje si:

- Pse duhet të hamë sa më shumë fruta e perime?
- Pse trupi ynë ka nevojë për ujë?
- A keni ngrënë ndonjëherë ushqime që nuk ju pëlqejnë, vetëm sepse janë të shëndetshme?
- A ekzistojnë ushqime të shijshme dhe që i bëjnë mirë organizmit tonë?
- Çfarë do të ndodhte nëse do të hanim vetëm ëmbëlsira të shijshme?
- Çfarë mendoni se është më e rëndësishme, të hamë ushqime që kanë shije të mirë, apo ushqime që i bëjnë mirë organizmit?



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxëniet Përmbledhje e strukturuar

U prezantohet nxënësve një video ku shpjegohet mënyra e organizimit të piramidës ushqimore në këtë link: <https://youtu.be/0KbA8pFĒ3tg>. Pas shikimit të videos së prezantuar, nxënësit ndërtojnë një piramidë të thjeshtë në faqen 29, në kutinë e zbrazët në tekst.

Varësisht prej kohës, prezantohen disa punime të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për mbledhjen e provave dhe nxjerrjen e rezultateve, si dhe për argumentimin e rëndësisë së ushqimit të shëndetshëm.

Detyrë:

Ndërtoni një piramidë të thjeshtë me llojet e ushqimeve që ju konsumoni.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Ndërton piramidën e thjeshtë të ushqimit të njeriut sipas vlerave ushqimore dhe për shëndetin.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, III.4, IV.6.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Piramida e ushqimit të njeriut - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon ushqimet e shëndetshme dhe të pashëndetshme;
- Grupon ushqimet në bazë të përbërjes;
- Ndërton piramidën ushqimore në fletë punuese.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, enciklopedi, fletë punuese, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Pyetja sjell pyetjen

Pyeten nxënësit:

- Ç'është e thotë të ushqehemi shëndetshëm?
- Si ndahen ushqimet sipas përbërjes?

Bashkë me nxënësit, grupohen ushqimet që përdoren në jetën e përditshme. Ushqimet që janë të mira për shëndetin janë disa grupe ushqimesh, si: mishi dhe peshku, bulmeti, karbohidratet, frutat dhe perimet, të cilat do t'i paraqesim më poshtë:

2.5. PIRAMIDA E USHQIMIT TË NJERIUT

1. Plotësoje piramidën më poshtë me ushqime, duke filluar prej poshtë - lart.



2. Plotësoje fjalinë duke përdorur fjalët në kuti.

*i shëndetshëm,
e balancuar, energji,
sëmuremi*

Një dietë _____ me lloje të ndryshme të ushqimeve dhe ushqimi _____ bëjnë që ne të ndihemi mirë, të kemi shumë _____ dhe të mos _____.

2.5. PIRAMIDA E USHQIMIT TË NJERIUT

1. Plotësoje piramidën më poshtë me ushqime, duke filluar prej poshtë - lart.



2. Plotëso fjalinë duke përdorur fjalët në kuti.

*i shëndetshëm,
e balancuar, energji,
sëmuremi*

Një dietë _____ me lloje të ndryshme të ushqimeve dhe ushqimi _____ bëjnë që ne të ndihemi mirë, të kemi shumë _____ dhe të mos _____.

BOTA E GJALLË

19

**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:****Përpunimi i përmbajtjes***Grupim - shqyrtim i përbashkët*

Ushqimet ndahen në disa grupe:

- | | |
|--|---|
| 1. Grupi i karbohidrateve:
tërshëra;
bananet;
panxhari etj. | 3. Grupi i bulmetrave:
qumështi;
djathi;
kosi. |
| 2. Grupi i proteinave:
vezët;
bajamet;
qumështi etj. | 4. Grupi i yndyrave:
arra;
veza;
vaji i ullirit etj. |

Theksohet se: për të qenë të shëndetshëm, duhet të kemi një dietë të pasur ushqimore.

Për t'i konsumuar ushqimet që ju bëjnë mirë, duhet të orientoheni sipas piramidës ushqimore; ashtu siç janë të renditura ushqimet në piramidën ushqimore, ashtu duhet t'i përdorim.

**Përforcimi:****Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënës***Veprimtari praktike*

Prezantohet para nxënësve piramida ushqimore

me anë të projektorit. Nxënësit vëzhgojnë piramidën, hapin fletore punen, faqe 19, dhe plotësojnë në tekst. Analizohet piramida bashkë me nxënësit. Theksohet se: një vend të rëndësishëm duhet të zënë karbohidratet, pra janë baza e piramidës, pastaj vijnë frutat e perimet, bulmeti, mishi dhe në fund ëmbëlsirat dhe yndyrat.

**Vlerësimi i nxënësve:**

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në identifikimin e ushqimeve të shëndetshme dhe të pashëndetshme, si dhe në krijimin e piramidës ushqimore.

Detyrë:

Shëno për një javë ushqimet që i konsumon, duke u mbështetur te piramida ushqimore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Aplikon në jetë udhëzimet për ruajtjen e ushqimeve nga mikrobet dhe ndotja, njeh afatet e përdorimit në etiketa dhe kushtet e higjienës së tyre për përdorim.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4, III.1, IV.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ruajtja e ushqimit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon mënyrën e ruajtjes së ushqimit;
- Shpjegon arsyen e leximit të etiketave në kutitë e ushqimeve;
- Argumenton për dëmin që shkaktojnë në organizëm ushqimet me afat të skaduar.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Kutitë ushqimesh të përdorura në familje, skeda, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Pyetja sjell pyetjen

Në kutitë e produkteve ushqimore, që nxënësit kanë sjellë, analizohen përmbajtjet e produkteve, meqë nxënësit kanë mësuar në mësimet e kaluara për përbërësit e ushqimeve, si: proteinat, yndyrat, sheqernat dhe karbohidratet.

I kushtohet vëmendje leximit të mënyrës së ruajtjes së këtyre ushqimeve dhe të afatit të përdorimit.

NEVOJA E NJERIUT PËR USHQIM DHE HIGJENË PERSONALE

2.6. RUAJTJA E USHQIMIT

Fjalët kyçe

ruajtja, frigorifer, qilar, bodrum, konservim, afati i përdorimit, myku.



Ruajtja e ushqimit në frigorifer

Ushqimi mund të përdoret vetëm një kohë të caktuar, pastaj ai prishet. Ushqimi i prishur (i kalbur, mykur ose që i vjen erë e keqe) nuk duhet të halet. Disa lloje të ushqimeve prishen shpejt (mishi, qumështi dhe produktet e tij, vezët etj.), ndërsa ushqimet e tjera prishen më ngadalë (buka, perimet, frutat etj.). Që ushqimi të qëndrojë më gjatë, ai duhet të ruhet në vend të freskët, të thatë dhe të pastër. Po ashtu, ushqimi duhet të mbulohet dhe të mos jetë në kontakt me brejtës (mini) dhe insekte, sepse ata përhapin sëmundje.

Ushqimet që mund të prishen lehtë (p.sh., mishi) duhet të ruhen në frigorifer. Temperatura e ulët dhe mungesa e dritës mundësojnë që ushqimi të ruhet më mirë dhe më gjatë.

Ushqimet e tjera që janë më të qëndrueshme (p.sh., domatet, trangujt, specat e perimet e tjera) mund të ruhen në frigorifer, në qilar të pastër dhe të errët. Frutat dhe perimet e tjera, p.sh., patatet, qepët, hudhrat, mollët, lakrat, panxhari etj. mund të ruhen mirë edhe në bodrum.



Qilari



Bodrumi ku ruhet ushqimi

Për t'i ruajtur më gjatë disa lloje të ushqimeve, siç janë: frutat, perimet, mishi dhe suxhuku etj., teren (thahen), disa të tjera konservohen në mënyra të ndryshme, si: turshitë, reçeli, marmelata etj. Një mënyrë tjetër e ruajtjes së ushqimit është edhe ngrirja.

BOTA E GJALLË



Tharja e ushqimeve



Konservimi i ushqimit



Ushqimi i mykur

Të gjithë këto forma të ruajtjes së ushqimit (temperatura e ulët, zvogëlimi i lagështisë, shtimi i kripës ose sheqerit) pamundësojnë rritjen e mikroorganizmave (kërpudhat, bakteret etj.), të cilët e prishin ushqimin.

25.05.2025

Është shumë e rëndësishme që, para se ta blejmë ushqimin, ta lexojmë përmbajtjen e tij në etiketë dhe afatin e përdorimit. Kjo na ndihmon që ta ruajmë dhe përdorim siç duhet atë.



Afati i përdorimit

Pyetje

1. Shëno disa nga ushqimet që prishen shpejt dhe disa që prishen më ngadalë.
2. Identifiko vendet ku duhen ruajtur ushqimet.
3. Pse, para se të blejmë prodhimet ushqimore, është me rëndësi t'i lexojmë edhe etiketën dhe afatin e përdorimit?

Të mbajmë mend

- Ushqimet e prishura (të kalbura, mykura ose që u vjen erë e keqe) nuk duhet të hahen.
- Ruajtja e ushqimeve duhet të bëhet në vende të veçanta, si në frigorifer, qilar, bodrum, ndërsa disa ushqime edhe mund të thahen, konservohen etj.
- Çdo herë, para se t'i blejmë ushqimet, duhet lexuar përmbajtjen e tyre në etiketë dhe afatin e përdorimit.

BOTA E GJALLË

31

Shtrohen pyetjet:

- A keni lexuar ndonjëherë në produktet që ju përdorni mënyrën e ruajtjes dhe afatin e përdorimit?
 - Pse duhet të lexohen?
 - Çfarë mund të ndodhë me ushqimet nëse nuk i ruajmë në vendin e duhur?
- Përgjigjet e këtyre pyetjeve plotësohen duke lexuar materialin e paraqitur në libër.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Hulumtim - grupi i ekspertëve

Njihen nxënësit për mësimin që do të zhvillohet. Njohuritë e reja rreth mësimin do të merren me grupe ekspertësh. Klasa ndahet në grupe me nga katër nxënës. Secili prej tyre numëron nga 1 - 4.

Numrat 1: Të tregojnë me shembuj mënyrën e ruajtjes së ushqimit.

Numrat 2: Të tregojnë ushqimet që prishen shpejt dhe ushqimet që prishen më ngadalë.

Numrat 3: Të shkruajnë pesë këshilla për ruajtjen e ushqimit.

Numrat 4: Të vlerësojnë pasojat që mund të sjellin ushqimet e prishura dhe me afat të skaduar në shëndetin e njeriut.

Pasi marrin kërkesat, numrat 1 grupohen bashkë, numrat 2 grupohen bashkë e kështu me radhë.

Për t'i dhënë përgjigje pyetjes së tyre, ata do ta përdorin materialin në libër dhe materialet që ata kanë sjellë. Pasi të përfundojnë në grup, kthehen te grupi i parë për t'ua mësuar shokëve. Më pas, saktësohet secila pikë me gjithë klasën. Saktësohen njohuritë e nxënësve.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve

Ruaje fjalën e fundit për mua

Një nxënës brenda grupit zgjedh një pjesë, që e ka tërhequr më shumë, dhe kërkon nga shokët që ta komentojnë. Pasi dëgjojnë komentet e tyre, në fund e komenton edhe ai.

Nxënësit vlerësohen me notë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në shpjegimin e etiketave të ushqimeve dhe për argumentimin e dëmeve që shkaktojnë në organizëm ushqimet me afat të skaduar.

Detyrë:

Trego një shembull të helmimit nga ushqimi i pakontrolluar.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Aplikon në jetë udhëzimet për ruajtjen e ushqimeve nga mikrobet dhe ndotja, njeh afatet e përdorimit në etiketa dhe kushtet e higjienës së tyre për përdorim.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4, III.1, IV.7.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ruajtja e ushqimit - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon mënyrën natyrale dhe artificiale të ruajtjes së ushqimit;
- Shpjegon mënyrën e ruajtjes së llojeve të ndryshme të ushqimit;
- Arsyeton rëndësinë e ruajtjes së ushqimit në vendin e duhur.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, enciklopedi, fletë punuese, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Pyetje - përgjigje

Prezantohet para nxënësve me anë të projektorit lloje të ndryshme të ushqimit. Nxiten nxënësit të emërtojnë dhe përshkruajnë ato. Pyeten nxënësit:

- A ruhen të gjitha ushqimet në vendin e njëjtë?
- Si duhet të klasifikohen ato kur i ruajmë?
- Ku duhet të ruhen? Pse?
- Pse shërben frigoriferi?

2.6. RUAJTJA E USHQIMIT

1. Në figurën e mëposhtme shihen produktet e blera në dyqan. Ku mund të ruhen këto produkte?



Në frigorifer duhet të ruhen:

Në qilar duhet të ruhen:

2. Shikoni në frigorifer dhe shkruani më poshtë se cilat produkte i ruani aty dhe deri kur kanë afat përdorimi.

2.6. RUAJTJA E USHQIMIT

1. Në figurën e mëposhtme shihen produktet e blera në dyqan. Ku mund të ruhen këto produkte?



Në frigorifer duhet të ruhen:

Në qilar duhet të ruhen:

2. Shikoni në frigorifer dhe shkruani më poshtë se cilat produkte i ruani aty dhe deri kur kanë afat përdorimi.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Shqyrtim i përbashkët

U shpjegohen nxënësve mënyrat e ruajtjes së ushqimit nëse duam t'i kemi më gjatë, si: ngrirja, zierja, tharja dhe pasterizimi.

Përmenden disa pemë që mund të ngrihen dhe thahen, po ashtu disa drithëra mund të ruhen në kavanoza të mbyllur, si dhe vlimi i qumështit në 65 gradë, ku bëhet pasterizimi.

Kërkohet nga nxënësit t'i hapin fletoret e punës, faqe 17, ku nxënësit, në bazë të vëzhgimit të figurave në libër, plotësojnë ushtrimet.

Ushtrimi 1: Nxiten të shkruajnë se cilat ushqime ruhen në frigorifer dhe qilar.

Ushtrimi 2: Shkruajnë për rëndësinë e leximit të afatit të skadimit të ushqimeve para ruajtjes dhe përdorimit.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Ditari dypjesësh

Kërkohet nga nxënësit të shkruajnë se cilat ushqime ruhen me metoda natyrale dhe cilat ushqime ruhen me metoda artificiale.

Metoda natyrale	Metoda artificiale

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në dallimin e mënyrave të ruajtjes së ushqimit dhe për argumentimin e rëndësisë së ruajtjes së ushqimit në vendin e duhur.

Detyrë:

Bisedo me prindërit dhe shkruaj në fletore si ruhen ushqimet në familjen tuaj.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Hulumton dhe dallon produktet ushqimore të shëndetshme dhe ato jo të shëndetshme për moshën specifike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2, III.1, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Efektet e lëndëve të dëmshme për organizmin

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Rendit pesë lëndët e dëmshme për organizmin;
 - Shpjegon rrezikimin e shëndetit të njeriut nga përdorimi i këtyre lëndëve;
 - Vlerëson rolin e njeriut në mbrojtjen e shëndetit të shoqërisë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, projektor, gazeta, kuti duhani, mjete shkrimi, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Stuhi mendimesh

Shkruhet në tabelë tema *Lëndët e dëmshme për organizmin*. Nxënësit japin mendime rreth temës, duke sjellë edhe shembuj nga jeta e përditshme.



Kafeja përmban lëndën kafeinë. Nëse pihet shumë brenda ditës, mund të jetë e rrezikshme. Kafeja është e dëmshme për fëmijët, ndërsa gratë shtatzëna dhe ato që janë duke ushqyer me gjë fëmijën duhet të jenë të kujdesshme në lidhje me sasinë e kafesë që pinë.



Kohëve të fundit edhe **pijet energjike** po përdoren shumë nga fëmijët dhe të rinjtë. Ato janë të rrezikshme, pasi kanë lëndë që dëmtojnë shëndetin tonë. Përdorimi i tepërt i këtyre pijeve shkakton nervozë, pagjumësi, kokëdhembje, çrregullim të ritmit të zemrës, shtypje të lartë të gjakut etj.



Pijet energjike

Pyetje

1. Identifikoj lëndët e dëmshme më të zakonshme për organizmin e njeriut.
2. Shpjego efektin e dëmshëm të duhanit, alkoolit, drogës dhe pijeve energjike për organizmin.
3. Për cilët persona është e dëmshme pirja e kafesë?

Të mbajmë mend

- Lëndët e dëmshme për organizmin tonë janë të shumta, por më të zakonshmet janë tymi i duhanit, alkooli, droga, pijet energjike etj.
- Jo vetëm pirja e duhanit, por edhe qëndrimi në vendet ku ka tym të duhanit ka pasojë për shëndetin tonë.
- Përdorimi i tepërt i pijeve energjike shkakton nervozë, pagjumësi, kokëdhembje etj.

BOTA E GJALLË

Shënohen në tabelë të gjitha mendimet e nxënësve, pa bërë komente për to. Në fund, nxirret një përfundim rreth efekteve të lëndëve të dëmshme për organizmin.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Përmbledhje pohim-mbështetje

Ndahen nxënësit në grupe dhe u shpërndahet skica bosh e një përmbledhjeje pohim-mbështetje. Kjo skicë paraqitet edhe në tabelë.

Nxënësit do t'i karakterizojnë mbështetjet e ndryshme për pohimin e dhënë në pesë mënyra, si: fakte, statistika, shembuj, autoriteti i ekspertit, logjika dhe arsyeja, të cilat i nxjerrin gjatë leximit në tekst dhe internet.

Përfaqësuesit e grupeve prezantojnë punën e tyre. Bëhet përmbledhja e tyre në tabelë, në këtë formë:

Efektet e lëndëve të dëmshme për organizmin

Pohim: Përdorimi e duhanit, drogës dhe i alkoolit është problem i madh për shoqërinë njerëzore.

1. *Fakte* - pirja e duhanit shkakton kancerin e mushkërive. Alkooli dëmton trurin, lukthin dhe mëlçinë etj.
2. *Statistika*
3. *Shembuj*
4. *Autoriteti i ekspertit*



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve
Shkrim i lirë

Jepet tema: *Çfarë do të bëje ti për ta mbrojtur shëndetin e shoqërisë njerëzore?*

Pas përfundimit, disa prej nxënësve lexojnë shkrimet e tyre. Diskutohet rreth tyre dhe vlerësohen shkrimet më të mira.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në renditjen e lëndëve të dëmshme për organizmin, për shpjegimin e rreziqeve nga këto lëndë, si dhe për vlerësimin e rolit të njeriut në mbrojtjen e shoqërisë.

Detyrë:

U përgjigjet pyetjeve në libër, faqe 33.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Hulumton dhe dallon produktet ushqimore të shëndetshme dhe ato jo të shëndetshme për moshën specifike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: II.2, III.1, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.3.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Efektet e lëndëve të dëmshme për organizmin - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon efektet e lëndëve të dëmshme për organizmin;
- Gjen zgjidhjen për ndalimin e shitjes së këtyre lëndëve në afërsi të shkollës;
- Shkruan një kërkesë për ta përmirësuar gjendjen në komunitet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Burime nga interneti, enciklopedi, fletë punuese, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim rreth njohurive paraprake


Pyeten nxënësit:

- A duhet fëmijët të pinë pije energjike? Pse?
- A shiten pije energjike në afërsi të shkollës?
- Si duhet të veprojmë për ndalimin e shitjes së pijeve energjike për fëmijët?

Nxënësit u përgjigjen pyetjeve të parashtruara, duke sjellë shembuj nga jeta e përditshme dhe rastet që ata i kanë parë ose dëgjuar.

2.7. EFEKTET E LËNDËVE TË DËMSHME PËR ORGANIZMIN

1. Prezantim në grupe.
Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup diskuton mes vete. Pas një periudhe prej 15-20 minutash, grupet bëjnë prezantimet. Cilat lëndë janë të dëmshme për njeriun dhe pse? Përgatitni një prezantim në fletë të bardhë dhe, së bashku me mësuesin/in, prezantoheni në klasë.



2. Hulumtoni në internet, me ndihmën e prindërve, dhe tregoni se a është i ndaluar konsumimi i duhanit në vende publike.

2.7. EFEKTET E LËNDËVE TË DËMSHME PËR ORGANIZMIN**1. Prezantim në grupe.**

Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup diskuton mes vete. Pas një periudhe prej 15-20 minutash, grupet bëjnë prezantimet. Cilat lëndë janë të dëmshme për njeriun dhe pse? Përgatitni një prezantim në fletë të bardhë dhe, së bashku me mësuesen/in, prezantojeni në klasë.

Pijet energjike



Duhani

Alkooli

2. Hulumtoni në internet, me ndihmën e prindërve, dhe tregoni se a është i ndaluar konsumimi i duhanit në vende publike.

BOTA E GJALLË

21

**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:****Përpunimi i përmbajtjes***Hulumtim - shqyrtim i përbashkët*

Ndahet klasa në grupe dhe kërkohet nga nxënësit që secili secili grup të bëjë një poster për lëndët e dëmshme për organizmin. U shpërndahen mjetet e punës dhe secili grup pajiset me laptop ose telefon, për të marrë burime nga interneti për temën e dhënë.

Diskutohet së bashku me të gjithë për efektet e dëmshme të duhanit, drogës, alkoolit dhe pijeve energjike.

Pas përfundimit të posterave për efektet e lëndëve të dëmshme për organizmin, ngjeshin punimet në murin e shkencës dhe, me anë të teknikës *Lapsat në mes*, përfaqësuesi i grupit e prezanton temën e punuar.

**Përforcimi:****Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit***Shkrim i lirë*

Shkruani një *kërkesë* drejtuar drejtorit të shkollës për të ndaluar shitjen e pijeve energjike në afërsi të shkollës. Nxënësit e shkruajnë kërkesën duke

u ndihmuar nga mësuesja. Theksohet rëndësia e shpjegimit të efekteve të dëmshme për organizmin e fëmijëve.

Kërkesa mund të vazhdohet edhe në shtëpi me ndihmën e prindërve, si dhe formohet grupi prej tre nxënësish, për të diskutuar me drejtorin e shkollës për këtë nismë të fëmijëve.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në shpjegimin e efekteve të lëndëve të dëmshme për organizmin, si dhe për gjetjen e zgjidhjes për ndalimin e shitjes së këtyre lëndëve në afërsi të shkollës.

Detyrë:

Shkruaj një kërkesë për ndalimin e shitjes së lëndëve të dëmshme në afërsi të shkollës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Ndërveprimet e organizmave të gjallë

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon dhe liston produktet higjienike që përdoren në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; IV.7; V.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Higjiena dhe prodhimet higjienike

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon kuptimin e fjalës *higjienë*;
- Përcakton mjetet që përdoren për mbajtjen e higjienës;
- Vlerëson rëndësinë e mbajtjes së higjienës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, laptop, kuti detergjentësh, mjete shkrimi, fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Dil rrotull, fol rrotull

Kërkohet nga nxënësit të mendohen për disa minuta dhe t'i përgjigjen pyetjes:

- Si duhet ta mbajmë higjienën personale dhe të mjedisit ku jetojmë?

Më pas, nxënësit ngrihen në këmbë dhe ecin rrotull klasës. Kur përplasim duart, ata ndalojnë dhe shkëmbejnë idetë me shokun që kanë pranë. Kur mësuesja përplas duart dy herë, nxënësit fillojnë përsëri ecjen. Kjo zhvillohet derisa nxënësit të komunikojnë tri herë me shokun pranë. Në fund, ulen nëpër vende. Idetë e tyre shkruhen në tabelë.

NEVOJA E NJERIUT PËR USHQIM DHE HIGJENË PERSONALE

2.8. HIGJIENA DHE PRODHIMET HIGJIENIKE


Fjalët kyçe

higjiena, ajrosja, prodhime higjienike.

Me higjienë kuptojmë mbajtjen pastër të trupit dhe të mjedisit ku jetojmë. Mbajtja pastër e trupit është higjienë personale. Të pastër jemi nëse vazhdimisht lajmë duart, dhëmbët, flokët, trupin dhe rrobat.

Për pastrim gjithmonë e përdorim ujin, por edhe mjete të tjera higjienike, të cilat e lehtësojnë pastrimin. Për shembull, për larjen e duarve dhe trupit përdorim sapunin, për larjen e dhëmbëve përdorim brushën dhe pastën, për larjen e flokëve përdorim shampun, për larjen e rrobave përdorim sapunin dhe detergjentët etj.

Pos higjienës së trupit, rëndësi duhet t'i kushtojmë edhe mjedisit të brendshëm në të cilin jetojmë (shtëpisë). Shtëpinë duhet ta pastrojmë dhe ta ajrosim vazhdimisht, meqë pjesën më të madhe të kohës e kalojmë aty. Nuk duhet të ketë pluhur, tym cigareje, myk etj., sepse mund të shkaktojnë sëmundje. Për mbajtjen pastër të mjedisit ku jetojmë, përdorim mjete të ndryshme, si: fshesa, shpuza, detergjentë të ndryshëm etj.



Ajrosja e shtëpisë



Mjete për mbajtje të higjienës

BOTA E GJALLË



Pastrimi i oborrit

Mjedisi i jashtëm në të cilin jetojmë, gjithashtu, duhet të mbahet pastër. Që të kemi një mjedis të pastër (oborr, korridorët e banesave, rrugët e lagjeve etj.), nevojitet angazhimi i të gjithëve që jetojnë në atë vend. Nuk duhet të hidhen mbeturinat dhe, nëse ka mbeturina, duhet të largohen etj.

Detyrë: Shkruaj më poshtë cilat prodhime higjienike i përdorni në përditshmëri:

Pyetje

1. Çfarë kuptojmë me higjienë?
2. Identifikoj mjetet që përdoren për mbajtjen e higjienës personale dhe asaj të mjedisit ku jetojmë.
3. Shpjego arsyen e mbajtjes së higjienës së mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm ku jetojmë dhe veprimet.

Të mbajmë mend

- Me higjienë kuptojmë mbajtjen pastër të trupit dhe të mjedisit ku jetojmë.
- Për mbajtje të higjienës gjithmonë përdorim ujë, por edhe mjete të tjera higjienike, të cilat e lehtësojnë pastrimin.
- Pas higjienës së trupit, rëndësi duhet t'i kushtojmë edhe mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm në të cilin jetojmë dhe veprimet.

BOTA E GJALLË



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Ditarët e të nxënës**

Ndahen nxënësit në grupe. Ndahet teksti në tri pjesë. Jepet për lexim pjesa e parë. Udhëzohen që në fillim të bëjnë nënvizime në fjalitë që iu bëjnë përshtypje e që janë të rëndësishme. Pas leximit dhe nxjerrjes së çështjeve më të rëndësishme, ato shkruhen në tabelë.

Mbajtja e higjienës personale	Mbajtja pastër e mjedisit të brendshëm	Mbajtja pastër e mjedisit të jashtëm

Përfaqësuesit e grupeve paraqesin komentet. Bëhen pyetje për t'i nxitur e për ta orientuar diskutimin në çështjet e rëndësishme. Bëhet përmbledhja e të gjitha komenteve në tabelë.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënës
Shkrim i lirë**

Shtrohet pyetja, së cilës nxënësit i japin përgjigje në fletoret e tyre:

- Cila është arsyeja e mbajtjes së higjienës në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm?

Nxënësit punojnë në mënyrë individuale në fletore, duke argumentuar mendimin e tyre. Lexohen disa shkrime të tyre para klasës. Vlerësohen me notë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për vlerësimin e rëndësishëm që ka mbajtja e higjienës dhe për përcaktimin e mjeteve higjienike.

Detyrë:

U përgjigjet pyetjeve në libër, faqe 35.

Reflektim për rrezultatin e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon dhe liston produktet higjienike që përdoren në jetën e përditshme.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, I.8, V.1, V.8, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Higjiena dhe prodhimet higjienike - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përforcim i njohurive të marra;
- Identifikon produktet higjienike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hamer, fotografi etj.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Edukatë figurative, Shkathtësi për jetë, Matematikë.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë


Diskutim për njohuritë paraprake

U kërkojmë nxënësve të ndahen në grupe. Secilit grup ia shpërndajmë nga një fletë, në qendër të së cilës është shkruar fjala “higjienë”. Nxënësit për 2-5 minuta do të punojnë atë se çfarë dinë për higjienën. Në fund, secili grup zgjedh përfaqësuesin dhe ai/ajo prezanton punën para gjithë klasës.



2.8. HIGJIENA DHE PRODHIMET HIGJIENIKE

1. Shkruaj emrat e produkteve të domosdoshme për mbajtjen e higjienës.




2. Ti je vetë përgjegjës për pastërtinë e trupit tënd, prandaj ti duhet të kujdesesh për higjienën e trupit.



Shkruaj më poshtë se çka i bën mirë trupit tënd.

2.8. HIGJENA DHE PRODHIMET HIGJENIKE

1. Shkruaj emrat e produkteve të domosdoshme për mbajtjen e higjienës.



2. Ti je vetë përgjegjës për pastërtinë e trupit tënd, prandaj ti duhet të kujdesesh për higjienën e trupit.



Shkruaj më poshtë se çka i bën mirë trupit tënd.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Të ndarë në grupe, ua shpërndajmë nxënësve materialet, ku kërkojmë nga ta që të realizojnë një mini-projekt prezantimi për mënyrën e kujdesit ndaj vetes. Ky projekt duhet të përmbajë: këshilla, ilustrime etj. Këto punime do të vendosen në turin e galerisë.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Rrjeti i diskutimit

U kërkohet nxënësve t'i hapin librat dhe të fillojnë të plotësojnë në fletore pune, faqe 22.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për punën në grupe, për identifikimin e prodhimeve higjienike dhe përforcimin e njohurive të marra.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Ndërveprimet e organizmave të gjallë

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Definon përbërësit e piramidës ushqimore në ekosistemet e gjalla, sipas rolit të tyre: prodhues, konsumues dhe zbrërthyes, dhe lidhjen e tyre në zinxhirët ushqimorë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: III.2; III.4; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndërveprimet e organizmave të gjallë me mjedisin

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Diskuton për ndërveprimin e organizmave të gjallë me mjedisin;
- Shpjegon ndërveprimin e organizmave të gjallë me mjedisin;
- Argumenton me shembuj ndërveprimet e dëmshme dhe të dobishme ndërmjet qenieve të gjalla.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, projektor, fletë A4, mjete shkrimi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Kërkim - hulumtim

Me anë të projektorit, paraqesim para nxënësve një video të shkurtër për ndërveprimet e organizmave të gjallë me mjedisin, në linkun e mëposhtëm: <https://youtu.be/xIJb9BRsLvg>.

Më pas, zhvillohet një diskutim me nxënësit rreth materialit të prezantuar. Nxiten nxënësit të diskutojnë dhe të parashtrajnë pyetje rreth temës.



NDËRVEPRIMET E ORGANIZMAVE TË GJALLË

Shembull të bashkëveprimit të ngushtë ndërmjet dy organizmave të llojeve të ndryshme, për përfitim të ndërsjella, kemi edhe ndërmjet shtazëve, p.sh., zogjtë në lëkurën e buallit përfitojnë duke gjetur insekte për ushqim, p.sh., rriqra etj., ndërsa bualli përfiton nga kjo, sepse zogjtë i eliminojnë dëmtuesit e lëkurës së tyre.



Dukuria e ndërveprimit të dobishëm ndërmjet vetë shtazëve

Ndërveprime të dëmshme kemi atëherë kur nga jeta e përbashkët, njëri organizëm përfiton, ndërsa tjetri dëmtohet, p.sh.: konkurrenca, grabitja dhe parazitizmi. Konkurrenca është ndërveprim kur në të njëjtën kohë organizmat e ndryshëm përpiqen të përdorin të njëjtin ushqim dhe hapësirë.

Grabitja është një ndërveprim i dëmshëm kur individi i një lloji (grabitqari), ha individ të një lloji tjetër (pre në).



Një grabitqar si shqiponja ha pre në e saj, në këtë rast peshkun.

Ndërveprim i dëmshëm është edhe dukuria kur një organizëm jeton në llogari të organizmit tjetër, por zakonisht nuk e shkatërron atë. Ky ndërveprim quhet **parazitizëm**. Në natyrë ka edhe raste kur dy organizma jetojnë së bashku dhe as përfitojnë, por as e dëmtojnë njëri-tjetrin.



Një shembull i përfitimit të njëanshëm është rasti i rriqrës, që ushqehet me gjakun e macës, ndërsa macja irritohet nga pickimi i rriqrës.

Pyetje

1. Shpjego ndërveprimin mes organizmave të gjallë dhe mjedisit, përmes shembullit të lejkukut.
2. Trego me ndonjë shembull dukurinë e ndërveprimit të dobishëm.
3. Në cilat raste kemi ndërveprime të dëmshme mes organizmave?

Të mbajmë mend

- Organizmat, përveçqë ndërveprojnë me mjedisin e jashtëm, ata ndërveprojnë edhe me njëri-tjetrin.
- Ndërveprimet mes organizmave mund të jenë të dobishme dhe të dëmshme.
- Ndërveprime të dobishme kemi kur dy organizma të ndryshëm jetojnë së bashku në një mjedis dhe që të dy përfitojnë nga njëri-tjetri.
- Ndërveprime të dëmshme kemi atëherë kur nga jeta e përbashkët, njëri organizëm përfiton, ndërsa tjetri dëmtohet.

BOTA E GJALLË



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Lexim me kodim teksti

Njohuritë e reja do të merren duke lexuar mësimin me vëmendje dhe duke shënuar te çdo paragraf simbolet e mëposhtme.

Unë e dija këtë	Unë e dija ndryshe	Unë nuk e kuptoj	Unë nuk e dija
V	-	?	+

Pasi lexohet dhe shënohet me simbole teksti, plotësohet tabela e mësipërme në fletore. Sugjerohen nxënësit të shkruajnë vetëm idetë kryesore, jo të gjithë paragrafin.

Pasi të mbarojnë nxënësit, paraqitet në mënyrë të strukturuar mësimi në tabelë; këtu sqarohen edhe paqartësitë e nxënësve te kolona e tretë.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve

Ditari dypjesësh

Kërkohet nga nxënësit që të renditin shembuj të ndërveprimeve të qenieve të gjalla, duke hulumtuar në internet dhe në enciklopedi.

Ndërveprimet e dobishme	Ndërveprimet e dëmshme
1. Bleta dhe lulja 2. Bualli dhe zogu	1. Shqiponja dhe peshku 2. Macja dhe rriqra

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në shpjegimin e ndërveprimit të organizmave të gjallë, si dhe për argumentimin e ndërveprimit të dëmshëm dhe të dobishëm.

Detyrë:

Punohet në fletore pune, faqe 23.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Ndërveprimet e organizmave të gjallë

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Definon përbërësit e piramidës ushqimore në ekosistemet e gjalla, sipas rolit të tyre: prodhues, konsumues dhe zbrërthyes, dhe lidhjen e tyre në zinxhirët ushqimorë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zinxhirët ushqimorë në ekosistem

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan lidhjen që ekziston midis gjallesave në natyrë;
 - Shpjegon sintagmën *zinxhir ushqimor*;
 - Ndërton tre zinxhirë ushqimorë me figura ose fjalë;
 - Argumenton rëndësinë e bimëve në zinxhirin ushqimor.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fotografji kafshësh dhe bimësh të prera në katrorë të vegjël, format i madh letre, ngjitës, mjete shkrimi, fletorja e nxënësit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Parashikim me terma paraprakë

Shkruhen disa fjalë në tabelë dhe kërkohet nga nxënësit të shkruajnë një tekst në të cilin duhet të renditin fjalët e dhëna dhe të argumentojnë renditjen e tyre.


bimë, shqiponjë, mi, fara bimësh, gjarpër.

2.10. ZINXHIRËT USHQIMORË NË EKOSISTEM

Fjalët kyçe
 zinxhiri ushqimor, ekosistemi, prodhuesi, konsumuesi, zbrërthyesit.

Në një vend të caktuar (ekosistem), jetojnë lloje të ndryshme të organizmave, të cilët ushqehen me njëri-tjetrin. Grupi i parë i organizmave janë bimët, të cilat e prodhojnë vetë ushqimin (ndryshe quhen prodhues). Grupi tjetër i organizmave janë shtazët (harxhuesit - konsumuesit), disa prej të cilëve ushqehen me bimë

(bimëngrënësit), ndërsa të tjerët ushqehen me kafshë (mishngrënësit). Grupi i fundit i organizmave janë bakteret dhe disa kërpudha (zbrërthyesit), të cilët zbrërthejnë materiet organike (mbetjet e bimëve dhe kafshëve të vdekura). Varësisht se si ushqehen organizmat me njëri-tjetrin, kemi këtë renditje: *prodhuesit* (bimët), *konsumuesit e rendit të parë* (bimëngrënësit), *konsumuesit e rendit të dytë* (mishngrënësit), *konsumuesit e rendit të tretë* (mishngrënësit e mishngrënëseve) dhe *zbrërthyesit* (bakteret dhe disa kërpudha). Një renditje e tillë e organizmave njëri pas tjetrit, në formë të zinxhirit, quhet *zinxhir ushqimor*.



Në ekosistem rrallë kemi raste kur një organizëm ushqehet vetëm me një organizëm tjetër. Zakonisht, një organizëm ushqehet me më shumë se dy organizma të tjerë. Në këto raste zinxhirët ushqimorë ndërthuren mes vete dhe formojnë *rrjetën ushqimore*.

Në bashkëpunim me shokët dhe shoqet dhe me ndihmën e mësueses/fit, bëni një zinxhir ushqimor, duke u bazuar në figurën lart.

Pyetje

1. Trego renditjen e organizmave në një zinxhir ushqimor.
2. Ku qëndron rëndësia e organizmave në hallkën e fundit të zinxhirit ushqimor?
3. Në cilat raste kemi rrjetën ushqimore?

Të mbajmë mend

- Në një ekosistem jetojnë lloje të ndryshme të organizmave, të cilët ushqehen me njëri-tjetrin.
- Zinxhiri ushqimor përbëhet nga disa hallka: prodhuesit (bimët), konsumuesit e rendit të parë (bimëngrënësit), konsumuesit e rendit të dytë (mishngrënësit) dhe zbërthyesit.
- Në rastet kur organizmat ushqehen me më shumë se dy organizma të tjerë, zinxhirët ushqimorë ndërthuren mes vete dhe formojnë rrjetën ushqimore.

Lexohen shkrimet e disa nxënësve. Shkruhen në tabelë variantet e renditjes së fjalëve.

Pyeten nxënësit:

- Mendoni se e keni parashikuar saktë renditjen?
- Lihen nxënësit të shpjegojnë mënyra të ndryshme të renditjes, të cilat më pas përmirësohen.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

Hulumtim - shqyrtim i përbashkët

Lexohet problemi në libër. U shpjegohet nxënësve sintagma *zinxhir ushqimor*. Vëzhgohet dhe komentohet figura në tekst. Nxënësit tregojnë të gjithë zinxhirët ushqimorë që formohen nga figurat. Shkruhen në tabelë disa prej tyre.

1. Bima hahet nga lepuri. Lepuri hahet nga dhelpra.
2. Nektari i lules thithet nga bleta. Bleta hahet nga zogu. Zogu hahet nga shqiponja.

Renditja e fjalëve që ju shkruat në fletore, a përbën një zinxhir ushqimor? Pse?

- Çfarë vini re në këta zinxhirë ushqimorë?
- Cila është gjallesa e parë në të?

U shpjegohet nxënësve se në bazë të çdo zinxhiri qëndron bima. Ajo e prodhon lëndën ushqyese, ndërsa kafshët e marrin të gatshme nga bimët ose nëpërmjet kafshëve të tjera.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**
Turi i galerisë

Nxënësit paraqesin me vizatim ose me fjalë disa zinxhirë ushqimorë. Kjo mund të bëhet edhe punë në grup, duke kombinuar me njëri-tjetrin figurat e gjallesave që kanë sjellë. Ngjiten në një format të madh dhe paraqitet në mur ose tabelë puna e secilit grup. Lexohen nga nxënësit zinxhirët ushqimorë.

Vlerësohen nxënësit me notë për veprimtarinë e kryer.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në mënyrën e ndërtimit dhe argumentimit të zinxhirëve ushqimorë.

Detyrë:

Vizato dhe përshkruaj zinxhirin ushqimor, duke formuar një ekosistem.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Ndërveprimet e organizmave të gjallë

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Definon përbërësit e piramidës ushqimore në ekosistemet e gjalla, sipas rolit të tyre: prodhues, konsumues dhe zbërthyes, dhe lidhjen e tyre në zinxhirët ushqimorë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Zinxhirët ushqimorë në ekosistem - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përshkruan rolin e bimëve në ekosistem si prodhues;
- Shpjegon renditjen e organizmave njëri pas tjetrit, duke formuar ekosistem;
- Argumenton për domosdoshmërinë e mbrojtjes së secilit organizëm në ekosistem.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Foto kafshësh dhe bimësh të prera në katorë të vegjël, format i madh letre, ngjitës, mjete shkrimi, fletorja e nxënësit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Pyetje - përgjigje

- Paraqiten para klasës disa pyetje:
- Ç'kuptoni me fjalën *ekosistem*?
 - Kush e përbën ekosistemin?
 - Cili është roli i bimëve në ekosistem?
 - Çfarë ndodh me ekosistemin nëse mungon njëri grup i organizmave?
 - Ku qëndron rëndësia e organizmave në hallkën e fundit të zinxhirit ushqimor?

2.10. ZINXHIRËT USHQIMORË NË EKOSISTEM

1. Plotësoje zinxhirin ushqimor duke përdorur shprehjet në kuti.

- prodhuesit
- konsumuesit e rendit të parë
- konsumuesit e rendit të dytë
- konsumuesit e rendit të tretë
- zbërthyesit




2. Cili është grupi i fundit i organizmave në zinxhirin ushqimor?

3. Kur organizmat ushqehen me më shumë se dy organizma të tjerë, zinxhirët ushqimorë ndërthuren dhe formojnë _____.

2.10. ZINXHIRËT USHQIMORË NË EKOSISTEM

1. Plotësoje zinxhirin ushqimor duke përdorur shprehjet në kuti.

- prodhuesit
- konsumuesit e rendit të parë
- konsumuesit e rendit të dytë
- konsumuesit e rendit të tretë
- zbërthyesit



2. Cili është grupi i fundit i organizmave në zinxhirin ushqimor?

3. Kur organizmat ushqehen me më shumë se dy organizma të tjerë, zinxhirët ushqimorë ndërthuren dhe formojnë _____.

Lihen nxënësit të lirë të japin përgjigje; nxënësit përmirësojnë njëri-tjetrin. Vazhdohet kështu duke u ndalur në rëndësinë e mbrojtjes së ekosistemit.



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**

Veprimtari me lexim-mendim të drejtuar

Nxiten nxënësit të plotësojnë në fletore pune ushtrimin e parë, duke përdorur shprehjet në kuti. Lexohen plotësimet e kryera nga dy-tre nxënës. Nxënësit plotësojnë njëri-tjetrin me fjalët që mungojnë. Në të njëjtën mënyrë veprohet dhe për dy ushtrimet e tjera.


Theksohet cikli i ndërveprimit të organizmave të gjallë në natyrë, ku secili prej tyre është i rëndësishëm për të funksionuar si tërësi.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**

Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Kërkohet nga nxënësit të punojnë në grupe dhe të mbajnë shënime sipas skemës:



Nxënësit tregojnë skemat e tyre. Bëhet përmbledhja e skemës në tabelë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në renditjen e organizmave të gjallë në ekosistem dhe argumentimin e rolit të secilit në funksionimin e ekosistemit.

Detyrë:

Shpjego pse duhet mbrojtur ekosistemi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Ndërveprimet e organizmave të gjallë

Rezultatet e të nxënësve të temës:
 Definon përbërësit e piramidës ushqimore në ekosistemet e gjalla, sipas rolit të tyre: prodhues, konsumues dhe zbërthyes, dhe lidhjen e tyre në zinxhirët ushqimorë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: III.2, III.4, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njëësia mësimore: Piramida ekologjike

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Përcakton prodhuesit dhe përbërësit në zinxhirin ushqimor;
- Përshkruan funksionin që kryejnë prodhuesit dhe përbërësit në qarkullimin e lëndëve në natyrë;
- Emërton konsumatorët në një zinxhir ushqimor;
- Argumenton rëndësinë që kanë prodhuesit dhe konsumatorët.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, projektor, fletë A4, mjete shkrimi, fletorja e nxënësit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Gushëkuqi rrethor

Punohet në grup për të përsëritur njohuritë që kanë nxënësit për zinxhirin ushqimor. Secili prej anëtarëve të grupit të thotë një ide, thënie apo pyetje rreth zinxhirit ushqimor. Pasi mbarojnë në grup, idetë më të rëndësishme thuhet me zë në klasë. Ja disa mendime:
Zinxhiri ushqimor ngjan me zinxhirin e vërtetë, sepse të dytë elementet përbërëse janë të lidhura me njëri-tjetrin. Në fillim të çdo zinxhiri qëndron një bimë. Një zinxhir ushqimor mund të ketë numër të ndryshëm gjallesash. Edhe njeriu bën pjesë në zinxhirin ushqimor.




Piramida ekologjike ka disa nivele:

Niveli i parë ushqyes përfaqësohet nga bimët e gjelbra (prodhuesit), të cilat vetë e krijojnë ushqimin. Ato përbëjnë bazën e piramidës, sepse kanë masën më të madhe.

Niveli i dytë ushqyes e përbëjnë shtazët (konsumuesit e rendit të parë), që ushqehen me bimë (bimëngrënësit), p.sh.: lepurit, kaprollit etj.

Niveli i tretë ushqyes e përbëjnë shtazët (konsumuesit e rendit të dytë), që ushqehen me kafshë bimëngrënëse (mishngrënësit), p.sh.: ujku, macja e egër etj.

Niveli i katërt ushqyes e përbëjnë shtazët (konsumuesit e rendit të tretë) që ushqehen me kafshë mishngrënëse (mishngrënësit e mishngrënëseve), p.sh.: shqiponja, luani etj.



Pyetje

1. Çfarë quajmë piramidë ekologjike?
2. Në piramidën ekologjike, cili nivel ushqyes ka numrin dhe masën më të madhe të organizmave?
3. Përmend organizmat që përbëjnë nivelin e dytë, të tretë dhe të katërt të piramidës ushqyese.

Të mbajmë mend

- Mënyra e ushqimit të organizmave me një-tjetrin mund të paraqitet edhe në formë piramidale (piramida ekologjike).
- Piramida ekologjike ka disa nivele. Nivelin e parë e përbëjnë bimët që paraqesin edhe bazën e piramidës. Nivelet e tjera i përbëjnë shtazët e ndryshme.

BOTA E GJALLË



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Vëzhgo - komento, rryjeti i diskutimit

Lihen nxënësit ta vëzhgojnë figurën në libër për disa minuta. Nxënësve u bëhen pyetje për ta përshkruar zinxhirin ushqimor.

- Çfarë ndodh me lepurin pasi ha bar?
 - A mbetet ndonjë gjë nga lepurit?
 - Çfarë ndodh me kockat e tij?
 - A mund të ndihmojnë ato në rritjen e bimëve?
- U shpjegohet nxënësve se mikroorganizmat ose bakteret shpërbëjnë gjallesat në lëndë minerale, të cilat shërbejnë si ushqim për bimët.
- A keni dëgjuar për bakteret? Si janë ato?
 - Mendoni se në këtë rast janë të dëmshme? Pse?
- Emërtohen hallkat e zinxhirit ushqimor në figurë.

Prodhues konsumator i parë konsumator i dytë konsumator i tretë
bima lepurit dhelpra luani



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Lojë

Nxënësit kanë shkruar në fletë A4 emra të ndryshëm gjallesash që formojnë zinxhirë ushqimorë. Ndahen nxënësit me grupe dhe secili prej tyre

merr nga një fletë dhe e ngjet në kurriz. Kapen nxënësit pas njëri-tjetrit, duke formuar zinxhirë ushqimorë.

Bëhen kombinime të hallkave të zinxhirit, p.sh., në vend të miut vendoset brekosa etj. Kjo veprimtari merr formën e lojës.

Vlerësohen nxënësit me notë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përcaktimin e prodhuesit, përbërësit dhe konsumatorit dhe për argumentimin e rëndësisë së tyre.

Detyrë:

U përgjigjen pyetjeve të dhëna në libër, faqe 41.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon dhe interpreton nevojat e organizmave bimorë për jetë, siç janë: uji, drita, dheu, materiet minerale dhe gazet: dyoksid karboni dhe oksigjeni.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3, III.2, VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Bimët dhe nevojat e tyre

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Përcakton kushtet e domosdoshme për rritjen e një bime;
- Përshkruan përshtatjen e bimëve ndaj kushteve të mjedisit;
- Bën dallimin ndërmjet bimëve që rriten në kushte të përshtatshme dhe bimëve që përshtaten ndaj mjedisit ku jetojnë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Bimë të ndryshme me lule, fara fasuleje, gota plastike, ujë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS






Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Hartë koncepti

Paraqitet para nxënësve një bimë dhe kërkohet që ta emërtojë. Krijohet harta e konceptit.




2.12. BIMËT DHE NEVOJAT E TYRE

Fjalët kyçe

bimët, fotosinteza, drita, oksigjeni, dyoksid karboni, sheqeri, uji.

Bimët janë organizma të cilët, me sistemin e tyre rrënjor, janë të përfurcuar për tokë. Nga toka, me anë të rrënjëve, ato marrin ujin me materie minerale. Ujin me materie minerale, përmes gypave mikroskopikë (shumë të hollë), e bartin deri në gjethe. Me anë të gjetheve, nga ajri ato marrin edhe dyoksidin e karbonit. Dyoksidi i karbonit dhe uji, me ndihmën e dritës në gjethe, shndërrohen në sheqer, i cili është ushqim për bimët. Ky proces quhet fotosinteza.

Pos ushqimit, me fotosintezë krijohet edhe oksigjeni, i cili është i domosdoshëm për frymëmarrjen e shtazëve, njeriut dhe vetë bimëve. Që të rriten dhe zhvillohen normalisht, bimët kanë nevojë për ujë, dritë, materie minerale, dyoksid karboni dhe temperaturë.



Procesi i fotosintezës

Të mbajmë mend

- Bimët nevojat e tyre për ujë dhe materie minerale i plotësojnë duke i përthithur me anë të rrënjëve dhe duke i bartur përmes gypave të ngushtë deri në pjesët e tjera.
- Nevojat për materie organike (sheqer) i plotësojnë me anën e procesit të fotosintezës.

Pyetje

1. Si furnizohen bimët me ujë dhe materie minerale?
2. Përkruaj formimin e materieve organike (sheqerit) në bimë.
3. Çfarë u nevojitet bimëve që të rriten dhe zhvillohen normalisht?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Grupi i ekspertëve

Ndahet klasa në grupe me nga 5 nxënës. Secili anëtar është përgjegjës për të lexuar një pjesë. Jepen pyetjet e përgatitura për çdo grup, me nga 2 pyetje, të cilat ndihmojnë të përmbledhin më mirë tekstin. Kështu, mësimi ndahet në dy çështje.

Pjesët e bimës

Nxënësi A - Cilat janë pjesët e bimës?

Eksperti A - Çfarë funksione kanë ato?

Fotosinteza

Nxënësi B - Si krijohet procesi i fotosintezës?

Eksperti B - Për çfarë kanë nevojë bimët?

Nxënësit lexojnë në mënyrë të pavarur pjesët e përzgjedhura. Rigrupohen nxënësit sipas shkronjës që kanë. Diskutohen dhe krahasohen përgjigjet e tyre, shënimet; kërkojnë shpjegime në mënyrë që të kthehen në ekspertë për pjesën e tyre.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Ekspertim - Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Hapi I: Ndahet klasa në grupe. Secili grup ka pesë

gota plastike, 20 fara fasuleje, një kuti këpucësh me kapak, ujë, gotë kimike të shkallëzuar.

Hapi II: Nxënësit zhvillojnë eksperimentin sipas udhëzimeve të dhëna në libër.

Hapi III: Çdo nxënës mban shënime në fletoren e tij.

Hapi IV: Kërkohet nga nxënësit të parashikojnë cilat nga farat do të mbijnë.

Pasi nxënësit punojnë në mënyrë individuale, mësuesi u kërkon të bëjnë parashikime në grup.

Hapi V: Kërkohet nga nxënësit të paraqesin atë çka zhvilluan dhe parashikimet e tyre në tabelë.

Pyeten nxënësit:

- Pse mendoni se do të mbijë?
- Pse nuk mund të mbijë?

Përfundimet e kësaj ore lihen të hapura, pasi nxënësit do të vëzhgojnë nga afër mbirjen e farës.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në përcaktimin e kushteve të domosdoshme për rritjen e bimëve, si dhe përshtatjen e bimëve me mjedisin.

Detyrë:

Përkruaj procesin e fotosintezës te bimët.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon dhe interpreton nevojat e organizmave shtazorë për jetë: nevojat për ushqim me bazë bimore dhe shtazore, ujë, strehim, riprodhim etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: II.1, II.7, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Kafshët dhe nevojat e tyre

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon kafshët në bazë të figurave;
- Grupon kafshët e buta dhe të egra, sipas mënyrës së të ushqyerit;
- Argumenton rëndësinë që kanë për njeriun kafshët e buta.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Figura kafshësh të prera, fletë A4, mjete shkrimi, fletorja e nxënësit, burime nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë:

Rendit, grupo, emërto

Nxënësit kanë sjellë figura kafshësh të ndryshme të prera. Pasi grumbullohen, u jepen në grup dhe kërkohet prej tyre:

1. Identifikoni me radhë çdo kafshë.
2. Mundohuni t'i gruponi sipas një cilësie.

Pasi t'i kenë grupuar, nëse nuk kanë arritur t'i grupojnë në bazë të mënyrës së të ushqyerit, atëherë u shpjegohet edhe grupimi i kafshëve në bazë të mënyrës së të ushqyerit.

2.13. KAFSHËT DHE NEVOJAT E TYRE

Kafshët janë organizma që lëvizin lirishit nga një vend në tjetrin. Lëvizja u mundëson që t'i shmangin armiqtë, të gjejnë ushqim dhe të shoqërohen mes vetë. Kafshët nuk e prodhojnë vetë ushqimin; disa prej tyre ushqehen me bimë dhe qohen bimëngrënëse, të tjerat ushqehen me mish dhe qohen mishngrënëse, ndërsa llojet e tjera ushqehen me bimë dhe me kafshë dhe qohen gjithçkangrënëse.


Fjalët kyçe

kafshët, bimëngrënëse, mishngrënëse, vendstrehimi.



Kafshë bimëngrënëse

Për jetë normale kafshëve u duhet edhe streha, në të cilën jetojnë dhe i rritin pasardhësit. Si strehë kafshët përdorin vende të ndryshme në natyrë, p.sh.: shpellat, gropat në tokë, vrimat e trunqeve, por disa kafshë ndërtojnë vetë strehën e tyre (çerdhen), p.sh.: dallëndyshja, laraska, korbi etj. Të gjitha kafshët riprodhohen (shumohen) në mënyrë seksuale, por ka dhe disa shtazë primitive që mund të riprodhohen në mënyrë joseksuale.



Kafshë mishngrënëse



Vendstrehimet e ndryshme të kafshëve

Pyetje

1. Identifiko mënyrat e ushqimit të kafshëve.
2. Shëno vendstrehimet e kafshëve të ndryshme.
3. Si riprodhohen kafshët?

Të mbajmë mend

- Lëvizja u mundëson kafshëve që t'i shmangin armiqtë, të gjejnë ushqim dhe të shoqërohen mes vetë.
- Disa prej kafshëve ushqehen vetëm me bimë, disa vetëm me mish, disa janë gjithçkangrënëse.
- Për nevojat e veta të strehimit, kafshët e ndryshme përdorin vende të ndryshme në natyrë.

2.13. KAFSHËT DHE NEVOJAT E TYRE

Kafshët janë organizma që lëvizin lirish nga një vend në tjetrin. Lëvizja u mundëson që t'i shmangin armiqtë, të gjejnë ushqim dhe të shoqërohen mes vete. Kafshët nuk e prodhojnë vetë ushqimin; disa prej tyre ushqehen me bimë dhe quhen bimëngrënëse, të tjerat ushqehen me mish dhe quhen mishngrënëse, ndërsa llojet e tjera ushqehen me bimë dhe me kafshë dhe quhen gjithçkangrënëse.

Për jetë normale kafshëve u duhet edhe streha, në të cilën jetojnë dhe i rritin pasardhësit. Si strehë kafshët përdorin vende të ndryshme në natyrë, p.sh.: shpellat, gropat nën tokë, vrimat e trungjeve, por disa kafshë ndërtojnë vetë strehën e tyre (çerdhen), p.sh.: dallëndyshja, laraska, korbi etj. Të gjitha kafshët riprodhohen (shumohen) në mënyrë seksuale, por ka dhe disa shtazë primitive që mund të riprodhohen në mënyrë joseksuale.

Fjalët kyçe

kafshët, bimëngrënëse, mishngrënëse, vendstrehimi.



Kafshë bimëngrënëse



Kafshë mishngrënëse



Vendstrehimet e ndryshme të kafshëve

Pyetje

1. Identifiko mënyrat e ushqimit të kafshëve.
2. Shëno vendstrehimet e kafshëve të ndryshme.
3. Si riprodhohen kafshët?

Të mbajmë mend

- Lëvizja u mundëson kafshëve që t'i shmangin armiqtë, të gjejnë ushqim dhe të shoqërohen mes vete.
- Disa prej kafshëve ushqehen vetëm me bimë, disa vetëm me mish, disa janë gjithçkangrënëse.
- Për nevojat e veta të strehimit, kafshët e ndryshme përdorin vende të ndryshme në natyrë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Rishikim në dyshe, harta e konceptit

Njohuritë e reja merren duke lexuar materialin në çift. Pjesa e parë e mësimit përfshin grupimin e kafshëve në bazë të mënyrës së ushqimit dhe pjesa e dytë strehimin dhe shumimin e tyre. Në pjesën e parë, një nxënës lexon me zë, përmbledh çështjet kryesore, ndërsa nxënësi tjetër, pasi e dëgjon, i bën dy pyetje rreth pjesës. Kur mbaron së studiuar pjesën e parë, diskutohet me gjithë klasën. Saktësohen njohuritë e nxënësve. Në të njëjtën mënyrë veprohet edhe me pjesën e dytë. Plotësohet në tabelë harta e konceptit.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Tabelë përmbledhëse

Vendosen në tabelë emrat e kafshëve të identifikuar, duke i grupuar ato në bazë të mënyrës së të ushqyerit. (Punë në grup si tek evokimi.)

Kafshë mishngrënëse	Kafshë barngrënëse	Kafshë gjithçkangrënëse

Në fund, vihet theksi te mbrojtja dhe kujdesi që duhet të kemi për kafshët dhe rëndësia e kafshëve për jetën e njeriut. Vlerësohen nxënësit me notë.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen nxënësit për saktësinë në identifikimin e tyre, grupimin në bazë të ushqyerjes dhe argumentimin e rëndësisë së tyre për njeriun.

Detyrë:

Shkruaj tri këshilla për mbrojtjen e kafshëve.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Nevojat jetësore të njeriut, ushqimi dhe higjiena personale

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon dhe interpreton nevojat e organizmave shtazorë për jetë: nevojat për ushqim me bazë bimë dhe shtazore, ujë, strehim, riprodhim etj.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1, II.7, III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.2, 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Nevojat e bimëve dhe të kafshëve - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon nevojat e bimëve dhe kafshëve për jetësor;
- Përcakton rolin e secilës pjesë të një bime të zhvilluar në procesin e saj jetësor;
- Grupon kafshët sipas mënyrës së të ushqyerit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Figura kafshësh të prera, fletë A4, mjete shkrimi, fletorja e nxënësit, burime nga interneti.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Lojëra

Shkruhen në tabelë përballë njëra-tjetrës këto fjalë:


numri i llojeve të bimëve

numri i llojeve të kafshëve

Kërkohet nga nxënësit që të vendosin shenjën e mosbarazimit. Këtu lexohen kuriozitetet për numrin e llojeve të kafshëve, duke theksuar se ai është shumë më i madh sesa numri i llojeve të bimëve.

2.12. NEVOJAT E BIMËVE DHE TË KAFSHËVE

1. Shëno fjalët e duhura në figurë.



2. Shëno në tabelë llojet e kafshëve.

Mishngrënëse	Bimëngrënëse
•	•
•	•
•	•
•	•
•	•
•	•
•	•
•	•
•	•
•	•

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Edukimi seksual

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Definon konceptin e familjes dhe strukturat e ndryshme (me dy prindër, me një prind...).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1; II.5; III.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Familja

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përcakton lidhjen nga e cila krijohet një familje;
 - Dallon familjen e ngushtë nga familja e gjerë;
 - Identifikon rolet e anëtarëve brenda familjes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Copëza të përziera, etiketa, fletë A3.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
Dil rrotull - fol rrotull

Mësuesja shkruan në tabelë pyetjen:

- Me kë jeton ti?
- Udhëzohen nxënësit të lëvizin nëpër klasë. Kur mësuesja i bie ziles, ata kapin për dore shokun a shoqen më të afërt dhe diskutojnë në heshtje duke iu përgjigjur pyetjes. Më pas, mund të vazhdohet edhe me pyetje të tjera, si:
- Cilat punë i bën nëna në shtëpi? Po babi?

- Ja një shembull i mundshëm:
- Me kë ishe në dyshe, Ana?
 - Isha me Drinin.



2.14. FAMILJA

Fjalët kyçe

familja, e gjerë, e ngushtë, anëtarët, fëmijët.

Njerëzit janë qenie shoqërore që jetojnë në bashkësi, d.m.th. janë pjesë e një familjeje. Familjet përbëhen nga dy ose më shumë persona, të cilët janë të lidhur mes vete nga ana biologjike, birësimi, martesë ose lidhjet e forta emocionale. Të gjithë anëtarët e familjes duhen mes vete dhe kujdesen për njëri-tjetrin. Familjen e gjerë e përbëjnë: prindërit, fëmijët, gjyshërit, xhaxhallarët, hallat dhe tezet. Ndërsa, familjen e ngushtë e përbëjnë prindërit dhe fëmijët.



Familja

Të mbajmë mend

- Familjet përbëhen nga dy ose më shumë persona, të cilët janë të lidhur mes vete nga ana biologjike, birësimi, martesë ose lidhjet e forta emocionale.
- Familja e ngushtë përbëhet nga prindërit dhe fëmijët, ndërsa ajo e gjerë nga gjyshërit, xhaxhallarët, hallat, dajallarët dhe tezet.
- Zakonisht, prindërit kujdesen që fëmijëve t'u sigurojnë strehë, ushqim, shkollim etj.

Në familje, për fëmijët përkujdesen prindërit ose kujdestarët. Anëtarët e familjes kanë role dhe nevoja të ndryshme në familje. Zakonisht, prindërit/kujdestarët kujdesen që fëmijëve t'u sigurojnë strehë, ushqim, shkollim etj. Ndërsa, fëmijët, pos mësimin, kujdesen edhe për rregullimin e gjërave të tyre personale dhe kryejnë ndonjë punë tjetër të shtëpisë.

Pyetje

- Cilat janë lidhjet që e përcaktojnë përbërjen e një familjeje?
- Përshkruaj familjen e ngushtë dhe atë të gjerë.
- Për çfarë duhet të kujdesen prindërit e për çfarë fëmijët në familje?

BOTA E GJALLË

44

- Me kë jeton Drini? Me babin dhe mamin.
 - Po Ana, me kë jeton, Drin?
 - Ana jeton me gjyshërit dhe prindërit.
- Më pas, vazhdohet edhe me të tjera pyetje.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Copëza të përziera

Kërkohet nga nxënësit t'i hapin librat dhe lexohet mësimi në mënyrë zinxhurore. Shpjegohen fjalët a nocionet e panjohura.

Ndahen nxënësit në grupe. Secilit grup i shpërndahet materiali i punës. Në fletushka të vogla krijohen disa përshkrime të shkurtra, të cilat paraqesin llojin e lidhjes, përbërjen e familjes dhe rolet e anëtarëve, kurse në disa etiketa të tjera të vogla shkruhet lloji i lidhjes, përbërja e familjes apo anëtarë i duhur sipas rolit të dhënë. Nxënësit i bashkojnë ato sipas lidhjes përkatëse me kuptim të saktë, duke i vendosur në fletë A3.

Ja një shembull i mundshëm:

Unë jam Kroi. Nëna ime më ka treguar që, kur isha i vogël, ajo më kishte marrë nga qendra e fëmijëve që jetojnë pa prindër. Unë i dua shumë prindërit e mi.

Përhëndetje! Unë jetoj në një shtëpi të madhe bashkë me prindërit, gjyshërit, hallat dhe xhaxhanë.

Familje e ngushtë

Lidhja biologjike

Birësimi

Gjyshi

Familje e gjerë

Prindërit

Kujdesen që unë të shkollohem, të kem ushqim dhe strehim.

Kujdeset për kopshtin e shtëpisë dhe më merr nga shkolla.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënës

Mendo dhe përgjigju

Babai i nënës sime është _____ im.

Djali i motrës së babit tim është _____ i _____ time.

Nëse unë jetoj vetëm me dy prindërit e mi, atëherë familja ime është familje e _____.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për përcaktimin e saktë të lidhjes së krijimit të familjes, dallimin e familjes së gjerë nga ajo e ngushtë dhe për caktimin e roleve të anëtarëve të familjes.

Detyrë:

Krijon trungun e familjes në një fletë pune të dhënë nga mësuesi/ja.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Edukimi seksual

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshekruan nevojat dhe rolet e anëtarëve brenda familjes;

Shpreh emocionet, dëshirat dhe nevojat e saj/tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4; III.1; III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Emocionet, dëshirat dhe nevojat e anëtarëve të familjes

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon funksionin themelor të familjes;
- Identifikon emocionet, dëshirat dhe nevojat brenda anëtarëve të familjes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë pune me hartën e konceptit.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shakthësi për jetë, Gjuhë amtare, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Ora mësimore fillohet me detyrën e shtëpisë, e cila ishte hartim i trungut familjar. Përzgjidhet një punim në të cilin është paraqitur familja e ngushtë dhe një familja e gjerë. Vendosen në tabelë dhe diskutohen karakteristikat e ndryshme. Gjatë prezantimit, bëhen pyetje të ndryshme rreth rolit të anëtarëve që kanë në familje, si:

- Çfarë detyra ka motra jote në shtëpi?
- Kush kujdeset për të sjellë ushqim në familje?
- Kush gatuan?

2.15. EMOCIONET, DËSHIRAT DHE NEVOJAT E ANËTARËVE TË FAMILJES

Anëtarët e familjes jetojnë së bashku dhe shoqërohen mes vete. Shoqërimi është njëri prej funksioneve kryesore të familjes, veçanërisht i rëndësishëm është shoqërimi i fëmijëve. Prindërit në familje kanë për detyrë që t'i mësojnë fëmijët si të sillen në shoqëri.

Fjalët kyçe

emocionet, dëshirat, nevojat, shoqërimi, prindërit.

Anëtarët e familjes i shprehin njëri-tjetrit emocionet, dëshirat dhe nevojat. Familja plotëson nevojat emocionale të të gjithë anëtarëve të saj. Anëtarët e familjes, po ashtu, kujdesen për plotësimin e dëshirave dhe nevojave të njëri-tjetrit, p.sh., ndihmojnë njëri-tjetrin në punët e përditshme, kur janë të sëmurë, ndihmojnë fëmijët në mësim etj. Njerëzit kanë nevojë vazhdimisht për ndihmë dhe mbështetje emocionale; vendi më i mirë për të gjetur këtë ndihmë është familja.



Shoqërimi i fëmijëve



Prindërit ndihmojnë fëmijët

Pyetje

1. Cili është funksioni kryesor në një familje?
2. Çfarë i shprehin njëri-tjetrit anëtarët e familjes?
3. Pse vendi më i mirë për ndihmë është familja?

Të mbajmë mend

- Nevojat e anëtarëve të familjes për njëri-tjetrin janë të zakonshme. Ata kanë nevojë për shoqërim dhe ndihmë për njëri-tjetrin vazhdimisht.
- Prindërit në familje kanë për detyrë që t'i mësojnë fëmijët si të sillen në shoqëri, t'i ndihmojnë ata në shkollim etj.

2.15. EMOCIONET, DËSHIRAT DHE NEVOJAT E ANËTARËVE TË FAMILJES

Anëtarët e familjes jetojnë së bashku dhe shoqërohen mes vete. Shoqërimi është njëri prej funksioneve kryesore të familjes, veçanërisht i rëndësishëm është shoqërimi i fëmijëve. Prindërit në familje kanë për detyrë që t'i mësojnë fëmijët si të sillen në shoqëri.

Fjalët kyçe

emocionet, dëshirat, nevojat, shoqërimi, prindërit.

Anëtarët e familjes i shprehin njëri-tjetrit emocionet, dëshirat dhe nevojat. Familja plotëson nevojat emocionale të të gjithë anëtarëve të saj. Anëtarët e familjes, po ashtu, kujdesen për plotësimin e dëshirave dhe nevojave të njëri-tjetrit, p.sh., ndihmojnë njëri-tjetrin në punët e përditshme, kur janë të sëmurë, ndihmojnë fëmijët në mësim etj. Njerëzit kanë nevojë vazhdimisht për ndihmë dhe mbështetje emocionale; vendi më i mirë për të gjetur këtë ndihmë është familja.



Shoqërimi i fëmijëve



Prindërit ndihmojnë fëmijët

Të mbajmë mend

- Nevojat e anëtarëve të familjes për njëri-tjetrin janë të zakonshme. Ata kanë nevojë për shoqërim dhe ndihmë për njëri-tjetrin vazhdimisht.
- Prindërit në familje kanë për detyrë që t'i mësojnë fëmijët si të sillen në shoqëri, t'i ndihmojnë ata në shkolim etj.


Pyetje

1. Cili është funksioni kryesor në një familje?
2. Çfarë i shprehin njëri-tjetrit anëtarët e familjes?
3. Pse vendi më i mirë për ndihmë është familja?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive: Përpunimi i përmbajtjes Harta e konceptit

Nxënësve u jepet një fletë e punës, në të cilën paraqitet harta e konceptit për njësinë mësimore. Udhëzohen fillimisht që ta lexojnë mësimin dhe pastaj të punohet harta e konceptit.



Mbikëqyret vazhdimisht procesi i plotësimit, asistohet në rastet e nevojshme. Lejohet edhe bashkëpunimi me shokun a shoqen e bankës. Në fund, prezantohen konceptet nga disa nxënës, ku diskutohen edhe një herë çështjet më të rëndësishme.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Loja me role

Në një kavanaoz vendosen disa fletushka me situata të ndryshme që ndodhin në familje. Ftohen nxënësit të marrin një fletushkë dhe të luajnë rolin e përcaktuar. Ja disa shembuj të situatave që mund të vendosen:

- Vëllai yt i madh ka ardhur nga shkolla dhe fytyra e tij është e mërzhitur, sepse shokët e tij e kanë ofenduar që ai nuk është i mirë në futboll. Po të ishte ti prindi i tij, çfarë do të ndërmerrije?
- Prindërit e tu kanë probleme financiare dhe gjendja emocionale e tyre është e rëndë. Si do të vepronte ti?
- Shoqërimi është funksioni kryesor brenda familjes, por në familjen tënde nuk shoqëroheshi shumë. Si do të vepronte ti për ta ndryshuar pozitivisht këtë çështje?

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e saktë të funksionit themelor të familjes, për identifikimin e emocioneve, nevojave dhe dëshirave të anëtarëve të familjes.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Edukimi seksual

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan nevojat dhe rolet e anëtarëve brenda familjes;

Shpreh emocionet, dëshirat dhe nevojat e saj/tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.4; III.1; III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Emocionet, dëshirat dhe nevojat e anëtarëve të familjes - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon rolin e familjes në jetën e tij;
- Identifikon dëshirat e shokëve dhe shoqeve të klasës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletushka, kavanoz.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shoqëria dhe mjedisi, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë


Rrjeti i diskutimit

Në tabelë shkruhet pyetja:

A do të jetonit të vetëm, pa familje?



Lexohen përgjigjet dhe diskutohen mendimet e nxënësve.



2.13. EMOCIONET, DËSHIRAT DHE NEVOJAT E ANËTARËVE TË FAMILJES

1. Formojeni një rreth, bashkë me mësuesen/in, dhe bisedoni për familjen.



2. Përkrahuj familjen tënde. Nga sa anëtarë përbëhet familja jote?



3. Kush të ndihmon më shumë në familje rreth mësimeve dhe gjërave të tjera që të nevojiten?

4. Trego se cilët janë shokët dhe shoqet e tua më të mira. Cilat janë dëshirat e tua dhe të shokut a shoqes sate?

Unë	Shoku/shoqja
Më pëlqen të luaj futboll...	
	I pëlqen...

BOTA E GJALLË

27



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive: Përpunimi i përmbajtjes Mësimdhënie e drejtuar

Udhëzohen nxënësit t'i hapin fletoret e punës, faqe 27, dhe punohen ushtrimet me radhë, në mënyrë individuale.

Leximi i përgjigjeve bëhet në formë të intervistës. Një nxënës pyet, tjetri lexon përgjigjet. Pasi të plotësohen dhe diskutohen ushtrimet 1, 2 dhe 3, shkruhet në tabelë.

Ku tjetër e ndien veten si në familje?

--	--	--



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët Kavanozi me dëshira

Përgjigjet mund të jenë nga më të ndryshmet, si te dajat, tezet, xhaxhai, gjyshërit, klasë a shkollë.

Në rast që merret si përgjigje në klasë, i vihet theksi sepse ushtrimi i radhës ka të bëjë me dëshirë.

rat e shokëve dhe shoqeve. Mirëpo, u shpjegohet se do të bëhet pak më ndryshe se detyra në libër. Secili nxënës shkruan dëshirat e tij në një fletushkë, e palos atë dhe e vendos në një kavanoz. Më pas, të gjitha ato përzihen. Të gjithë nxënësit me radhë e zgjedhin nga një fletushkë. Lexohet dëshira dhe nxënësi hamendëson se kush e ka atë dëshirë - në këtë mënyrë do të kuptojnë sa mirë e njohin njëri-tjetrin brenda klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për dallimin e saktë të rolit të familjes në jetën e tij, gjatë plotësimit të detyrave, për pjesëmarrjen aktive në diskutime dhe për identifikimin e dëshirave të shokëve dhe shoqeve.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Fërkimi dhe shtypja

Rezultatet e të nxënit të temës:

Dallon sipërfaqet e lëmuara nga sipërfaqet e vrazhda të trupave dhe gjen shembuj për varësinë e fërkimit nga lloji i materialit të sipërfaqeve takuese.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.2; II.8; III.4; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fërkimi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon fërkimin si proces fizik;
- Dallon sipërfaqet e lëmuara nga të vrazhdat;
- Krahason forcën e fërkimit të trupave me masë më të madhe nga ata me masë më të vogël.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Bankë, fletë pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shakthësi për jetë, Gjuhë amtare, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Përzgjidhet një nxënës për ta lëvizur bankën e mësueses, duke e shtyrë me duar. Më pas, bëhen disa pyetje:

- A ishte e vështirë ta lëvizje bankën?
- Pse u dëgjua zhurmë derisa ti po e shtyje zvarrë bankën?


Përfundohet se banka po fërkohet me tokën, prandaj është vështirë të lëvizet dhe njëkohësisht krijohet zhurmë. Më pas, mbi bankë vendosen gjëra të rënda. I njëjti nxënës do ta lëvizë bankën përsëri duke e zvarritur. Pyetet përsëri:

- Po tani, a ishte e vështirë që ta lëvizje bankën?
- Përgjigjja e mundshme do të jetë që këtë radhë lëvizja u bë edhe më e vështirë.
- Pse mendon se e kishe edhe më të vështirë?

3.1. FËRKIMI

Fërkim kemi atëherë kur dy trupa janë në kontakt mes vete. Gjatë fërkimit paraqitet një lloj force ndërmjet dy objekteve, e cila pengon lëvizjen e tyre. Kjo forcë quhet forcë e fërkimit. Forca e fërkimit varet nga sipërfaqja kontaktuese e trupave dhe nga masa e tyre. Nëse trupat që fërkohen kanë sipërfaqe të lëmuara, atëherë forca e fërkimit është e vogël. Sa më e vrazhdë të jetë sipërfaqja kontaktuese, aq më e madhe është forca e fërkimit. P.sh., topi që lëviz në sipërfaqe të lëmuara ka forcë më të vogël fërkimi dhe e arrin distancën më të madhe, sesa topi që lëviz në sipërfaqe të vrazhdë.

Fjalët kyçe
forca, fërkimi, trupat.



Forca e fërkimit të topit në sipërfaqe të lëmuara dhe të vrazhdë

Nëse trupat që fërkohen kanë peshë (masë) të lehtë, forca e fërkimit është më e vogël; ajo rritet, me rritjen e peshës së trupave. P.sh.: nëse ne e shtyjmë një dollap plot me rroba, forca e fërkimit është më e madhe, ndërsa, nëse e shtyjmë dollapin e zbrazët, forca e fërkimit është më e vogël.



Forca e fërkimit të dollapit me peshë të lehtë dhe të rëndë

Pyetje

1. Çfarë paraqitet gjatë fërkimit të dy trupave?
2. Dalo forcën e fërkimit në mes të trupave të vrazhdë dhe të lëmuara.
3. Shpjego me shembuj mënyrën e fërkimit të trupave me pesha të ndryshme.

Të mbajmë mend

- Gjatë fërkimit, paraqitet një lloj force ndërmjet dy objekteve, e cila pengon lëvizjen e tyre.
- Forca e fërkimit varet nga sipërfaqja kontaktuese e trupave dhe nga masa e tyre.

3.1. FËRKIMI

Fërkim kemi atëherë kur dy trupa janë në kontakt mes vete. Gjatë fërkimit paraqitet një lloj force ndërmjet dy objekteve, e cila pengon lëvizjen e tyre. Kjo forcë quhet forcë e fërkimit. Forca e fërkimit varet nga sipërfaqja kontaktuese e trupave dhe nga masa e tyre. Nëse trupat që fërkohen kanë sipërfaqe të lëmuar, atëherë forca e fërkimit është e vogël. Sa më e vrazhdë të jetë sipërfaqja kontaktuese, aq më e madhe është forca e fërkimit. P.sh., topi që lëviz në sipërfaqe të lëmuar ka forcë më të vogël fërkimi dhe e arrin distancën më të madhe, sesa topi që lëviz në sipërfaqe të vrazhdë.

Fjalët kyçe

forca, fërkimi, trupat.



Forca e fërkimit të topit në sipërfaqe të lëmuar dhe të vrazhdë

Nëse trupat që fërkohen kanë peshë (masë) të lehtë, forca e fërkimit është më e vogël; ajo rritet, me rritjen e peshës së trupave. P.sh.: nëse ne e shtyjmë një dollap plot me rroba, forca e fërkimit është më e madhe, ndërsa, nëse e shtyjmë dollapin e zbrazët, forca e fërkimit është më e vogël.



Forca e fërkimit të dollapit me peshë të lehtë dhe të rëndë

Pyetje

1. Çfarë paraqitet gjatë fërkimit të dy trupave?
2. Dallo forcën e fërkimit në mes të trupave të vrazhdë dhe të lëmuar.
3. Shpjego me shembuj mënyrën e fërkimit të trupave me peshë të ndryshme.

Të mbajmë mend

- Gjatë fërkimit, paraqitet një lloj force ndërmjet dy objekteve, e cila pengon lëvizjen e tyre.
- Forca e fërkimit varet nga sipërfaqja kontaktuese e trupave dhe nga masa e tyre.

PROCESI FIZIKE

Si përgjigje pritet të merret që banka ishte edhe më e rëndë.

- Çfarë po ndodh me bankën dhe me sipërfaqen e tokës?

Arrihet në përfundim bashkërisht që ato po fërkohen me njëra-tjetrën.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Pyetja sjell pyetjen

Shkruhen në tabelë disa pyetje. Derisa mësuesja shkruan, lexohet mësimi nga nxënësit.

Pyetjet:

- Kur ndodh fërkimi?
- Kush e pengon lëvizjen kur dy trupa fërkohen?
- Shkruaj një rast nga jeta e përditshme ku ndodh fërkimi.
- Te cili lloj i sipërfaqes forca e fërkimit është më e madhe dhe te cila më e vogël?

Ndahet faja e fletores në tri pjesë, ose jepet fleta e gatshme me tri kolona. Kontrollon procesin e punës vazhdimisht dhe në fund lexohen shkrimet e bëra nga disa nxënës.

Pyetje	Çfarë di unë për këtë njësi?	Marrëdhënie shkak-pasojë
Kur ndodh fërkimi?	Fërkimi ndodh kur dy trupa janë në kontakt mes vete.	Nëse trupi peshon më shumë, forca e fërkimit do të jetë më e madhe.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Shkathtësi dhe saktësi në grupe

Ndahen grupet. Fleta e punës vendoset në një vend. Nxënësit bëhen rresht. Fillon i pari dhe jep përgjigjen dhe, kur e përfundon, shkon në fund, duke i lënë radhën të dytit. Grupi që e përfundon shpejt dhe saktë përgëzohet dhe duartroket.

- Rrotat e makinës fërkohen me _____;
- Te biçikleta, kur lëvizja bëhet në rrugë të vrazhdë me gur, forca e fërkimit është më e _____ se në rrugë të asfaltuar.
- Nëse trupi ka masë më të madhe, fërkimi do të jetë më i _____.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për identifikimin e fërkimit si proces fizik, për saktësinë në dallimin të indikatorëve që ndikojnë që forca e fërkimit të jetë më e madhe apo më e vogël.

Detyrë:

Të plotësohet në fletore pune, faqe 29.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Fërkimi dhe shtypja

Rezultatet e të nxënit të temës:

Demonstron dallimin e fërkimit të qetësisë, të lëvizjes dhe të rrokullisjes.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: II.1; II.4; III.5; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fërkimet mes trupave me gjendje të ndryshme agregate

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon fërkimet mes trupave me gjendje të ndryshme agregate;
- Përcakton llojet e fërkimeve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Makinë lodër, figura, fletë pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Copëza të përziera

Nxënësit ndahen në grupe dhe u jepen disa figura. Figurat bashkohen duke krijuar çifte, pra një objekt dhe hapësira ose vendi ku vepron, p.sh., vetura bëhet bashkë me rrugën, këpucët me trotuarin, anija me ujin, aeroplani me qiellin.



Kuptohet që fërkimi ndodh edhe mes trupave me gjendje të ndryshme agregate.

FËRKIMI DHE SHTYPJA

3.2. FËRKIMET MES TRUPAVE ME GJENDJE TË NDRYSHME AGREGATE

Fjalët kyçe

fërkimi, gjendja agregate, e lëngët, e ngurtë, e gaztë, qetësi, lëvizje, rrokullisje.

Fërkimi ndodh mes trupave me gjendje të ndryshme agregate (të ngurtë, të lëngët dhe të gaztë). P.sh., kur aeroplani fluturon në ajër, ai fërkohet me grimca të ajrit, në këtë rast ajri (gazi) i bën rezistencën aeroplanit (i ngurtë). Ngjashëm ndodh edhe kur anija lundron në ujë (ajo fërkohet me ujin), kështu uji (lëngu) i bën rezistencë anijes (e ngurtë) dhe e ngadalëson lëvizjen e saj.



Fërkimi i trupit të ngurtë (aeroplanit) me ajrin (gaz)



Fërkimi i trupit të ngurtë (anija) në sipërfaqe të ujit (lëng)



Rrëshqitja me ski, shembulli i fërkimit mes trupave të ngurtë

Fërkimin dhe forcën e fërkimit (rezistencën) ne e takojmë vazhdimisht në jetën e përditshme, p.sh.: kur ne lëvizim, kur lëvizim pajisje të ndryshme në shtëpi, kur frenojmë automjetet, kur pastrojmë etj.

PROCESET FIZIKE

3.2. FËRKIMET MES TRUPAVE ME GJENDJE TË NDRYSHME AGREGATE

1. Lidhni me vizë figurën e duhur me përshkrimin në kator.

Fërkimi i trupit të ngurtë me ajrin.



Fërkimi i trupit të ngurtë në sipërfaqe të lëngët.



Fërkimi mes trupave të ngurtë.



2. Plotëso në figurë llojet e fërkimeve.



Fërkimi i _____ Fërkimi i _____ Fërkimi i _____



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Tabela e koncepteve**

Fillimisht lexohet mësimi.

Bëhen pyetje:

- Duke marrë parasysh që bankat tona janë mbi tokë, a mendoni se kemi apo nuk kemi fërkim, edhe pse ato nuk janë në lëvizje?

Dëgjohen disa përgjigje dhe arrihet në përfundim që fërkimi në qetësi ndodh kur dy trupa janë duke u takuar mes vete, por në ta nuk vepron asnjë forcë që i vë në lëvizje.

Mësuesi vendos një makinë lodër me rrota mbi bankë dhe fton një nxënës që ta vërë në lëvizje.

Pyeten nxënësit përsëri:

- Çfarë lloj fërkimi po vërehet tani?

Përgjigje e mundshme pritet që fërkimi po ndodh kur rrotat po rrokullisen dhe është, pra, fërkimi i rrokullisjes.

Më pas, vendoset një fotografi, ku shihet tërheqja e një objekti pa rrota, i cili vihet në lëvizje duke zvarritur (rrëshqitur).

Vendoset mbi bankë një kub i mbushur me gjëra, që të bëhet më i rëndë dhe lëvizet e njëkohësisht pyeten nxënësit se:

- Çfarë lloj fërkimi kemi këtu?

- A ka fërkim gjatë rrëshqitjes së këtij objekti? Nëse po, a është fërkim i madh apo i vogël?

- Objekti ynë po lëviz me vështirësi, cila do të ishte një zgjidhje që të kemi fërkim më të vogël e lëvizje më të shpejtë? Me anë të këtyre pyetjeve, mendohet të arrihet në përfundim që po të kishte rrota objekti, fërkimi do të ishte më i vogël e lëvizja më e shpejtë dhe se fërkimi i rrëshqitjes është shumë i madh.

Gjatë kësaj kohe, sa herë që arrihet në një përfundim, plotësohet tabela e koncepteve, e dhënë në fletë pune.

Fërkimi i qetësisë	Fërkimi i rrokullisjes	Fërkimi i lëvizjes



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Punë e pavarur**

Plotësohet në fletore pune, faqe 30, në mënyrë individuale.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në dallimin e fërkimit mes trupave me gjendje të ndryshme agregate, si dhe në përcaktimin e llojit të fërkimit.

Detyrë:

Të shkruhet nga një rast nga jeta e përditshme për secilin lloj të fërkimit.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Fërkimi dhe shtypja

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon vetitë e dëmshme dhe të dobishme të fërkimit në jetën e përditshme dhe mënyrat e zmadhimit apo zvogëlimit të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.4; III.5; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fërkimet e dobishme dhe të dëmshme

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon anët pozitive dhe negative të fërkimit;
- Njeh fërkimet e dobishme nga ato të dëmshme;
- Klasifikon fërkimet e dëmshme nga ato të dobishme.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Enë, etiketa, dy hamera.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Pro dhe kontra

Ndahet tabela në mes dhe pyeten nxënësit:

- Cilat janë anët pozitive dhe anët negative të fërkimit?

Përgjigjet e nxënësve shënohen në tabelë, po ashtu, edhe nga nxënësit në fletore.

Shembull:

Anët pozitive	Anët negative
Mban objekte. Mundëson ecjen, vrapimin. Ndalon lëvizjet, pra frenon makinat.	Ngadalëson shpejtësinë. Në sipërfaqe të lëmuara paraqet rrezik sepse zvogëlohet fërkimi.

FËRKIMI DHE SHTYPJA

3.3. FËRKIMET E DOBISHME DHE TË DËMSHME

Fjalët kyqe
fërkimi, i dëmshëm, i dobishëm, nxehtësia.

Fërkimi për njeriun mund të jetë i dobishëm dhe i dëmshëm. I dobishëm është në ato raste kur forca e fërkimit është e përshtatshme që ne të kryejmë normalisht punët tona. P.sh., fërkimi i këpucëve dhe tokës, i rrotave të makinës dhe tokës etj., këto lloje të fërkimit janë të dobishme, sepse na mundësojnë të lëvizim.

Mirëpo, nëse nuk jemi të kujdesshëm, forca e fërkimit mund të jetë e dëmshme për ne. Për shembull, nëse ecim në një sipërfaqe me akull, forca e fërkimit mes këpucëve dhe akullit është e vogël dhe ne lehtë mund të rrëshqasim dhe të rrezohemi. Po ashtu, nëse ngasim makinën me shpejtësi të madhe, zvogëlohet forca e fërkimit dhe ne lehtë mund të shkaktojmë aksident, prandaj duhet të kemi kujdes.

Gjatë fërkimit të trupave të ndryshëm, lirohet nxehtësi. Prandaj, kur ne e kemi ftohtë gjatë dimrit, fërkojmë duart që t'i ngrohim. Po ashtu, temperatura që lirohet nga fërkimi i fijes së shkrepsës me kutinë e vet, bën që ajo të ndizet.

Të mbajmë mend

- Fërkimi i dobishëm është në ato raste kur forca e fërkimit është e përshtatshme që ne të kryejmë normalisht punët tona. Mirëpo, nëse nuk jemi të kujdesshëm, forca e fërkimit mund të jetë e dëmshme për ne.
- Gjatë fërkimit të trupave të ndryshëm, lirohet nxehtësi.

Pyetje

1. Dallo fërkimin e dobishëm dhe atë dëmshëm.
2. Çfarë lirohet gjatë fërkimit të trupave? Shpjego me shembuj.

PROCESET FIZIKE

3.3. FËRKIMET E DOBISHME DHE TË DËMSHËM

Fjalët kyçe
fërkimi, i dëmshëm, i dobishëm, nxehtësia.

Fërkimi për njeriun mund të jetë i dobishëm dhe i dëmshëm. I dobishëm është në ato raste kur forca e fërkimit është e përshtatshme që ne të kryejmë normalisht punët tona. P.sh., fërkimi i këpucëve dhe tokës, i rrotave të makinës dhe tokës etj., këto lloje të fërkimit janë të dobishme, sepse na mundësojnë të lëvizim.



Fërkimi i rrotave të makinës dhe tokës




Fërkimi i këpucëve dhe tokës

Mirëpo, nëse nuk jemi të kujdesshëm, forca e fërkimit mund të jetë e dëmshme për ne. Për shembull, nëse ecim në një sipërfaqe me akull, forca e fërkimit mes këpucëve dhe akullit është e vogël dhe ne lehtë mund të rrëshqasim dhe të rrezohemi. Po ashtu, nëse ngasim makinën me shpejtësi të madhe, zvogëlohet forca e fërkimit dhe ne lehtë mund të shkaktojmë aksident, prandaj duhet të kemi kujdes.



Fërkimi i këpucëve dhe akullit

Gjatë fërkimit të trupave të ndryshëm, lirohet nxehtësi. Prandaj, kur ne e kemi ftohtë gjatë dimrit, fërkojmë duart që t'i ngrohim. Po ashtu, temperatura që lirohet nga fërkimi i fijes së shkrepës me kutinë e vet, bën që ajo të ndizet.



Fërkimi i duarve

Fërkimi i fijes së shkrepës me kutinë e vet

Të mbajmë mend

- Fërkimi i dobishëm është në ato raste kur forca e fërkimit është e përshtatshme që ne të kryejmë normalisht punët tona. Mirëpo, nëse nuk jemi të kujdesshëm, forca e fërkimit mund të jetë e dëmshme për ne.
- Gjatë fërkimit të trupave të ndryshëm, lirohet nxehtësi.

Pyetje

- Dallo fërkimin e dobishëm dhe atë dëmshëm.
- Çfarë lirohet gjatë fërkimit të trupave? Shpjego me shembuj.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Përvijim i të menduarit

Merren dy hamera. Te njëri shkruhet fërkim i dobishëm dhe tek tjetri fërkim i dëmshëm.

Me këtë rast, shpjegohen konceptet që po mësohen. Hapen librat dhe lexohet mësimi. Më pas merret një enë ku janë të vendosura disa etiketa në të cilat ka lloje të ndryshme të rasteve të fërkimeve. Nxënësit përzgjedhin një nga to, etiketa lexohet, komentohet se çfarë lloj fërkimi është e më pas vendoset në hamerin përkatës.

Fërkimi i furçës me dhëmbët

Fërkimi i këpucëve dhe akullit

Krijimi i zhurmës gjatë fërkimit

Fërkimi i këpucëve me vajin mbi tokë

Kur dy vetura ndeshen bashkë

Fërkimi i lëkurës së krahut me pjesë të forta të murit



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Rrjeti i diskutimit

Fërkimi është domosdoshmëri për të jetuar një jetë normale.

PO	JO

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për identifikimin e saktë të anëve pozitive nga ato negative të fërkimit, dallimin e dy llojeve të fërkimit dhe klasifikimin e fërkimeve të dëmshme nga ato të dobishme.

Detyrë:

Të shkruhen një fërkim i dobishëm dhe një i dëmshëm që të ndodhin gjatë javës.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Fërkimi dhe shtypja

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shqyrton shembuj të zmadhimit të temperaturës së trupit (sipërfaqes) me fërkim.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.2; III.1; III.4; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Fërkimet e dobishme dhe të dëmshme - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Kategorizon fërkimet në të dëmshme dhe të dobishme;
- Përcakton raste ku fërkimi zvogëlohet dhe ku zmadhohet.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathësi për jetë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS





Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim i njohurive paraprake

Shënohet në tabelë *fërkimi*. Disa nxënës përzgjidhen për të krijuar pyetje rreth njësive të mësuara për fërkimin, ndërsa të tjerët përgjigjen. Gjërat kryesore shënohen në tabelë dhe nxënësit i shkruajnë në fletore.



3.3 FËRKIMET E DOBISHME DHE TË DËMSHME

1. Si mendoni, cilat janë fërkime të dobishme dhe cilat të dëmshme për njeriun në jetën e përditshme? Bazohu në figurat më poshtë.



Trego ndonjë shembull:

2. Ti ke mësuar se aty ku trupat preken mes vete, paraqitet forca e fërkimit. Mirëpo, ka edhe mundësi që forca e fërkimit të rritet ose të zvogëlohet. Trego ndonjë shembull nga jeta e përditshme, ku paraqitet rritja ose zvogëlimi i forcës së fërkimit.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive: Përpunimi i përmbajtjes Të nxënësit në bashkëpunim

Ndahen grupet e punës dhe caktohen rolet e ndryshme brenda grupit. Hapet fletorja e punës, faqe 31.

Plotësohen dy ushtrimet e dhëna. Puna e nxënësve vëzhgohet vazhdimisht dhe nxiten nxënësit për ide të ndryshme gjatë plotësimit të ushtrimit.

Pasi përfundimit të kohës së parashikur, prezantuesit e grupeve dalin në tabelë për të prezantuar punën e bërë. Mund edhe të hapet ndonjë diskutim në bazë të prezantimeve të nxënësve.

Kur nxënësit punojnë, mësuesja shënon në tabelë:

Rritja e forcës së fërkimit	Zvogëlimi i forcës së fërkimit

Kjo tabelë plotësohet me shembujt që i japin nxënësit nga puna e bërë në grup.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Shkrim i shpejtë

Lëshohet një video. Videoja gjendet në vegëzen: <https://www.youtube.com/watch?v=qN0V0NXV3K-w&t=193s>

Shkruhen në fletore tri gjëra që janë mbajtur mend nga shikimi i videos dhe që u janë dukur më interesante.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për kategorizim të saktë të fërkimeve në të dëmshme dhe të dobishme, si dhe për saktësinë në përcaktim të rasteve të fërkimit të madh dhe të vogël.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Fërkimi dhe shtypja

Rezultatet e të nxënit të temës:

Identifikon fërkimin si mënyrë të ngarkimit të trupave me elektricitet.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.8; III.1; III.4; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Elektrizimi i trupave përmes fërkimit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Demonstron elektrizimin mes vizores dhe grimcave të letrës;
- Shpjegon procesin e elektrizimit me anë të fërkimit të trupave;
- Identifikon rastet e elektrizimit me fërkim nga të tjerat elektrizime.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Vizore, grimca letre, fletë pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Praktiko dhe mëso

Ndahen nxënësit në tandem. Secili nga ta duhet të ketë një vizore dhe disa grimca letre. Udhëzohen që vizoren ta vendosin mbi grimcat e letrës dhe pyeten a ndodh diçka. Si përgjigje e mundshme pritet të jetë që nuk vërehet asnjë ndryshim. Pastaj udhëzohen që vizorja të fërkohet për pantallona apo bluzë dhe me kujdes të vendosin përsëri vizoren pranë grimcave të letrës.

Nëse puna është bërë siç duhet, grimcat e letrës do të ngjiten në vizore e më pas vijohet me pyetjen:

- Pse grimcat e letrës në fillim nuk u kapën për vizore, kurse pas fërkimit të saj po?

Me anë të këtij aktiviteti, arrihet të shpjegohet njësia që do të realizohet, ku theksohet që elektrizimi ndodh kur dy trupa me ngarkesa të kundërta tërhiqen.



3.4. ELEKTRIZIMI I TRUPAVE PËRMES FËRKIMIT

Disa trupa, si p.sh., qelibari, qelqi etj., nëse fërkohen, elektrizohen. D.m.th. këta trupa ngarkohen me ngarkesa elektrike negative ose pozitive dhe tërheqin trupa të tjerë. Nëse një shufër qelibari e fërkojmë me një copë lëkure dhe e afrojmë pranë disa copa letrash të vogla, ajo do t'i tërheqë ato. Njëjtë edhe shufra e qelqit do t'i tërheqë copat e letres, nëse e fërkojmë me një copë mëndafshi. Po ashtu, këtë veti e keni vërejtur edhe kur krihni flokët, sepse krehri është elektrizuar pasi është fërkuar me flokët. Krehri në këtë rast është në gjendje të tërheqë copa letrë.

Detyrë: Testojeni, së bashku me shokët dhe shoqet e klasës dhe me mësuesin/in, se a funksionon kjo nëse e bëni fërkimin e lapsit me ndonjë trup tjetër dhe shënojeni më poshtë rezultatit.




Elektrizimi i lapsit

Pyetje

- Përshkruaje elektrizimin e trupave me shembullin e fërkimit të qelibarit ose qelqit me trupa të tjerë.
- Shpjego elektrizimin përmes shembullit të fërkimit të krehrit me flokët.

Fjalët kyçe

elektrizimi, qelibari, qelqi, krehri, lapsi.



Qelibari i elektrik



Krehri i elektrizuar

Të mbajmë mend

- Disa trupa, nëse fërkohen, mund të elektrizohen. Shembuj të tillë janë qelibari, qelqi etj.
- Elektrizimi i trupave vërehet edhe në rastin e krehjes së flokëve.

PROCESET FIZIKE



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Puna vazhdon në tandemet e krijuara. Lexohet mësimi i dhënë në libër, si dhe u jepet edhe një fletë pune me disa informacione. Lexohen dhe analizohen nga nxënësit materialet e dhëna. Në mënyrë të përbashkët, diskutohen gjërat kryesore dhe mbahen shënime.

Shembull i materialit shtesë:

Në kushte normale, lënda është elektroasnjanëse, sepse në brendësi ka aq elektrone, sa edhe protone. Që një lëndë të ngarkohet me ngarkesë elektrike, duhet të ketë tepërcicë të njëjës prej grimcave të ngarkuara kundrejt tjetrës. Meqenëse protonet janë të lidhura në bërthamë dhe bërthama është e qëndrueshme, grimcat elementare të ngarkuara që mund të shtohen në një trup janë elektronet. Me shtimin e elektroneve kundrejt protoneve, trupi fiton ngarkesë negative.

Elektrizimi i trupave përmes fërkimit			
Ndodh sepse	Sa i përket elektricitetit, trupat në qetësi janë:	Trupat që elektrizohen janë:	Trego disa shembuj të elektrizimit:



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Përgjigje të shkurtra

Plotësohet fleta e punës në mënyrë individuale, e cila përmban përmbledhje të shkurtër rreth njësisë mësimore.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për demonstrimin e elektrizimit me fërkim, saktësinë gjatë shpjegimit të procesit dhe identifikimin e saktë të rasteve të elektrizimit me fërkim.

Detyrë:


Të provohet elektrizimi me krehër dhe të shpjegohet procesi; shiko në faqen 53 në libër.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

- Vendos fjalët në hapësira të zbrazëta
Elektricitet pozitiv, elektricitet negativ



- Rretho rastet e elektrizimit me fërkim



ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Fërkimi dhe shtypja

Rezultatet e të nxënit të temës:

Vë në dukje shembuj të zmadhimit të temperaturës me fërkim të sipërfaqeve takuese.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.4; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Elektrizimi i trupave përmes fërkimit - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon informacione të ndryshme për elektrizimin e trupave;
- Demonstron elektrizimin e trupave me anë të eksperimentit;
- Dallon informacionet e pasakta nga të saktat rreth njësisë mësimore.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Shkop plastik, balona, zile, copëza letre.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Lëviz, ndalo dhe diskuto

Nxënësit lihen të lirë për të lëvizur nëpër klasë. Parashtrohet një pyetje rreth njësisë paraprake.

Shembull:

- Kur një trup fërkohe, çfarë i ndodh atij?

Pasi bëhet pyetja, nxënësit fillojnë të lëvizin e më pas thuhet stop, ose i bihet ziles. Në momentin e ndalimit, nxënësit bashkohen me personin më të afërt dhe japin përgjigje për pyetjen e bërë.

Shembull:


- Andi, çfarë përgjigje të dha Sara?

FËRKIMI DHE SHTYPJA

3-4. ELEKTRIZIMI I TRUPAVE PËRMES FËRKIMIT

1. Cilën veti e fitojnë trupat pas fërkimit?

2. Eksperiment: duke u bazuar në figura, provoni në shtëpi apo në klasë të merrni një shkop plastike dhe fërkoni atë me një copë mëndafshi; pastaj një shkop tjetër të lidhur me penj vareni në një objekt, në mënyrë që të lëvizë lirshëm.




Përkruajë rezultatit e eksperimentit.

3-4. ELEKTRIZIMI I TRUPAVE PËRMES FËRKIMIT

1. Cilën veti e fitojnë trupat pas fërkimit?

2. Eksperiment: duke u bazuar në figura, provoni në shtëpi apo në klasë të merrni një shkop plastike dhe fërkoni atë me një copë mëndafshi; pastaj një shkop tjetër të lidhur me peni vareni në një objekt, në mënyrë që të lëvizë lirshëm.



Përkruaj rezultat e eksperimentit.

- Sara më tha se trupat kur fërkohen, elektrizohen.
- Po ty, Sara, çfarë të tha Andi?
- Andi tha përgjigjen e njëjtë, veçse shtoi se trupat në qetësi nuk kanë elektricitet.

**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:****Përpunimi i përmbajtjes***Punë praktike*

Nxënësit ndahen në grupe pune. Hapin fletoret e punës, faqe 32. Eksperimenti nga libri i jepet dy grupeve. Ndërsa grupit të tretë dhe grupit të katërt u jepet detyrë të elektrizojnë balonat dhe të tërheqin me ta copëza letre, flokë apo diçka tjetër. Nxënësit vëzhgohen vazhdimisht dhe asistohen në rast nevojë.

Kur eksperimentet përfundohen, njëri grup nga dy të parat e demonstroi edhe një herë para të gjithëve. E njëjta bëhet edhe me eksperimentin tjetër. Pastaj plotësohet faqja në fletore pune, ku shpjegohet rezultati i eksperimentit.

**Përforcimi:****Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit***Dy gënjeshtër, një e vërtetë*

Shkruhen tri fjali, dy prej tyre të pasakta e një e saktë. Nxënësit do të gjejnë cilat janë të sakta e cilat të pasakta.

Detyrë: Shkruaj me G për fjalitë që nuk janë të vërteta dhe V për të vërtetën.

	Trupat në qetësi kanë numër më të madh të protoneve sesa të elektroneve.
	Trupat në qetësi kanë numër të barabartë të ngarkesës pozitive dhe negative.
	Trupat në qetësi kanë më shumë elektrone sesa protone.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e përgjigjeve, mënyrën e demonstrimit dhe shpjegimit të eksperimentit, si dhe për saktësinë në gjetjen e fjalive të pasakta dhe të sakta.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Fërkimi dhe shtypja

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon me shembuj shtypjen që bën trupi në sipërfaqe dhe varësinë e saj nga rëndimi i trupit dhe sipërfaqja e tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.4; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Shtypja e trupit mbi sipërfaqe

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon se çfarë nënkupton me shtypje të trupave;
- Demonstron shembuj të shtypjes së trupave me forcë dhe sipërfaqe të ndryshme;
- Dallon me anë të eksperimentit peshën e trupit si faktor të rëndësishëm të shtypjes së trupave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Miell, gota me madhësi të ndryshme, enë, ujë, fletë pune.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë:

Zbulo titullin

Shkruhen disa fjali pyetëse në tabelë, ose fjali me hapësira të zbrazëta. Përgjigjet e tyre theksohet që të jenë të shkurtra. Shpjegohet se bashkimi i shkronjave të para të secilës përgjigje e jep titullin e njësisë mësimore.

Shembull:

- Vendi ku ne shkruajmë në tabelë quhet _____ e tabelës.
- Vizatimi i sipërfaqes së Tokës në letër paraqitet përmes _____.
- Ne jetojmë në planetin _____.
- Trupat ndriçues pesëkëndorë në hapësirë quhen _____.

FËRKIMI DHE SHTYPJA

3-5. SHTYPJA E TRUPIT MBI SIPËRFAQE

Fjalët kyçe
shtypja, sipërfaqe, forca.

Forca me të cilën vepron një trup mbi sipërfaqe quhet shtypje. Për shembull, nëse shtyni bankën, atëherë ushtroni shtypje mbi të. Po ashtu, edhe nëse fryni një balonë apo shtrydhni një frutë, ushtroni shtypje. Sa më e madhe të jetë forca dhe sa më vogël sipërfaqja, shtypja është më e madhe dhe anasjelltas. Për shembull: merrni një enë dhe mbusheni 3-4 centimetra me miell. Në miell vendosni dy gota me pesha të njëjta, por njëra të jetë e gjerë (sipërfaqe më të madhe) dhe tjetra e ngushtë (sipërfaqe më të vogël). Pasi t'i largoni gotat nga mielli, do të shihni se gota më e ngushtë ka bërë një vrimë më të thellë krahasuar me gotën e gjerë, sepse gota e ngushtë ka ushtruar më shumë shtypje. Po ashtu, shtypja varet edhe nga pesha e trupit. Për ta vërtetuar këtë, mund ta bëni një ushtrim të ngjashëm me të parin. Merrni një enë me miell, por tani vendosni dy gota me gjerësi të njëjtë, njëra të jetë e thatë, ndërsa tjetra të mbushet me ujë. Pasi t'i largoni gotat, do të shihni se gota e mbushur me ujë ka bërë një vrimë më të thellë, sepse ka pasur peshë më të madhe dhe ka ushtruar shtypje më të madhe në të njëjtën sipërfaqe.

Detyrë: Ndahuni në grupe dhe bëjeni këtë eksperiment së bashku me mësuesin/in. Provojeni me trupa të madhësive të ndryshme dhe në fund prezantoni rezultatet.

Të mbajmë mend

- Forca me të cilën vepron një trup mbi sipërfaqe quhet shtypje.
- Sa më e madhe të jetë forca dhe sa më vogël sipërfaqja, shtypja është më e madhe dhe anasjelltas.
- Shtypja e trupit mbi sipërfaqe varet edhe nga pesha e tij.

Shtypja e trupave

Pyetje

1. Çfarë quajmë shtypje të trupit?
2. Shpjego ndikimin e gjerësisë, përkatësisht sipërfaqes së trupit në shtypje.
3. A ndikon forca e shtypjes nga pesha e trupit?

PROCESET FIZIKE

54

3-5. SHTYPJA E TRUPIT MBI SIPËRFAQE

Fjalët kyçe
shtypja, sipërfaqe, forca.

Forca me të cilën vepron një trup mbi sipërfaqe quhet shtypje. Për shembull, nëse shtyni bankën, atëherë ushtroni shtypje mbi të. Po ashtu, edhe nëse fryni një balonë apo shtrydhni një frutë, ushtroni shtypje. Sa më e madhe të jetë forca dhe sa më vogël sipërfaqja, shtypja është më e madhe dhe anasjelltas. Për shembull: merrni një enë dhe mbusheni 3-4

centimetra me miell. Në miell vendosni dy gota me pesha të njëjta, por njëra të jetë e gjerë (sipërfaqe më të madhe) dhe tjetra e ngushtë (sipërfaqe më të vogël). Pasi t'i largoni gotat nga mielli, do të shihni se gota më e ngushtë ka bërë një vrimë më të thellë krahasuar me gotën e gjerë, sepse gota e ngushtë ka ushtruar më shumë shtypje.

Po ashtu, shtypja varet edhe nga pesha e trupit. Për ta vërtetuar këtë, mund ta bëni një ushtrim të ngjashëm me të parin. Merrni një enë me miell, por tani vendosni dy gota me gjerësi të njëjtë, njëra të jetë e thatë, ndërsa tjetra të mbushet me ujë. Pasi t'i largoni gotat, do të shihni se gota e mbushur me ujë ka bërë një vrimë më të thellë, sepse ka pasur peshë më të madhe dhe ka ushtruar shtypje më të madhe në të njëjtën sipërfaqe.

Detyrë: Ndahuni në grupe dhe bëjeni këtë eksperiment së bashku me mësuesin/in. Provojeni me trupa të madhësive të ndryshme dhe në fund prezantoni rezultatet.



Shtypja e trupave

Të mbajmë mend

- Forca me të cilën vepron një trup mbi sipërfaqe quhet shtypje.
- Sa më e madhe të jetë forca dhe sa më vogël sipërfaqja, shtypja është më e madhe dhe anasjelltas.
- Shtypja e trupit mbi sipërfaqe varet edhe nga pesha e tij.

Pyetje

1. Cfarë quajmë shtypje të trupit?
2. Shpjego ndikimin e gjerësisë, përkatësisht sipërfaqes së trupit në shtypje.
3. A ndikon forca e shtypjes nga pesha e trupit?

PROCESET FIZIKE

54

- Kur dy lëndë përzihen bashkë, themi se krijohet _____.
 - Ajo që dëgjohe kur zëri përplasat në një mur dhe kthehet mrapa është _____.
 - Një lloj metali me të cilin bëhen stolitë e çmueshme quhet _____.
- (Përgjigjet: sipërfaqe, hartë, tokë, yje, përzierje, jehonë, ari)

SHTYPJA

Pyeten se çfarë kuptojnë me këtë fjalë e më pas shpjegohet se shtypja është forca me të cilën një trup vepron mbi sipërfaqe.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Punë praktike

Hapen librat në faqen 54. Lexohet mësimi. Pjesa *Të mbajmë mend* theksohet dhe analizohet. Zgjedhen 4 nxënës në tabelë për të kryer eksperimentin. Vëzhgimet e bëra shënohen në fletën e punës. Më pas, zgjedhen edhe 4 nxënës të tjerë për të bërë eksperimentin e dytë; përsëri shënohet rezultati i vëzhguar.

Eksperimentet mund të përsëriten edhe një herë nga të tjerë nxënës.

Shembull i fletës së punës:

Eksperimenti 1:	Eksperimenti 2:
Mjetet e nevojshme:	Mjetet e nevojshme:
Rezultati:	Rezultati:



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët

Copëza të përziera

Jepen përkufizimet kryesore në formën e përzier. Nxënësit i renditin saktë, diskutojnë dhe lexojnë. Secili grup ka përkufizim të ndryshëm nga tjetri.

Shembull:

mbi sipërfaqe

varet edhe nga

Shtypja e trupit

pesha e tij.

Fjalja duhet të renditet kështu: Shtypja e trupit mbi sipërfaqe varet edhe nga pesha e tij. Në këtë mënyrë bëhen edhe përkufizimet e tjera.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për shpjegimin e saktë të shtypjes së trupave, demonstrimin e eksperimenteve dhe gjetjen e rezultateve nga zhvillimi i tyre.

Detyrë:

Të plotësohet në fletore pune, faqe 33.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Bashkëveprimi mes trupave

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Demonstron bashkëveprimin e ngarkesave elektrike dhe poleve magnetike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.8; III.3; III.4; III.7; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Elektriciteti, magneti dhe magnetizmi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon elektricitetin, magnetizmin dhe magnetët;
- Identifikon magnetët, poet, format dhe përdorimin e tyre;
- Klasifikon objektet me veti magnetike nga ato jomagnetike.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletushka, magnetë, fletë pune, objekte të ndryshme magnetike dhe jomagnetike.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë amtare, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Shkrim i lirë

Udhëzohen nxënësit të shkruajnë se çfarë kanë mbajtur mend nga mësimi i elektrizimit me fërkim për 2-3 minuta. Theksohet të shpjegohet elektriciteti, ngarkesa elektrike e trupit. Shkrimi bëhet në fletushka, të cilat vendosen në tabelë dhe lexohen disa prej tyre.


Nxënësi 1

Nxënësi 2

Nxënësi 3



BASHKËVEPRIMI I TRUPAVE



Format e magnetëve

Magnetët kanë forma të ndryshme, p.sh., në formë të shufrës, në formë të shkronjës U, në formë rrethore etj. Magnetët janë të rëndësishëm dhe përdoren për ndërtimin e pajisjeve të ndryshme, p.sh., televizorit, radios, telefonit, për ndarjen e metaleve nga jometalet, për ndërrimin e busullave që na shërbejnë për orientim etj.

Disa metale, me ndihmën e rrymës elektrike, mund të elektrizohen përkohësisht. Këto lloje të magnetëve quhen elektromagnetë dhe përdoren nga makina të ndryshme për të ngritur metalet, si hekuri ose çeliku.



Elektromagneti

Detyrë:

Se bashku me shokët dhe shoqet e klasës dhe mësuesin/in, testoni se cilat objekte janë magnetike dhe cilat jomagnetike, duke u bazuar sikurse në figurë.



Tërheqja e materialeve me magnet

Shëno mië poshtë, cilat mjete që i mbani në çantë dhe ato që i keni në klasë janë magnetike e cilat jomagnetike.

Të mbajmë mend

- Trupat e ngarkuar me ngarkesa të ndryshme elektrike tërhiqen mes vete, ndërsa ata me ngarkesa të njëjta refuzohen (largohen) me njëri-tjetrin.
- Disa metale, me ndihmën e rrymës elektrike, mund të elektrizohen përkohësisht. Këto lloje të magnetëve quhen elektromagnetë.

Pyetje


1. Cilët trupa tërhiqen mes vete e cilët refuzohen nga njëri-tjetri?
2. Çfarë është magnetizmi?
3. Identifiko format e magnetëve. Trego për përdorimin e tyre.

PROCESI FIZIKE



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Harta e konceptit**

Lexohet mësimi në faqet 55-56. Diskutohen bashkë me nxënësit çështjet kryesore të mësimin, me anë të pyetjeve që nxisin mendimin kritik. Pas punës me tekstin, ndahen nxënësit nga dy dhe orientohen ta plotësojnë hartën e konceptit.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Punë praktike**

Ndahen nxënësit në grupe. I shpërndahet secilit grup një kuti me magnetë me forma të ndryshme. Nxënësit testojnë objektet e klasës, duke i ndarë në objekte magnetike dhe jomagnetike.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për shpjegimin e qartë të koncepteve kryesore, për identifikim të saktë të magnetëve, poleve, formave dhe përdorimit të tyre, si dhe për klasifikim të objekteve me veti magnetike nga ato jomagnetike.

Detyrë:

Të shkruhen tri objekte magnetike që i ke në shtëpi dhe tri jomagnetike.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

Për mësuesin/en

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Bashkëveprimi mes trupave

Rezultatet e të nxënit të temës:

Demonstron bashkëveprimin e ngarkesave elektrike dhe poleve magnetike.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.4; III.7; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Elektriciteti, magneti dhe magnetizmi - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon rastet e tërheqjes dhe shtyrjes së magnetëve;
- Dallon polet magnetike dhe format e magnetëve.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë pune, hamer, magnetë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Rrjeti i diskutimit

Nxënësit u përgjigjen diskutimit të dhënë: ata pohojnë ose mohojnë dhe përgjigja shoqërohet me argument.

Magnetët tërhiqen me pole të njëjta	
PO	JO



3.6. ELEKTRICITETI, MAGNETI DHE MAGNETIZMI

1. Si quhen poet magnetike? Trego cilat janë shenjat e tyre.

a) _____

b) _____

2. Trego për format e magnetit. Vendosi fjalët e duhura në vendet boshe nën figura.



3. Edhe ti mund ta realizosh eksperimentin me magnet.

Testoje se cilat pjesë të monedhës metalike një dhe dyeuroshe janë magnetike. Për këtë eksperiment të nevojiten: një monedhë 1-euroshe, një monedhë 2-euroshe dhe një magnet.



Shëno rezultatet e fituara.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Të nxënësit me këmbime


Ndahet klasa në grupe, varësisht prej numrit të çështjeve që do të diskutohen. Secili grup ka nga 4 nxënës.

Nxënësi 1 – format e magnetëve.

Nxënësi 2 – tërheqja apo refuzimi magnetik.

Nxënësi 3 – materialet magnetike dhe jomagnetike.

Nxënësi 4 – gjen fjalët e fshehura në bashkësinë e shkronjave.



M	A	G	N	E	T	I	Z	M	I	U
M	A	G	N	E	T	S	D	F	G	H
D	F	H	J	K	L	M	N	B	V	N
P	O	L	I	J	U	G	O	R	B	M
M	A	G	N	E	T	I	K	E	U	M
P	O	L	I	I	V	E	R	I	U	T
A	N	T	Ë	R	H	I	Q	E	N	M

Krijohet grupi A, grupi B e me radhë; krijohen si grupe eksperte për çështjet e paracaktuara. Mësuesi/ja kujdeset që t'i pajisë me materialet e nevojshme grupet. Pas disa minutash diskutim, kthehen nxënësit në grupin fillestar, ku secili shpjegon për punën e bërë në grupin ekspert. Katër fletat e punës vendosen nga nxënësit e grupit fillestar në një hamer.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Punë e pavarur

Plotësohen në fletore pune, faqe 34, detyra 1 dhe 2.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë në përcaktim të rasteve kur tërhiqen e kur shtyhen magnetët, dallimin mes poleve dhe formave magnetike.

Detyrë:

Të bëhet eksperimenti në fletore pune dhe të shënohen rezultatet e tij në libër.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Bashkëveprimi mes trupave

Rezultatet e të nxënit të temës:

Konstaton me shembuj se i njëjti trup mund të jetë në të njëjtën kohë edhe në lëvizje, edhe në qetësi, varësisht se ndaj kujt vlerësohet.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; III.4; III.7; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Bashkëveprimi i trupave në lëvizje dhe në qetësi

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Shpjegon lëvizjen dhe qetësinë e trupave;
- Identifikon shembuj të trupave në lëvizje, trupave në qetësi dhe trupave në qetësi dhe lëvizje njëkohësisht;
- Përcakton llojin e lëvizjes së trupit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë pune, projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Gjuhë amtare, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Shiko, mendo dhe përgjigju

Jepet një fletë pune, në të cilën ka figura dhe veprime. Figurat lidhen me shigjetë me veprimin përkatës. Pas lidhjes me shigjetë, kuptohet që të gjitha veprimet janë mënyra të lëvizjes dhe vijohet me pyetjen:
- Nëse këta trupa nuk i bëjnë këto lëvizje, atëherë këta trupa themi se janë në: _____.

Nga ky ushtrim kuptohet që trupat mund të lëvizin dhe të jenë në qetësi.



3.7. BASHKËVEPRIMI I TRUPAVE NË LËVIZJE DHE NË QETËSI

Trupat në natyrë mund të jenë në gjendje qetësie ose në lëvizje. Kur trupi i caktuar qëndron në një pozitë dhe nuk ndërron vend, themi se ai është në gjendje qetësie. Nëse në të njëjtin trup ushtrohim forcë, ai e ndryshon pozitën dhe themi që lëviz. Ndryshimi i pozitës së një trupi në krahasim me një trup tjetër (që nuk lëviz) quhet lëvizje. P.sh., kur një person është ulur në një ulëse (pushimore), ai është në qetësi (nuk është në lëvizje), ndërsa kur ai fillon të ecë, atëherë gjendja e tij ndryshon dhe themi se është në lëvizje. Objekti që nuk lëviz quhet pikë treguese - referente, sepse me të e krahasojmë lëvizjen e trupit që lëviz. Në natyrë kemi shembuj të ndryshëm të lëvizjes, p.sh., kur shikoni lart në qiell, e vëreni se si retë lëvizin, edhe pikat e shiut lëvizin kur ato bien nga retë në tokë. Edhe ajri që na rrethon lëviz. Kur ngrohet në mënyrë jo të barabartë, ai nga zona më e ftohtë, shkon në drejtim të zonave të ngrohta dhe në këtë rast krijohet era, që në e ndiejmë si lëvizje të ajrit.

Fjalët kyçe
lëvizja, qetësi, udhëtimi.



Lëvizja e reve



Udhëtimi me tren


Në disa raste, një trup mund të jetë njëkohësisht edhe në lëvizje, edhe në qetësi. P.sh.: nëse udhëtoni me tren, anije ose automobil etj., ju jeni në qetësi (brenda mjetit), por mjeti me të cilin ju udhëtoni lëviz në krahasim me trupat e tjerë, si p.sh., drurit, ndërtesat etj., të cilat gjenden rreth rrugës dhe nuk lëvizin.

Pyetje

- Shpjego kur një trup është në gjendje qetësie e kur në lëvizje.
- Sqaro me një shembull rastin kur një trup njëkohësisht mund të jetë edhe në lëvizje, edhe në qetësi.

Të mbajmë mend

- Ndryshimi i pozitës së një trupi në krahasim me një trup tjetër (që nuk lëviz) quhet lëvizje.
- Kur trupi i caktuar qëndron në një pozitë dhe nuk ndërron vend, themi se ai është në gjendje qetësie. Nëse në të njëjtin trup ushtrohim forcë, ai e ndryshon pozitën dhe themi që lëviz.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes
Mbajtja e strukturuar shënimeve

Hapen librat, faqe 57. Lexohet mësimi në mënyrë individuale. Më pas, shikohet një video. Videoja gjendet në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=elAzkXyRQFU>.

Derisa videoja shikohet, nga mësuesja krijohet një strukturë për shënime në tabelë. Plotësohet si shembulli i dhënë.

LËVIZJE	QETËSI	LËVIZJE DHE QETËSI
Ndryshimi i pozitës së një trupi në krahasim me një trup që nuk lëviz quhet lëvizje		
SHKRUAJ SHEMBUJ	SHKRUAJ SHEMBUJ	SHKRUAJ SHEMBUJ
1. Ecja e njeriut pasi ngrihet nga karrigia		
2. Ajri rreth nesh		



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët
Çfarë fshihet në kavanoz

Një kavanoz mbushet me disa etiketa që përmbajnë figura, të cilat tregojnë lloje lëvizjesh. Nxënësit e përzjedhin një dhe tregojnë për cilin lloj bëhet fjalë. Llojet e lëvizjeve shkruhen në fletore.



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për shpjegimin e qartë dhe të saktë të lëvizjes dhe qetësisë së trupave, si dhe për identifikim të shembujve të ndryshëm kur trupat janë në lëvizje, qetësi apo edhe të dyja bashkë, si dhe për përcaktimin e llojit të këvizjes.

Detyrë:

Të plotësohet në fletore pune, faqe 35.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Bashkëveprimi mes trupave

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon zgjerimin dhe tkurrjen e trupave me temperaturë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.4; II.8; III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Bymimi dhe tkurrja

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon rolin e temperaturës në bymim dhe tkurrjen e trupave;
- Shpjegon raste të ndryshme të bymimit dhe të tkurrjes së trupave të ndryshëm.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Balonë, fotografi, fletë pune, enë qelqi, kapëse druri, shkrepës, ujë.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Përvijim i të menduarit

Vendoset një fotografi në tabelë, në formë skeme, ku tregohet uji në tri gjendjet agregate të tij. Emërtohen gjendjet e ujit. Bëhen pyetje:

- Që uji nga gjendja e lëngët të kalojë në gjendje të ngurtë, çfarë duhet të bëhet?
- Kush e shndërron gjendjen e lëngët të ujit në gjendje të gaztë?

Si përgjigje të mundshme pritjet të jenë: ngrirja, të ftohtët, ngrohja, nxehtësia.

Shpjegohet se për të ndodhur këto shndërrime, duhet që në to të ndikojë temperatura e lartë apo e ulët.

BASHKËVEPRIMI I TRUPAVE

3.8. BYMIMI DHE TKURRJA

Fjalët kyçe
bymimi, tkurrja.

Trupat, zakonisht, kur nxehen, bymehen (ritin vëllimin), ndërsa, kur ftohen, ata tkurren (zvogëlojnë vëllimin). Pra, i njëjti trup ndryshon vëllimin varësisht nga ndryshimi i temperaturës. Trupat e ngurtë, lëngjet dhe gazet bymehen. Për shembull, kur bie temperatura, shinat e trenit (të ngurta) shkurtohen dhe mes tyre krijohet zbrazëti. Shumica e termometrave punojnë në bazë të aftësisë së tkurrjes dhe bymimit të lëngjeve (p.sh., alkooli, mercuri etj.). Kur temperatura rritet, lëngu brenda termometrit bymehet (rit vëllimin) dhe termometri tregon temperaturë më të lartë, ndërsa, kur temperatura bie, lëngu tkurret (zvogëlon vëllimin) dhe termometri tregon temperaturë më të ulët.

Bymimi i lëngut në termometër

Bymimi i ajrit në shishe

Gazet, po ashtu, bymehen. Nëse merrni një shishe të qelqit, në grykën e së cilës është vendosur një balonë paraprakisht, dhe pastaj e nxehni shishen, do të vëreni se balona do të fryhet. Fryrja e balonës ndodh për shkak të rritjes së vëllimit të gazit.

Detyrë: Provo të konstatosh tkurrjen dhe bymimin e balonës në klasë dhe shëno për dallimet që i vëren.

Të mbajmë mend

- Trupat, zakonisht, kur nxehen, bymehen (ritin vëllimin), ndërsa, kur ftohen, ata tkurren (zvogëlojnë vëllimin).
- Bymimi ndodh te trupat e ngurtë, të lëngët dhe të gaztë.

Pyetje


1. Sqaro në cilat raste trupat bymehen e në cilat tkurren.
2. Shëno trupat në të cilët ndodh bymimi.
3. Shpjeg bymimin e gazeve përmes shembullit të shishe së qelqit dhe balonës, të përshkruar më lart.

PROCESET FIZIKE


58

3.8. BYMIMI DHE TKURRJA

Fjalët kyçe
bymimi, tkurrja.



Bymimi i lëngut në termometër



Bymimi i ajrit në shishe

Trupat, zakonisht, kur nxehen, bymehen (rritin vëllimin), ndërsa, kur ftohen, ata tkurren (zvogëlojnë vëllimin). Pra, i njëjti trup ndryshon vëllimin varësisht nga ndryshimi i temperaturës. Trupat e ngurtë, lëngjet dhe gazet bymehen. Për shembull, kur bie temperatura, shinat e trenit (të ngurta) shkurtohen dhe mes tyre krijohet zbrazëtitë. Shumica e termometrave punojnë në bazë të aftësisë së tkurrjes dhe bymimit të lëngjeve (p.sh., alkooli, mercuri etj.). Kur temperatura rritet, lëngu brenda termometrit bymehet (rrit vëllimin) dhe termometri tregon temperaturë më të lartë, ndërsa, kur temperatura bie, lëngu tkurret (zvogëlon vëllimin) dhe termometri tregon temperaturë më të ulët.

Gazet, po ashtu, bymehen. Nëse merrni një shishe të qelqit, në grykën e së cilës është vendosur një balonë paraprakisht, dhe pastaj e nxehni shishen, do të vëreni se balona do të fryhet. Fryrja e balonës ndodh për shkak të rritjes së vëllimit të gazit.

Detyrë: Provo të konstatosh tkurrjen dhe bymimin e balonës në klasë dhe shëno për dallimet që i vëren.

Të mbajmë mend

- Trupat, zakonisht, kur nxehen, bymehen (rritin vëllimin), ndërsa, kur ftohen, ata tkurren (zvogëlojnë vëllimin).
- Bymimi ndodh te trupat e ngurtë, të lëngjet dhe të gaztë.


Pyetje

1. Sqaro në cilat raste trupat bymehen e në cilat tkurren.
2. Shëno trupat në të cilët ndodh bymimi.
3. Shpjego bymimin e gazeve përmes shembullit të shishes së qelqit dhe balonës, të përshkruar më lart.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Diagrami i Venit

Hapen librat në faqen 58. Mësimi punohet në tandem me shokun a shoqen e bankës.



Derisa nxënësit punojnë, paraqitet nga mësuesi në tabelë një diagram i tillë, i cili plotësohet me mendimet e nxënësve nga diskutimi i përbashkët në fund të aktivitetit.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët Punë praktike

Zhvillohet eksperimenti i dhënë në libër, ku ndodh bymimi i ajrit. Eksperimenti shoqërohet edhe me

shpjegim të procesit dhe rezultatit të arritur.

Tregohet një kuriozitet që zakonisht të gjithë trupat bymehen me rritjen e temperaturës, ndërsa uji bymehet nën ndikim të temperaturës së ulët, sepse kur uji bëhet akull, ai bymehet.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për shpjegimin e qartë dhe të saktë të lëvizjes dhe qetësisë së trupave, si dhe për identifikim të shembujve të ndryshëm kur trupat janë në lëvizje, qetësi apo edhe të dyja bashkë, si dhe për përcaktimin e llojit të lëvizjes.

Detyrë:

Të shkruhen një rast i bymimit dhe një i tkurrjes së ndonjë trupi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Bashkëveprimi mes trupave

Rezultatet e të nxënit të temës:

Shpjegon zgjerimin dhe tkurrjen e trupave me temperaturë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.4; II.8; III.1.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Bymimi dhe tkurrja - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon kur trupat bymehen dhe kur tkurren;
- Shpjegon rezultatet e arritura nga eksperimenti.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Enë, shishe, balonë, ujë të ngrohtë, puzzle, fletushka.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathësi për jetë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS





Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Kompleto puzzle-in

Nxënësve u shpërndahen disa puzzle. Secili prej tyre ka diçka të shkruar rreth njësisë. Copëzat që ata kanë janë pjesë e një përkufizimi që pritet të krijohet. Lëvizet nëpër klasë, diskutohet, bashkohen nxënësit me përkufizim të duhur, mblidhet grupi dhe në fund prezantohet puna.



BASHKËVEPRIMI I TRUPAVE


3.8. BYMIMI DHE TKURRJA

1. Kur mund të vërehen zgjerimi dhe tkurrja?

a) Tkurrrja ndodh kur trupat _____.

b) Bymimi apo zgjerimi ndodh kur trupat _____.

2. Vendosni fjalët e duhura në figurën më poshtë.




Balona normale

Balona e tkurrur

Balona e zgjeruar

3. Eksperiment:
Duke u bazuar në figurë, merrni ujin e vluar dhe vendosni në enë. Balonën vendosni në shishe lart, në vend të kapakut. Tregoni më poshtë për rezultatit e arritur.
Kujdes! Ky eksperiment duhet të mbikëqyret nga mësuesi/ja ose prindi.



Mjetet e nevojshme: ena, shishja, balona.

36


3.8. BYMIMI DHE TKURRJA

1. Kur mund të vërehen zgjerimi dhe tkurrja?

a) Tkurrrja ndodh kur trupat _____.

b) Bymimi apo zgjerimi ndodh kur trupat _____.

2. Vendosni fjalët e duhura në figurën më poshtë.



Balona normale

Balona e tkurrur

Balona e zjeruar

3. Eksperiment:

Duke u bazuar në figurë, merreni ujin e vluar dhe vendosni në enë. Balonën vendosni në shishe lart, në vend të kapakut. Tregoni më poshtë për rezultatin e arritur.
Kujdes! Ky eksperiment duhet të mbikëqyret nga mësuesi/ja ose prindi.



Mjetet e nevojshme: ena, shishja, balona.

**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:****Përpunimi i përmbajtjes***Shkëmbe një problem*

Aktiviteti realizohet në tandem. Çdo tandem pajiset me një fletushkë të bardhë. Krijohet një pyetje, e cila do të plotësohet nga tandemi tjetër pranë tyre. Nxiten nxënësit që pyetjet të jenë nga më të ndryshmet.

Shkëmbehen fletushkat, shkruhen përgjigjet e pyetjeve dhe në fund lexohen dhe diskutohen bashkërisht.

**Përforcimi:****Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve***Punë praktike*

Hapen fletoret e punës, faqe 36. Përzgjidhen disa nxënës që do ta realizojnë eksperimentin. Në tabelë shkruhet titulli i eksperimentit, mjetet e nevojshme dhe, në fund, rezultatet e fituara. Pas përfundimit të eksperimentit, nxirren bashkërisht rezultatet e eksperimentit, të cilat shkruhen nga nxënësit në hapësirën e dhënë në libër.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për saktësinë e identifikimit të bymimit dhe të tkurrjes së trupave, si dhe për shpjegimin e rezultateve të arritura nga eksperimenti.

Detyrë:

Të plotësohen detyra 1 dhe 2 në fletore pune, faqe 36.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Bashkëveprimi mes trupave

Rezultatet e të nxënit të temës:

Trajton përhapjen e zërit në ajër, ujë dhe në trupa të ngurtë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.1; III.1; III.5; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përhapja e zërit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon burime të ndryshme të zërit;
- Bën dallimin mes zërit, zhurmës dhe jehonës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Altoparlantë, laptop, fletushka me pyetje.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Përvijim i të menduarit

Vendoset një fotografi e syrit, veshit dhe gojës.

Pyeten nxënësit:

- Çfarë shikoni në fotografi? (Sy, vesh, gojë.)
- Cili është roli i secilës prej tyre? (Shikimi, dëgjimi, të folurit.)
- Si quhen ndryshe? (Shqisa.)

Pastaj dëgjohe një video. Pamja e videos nuk vendoset, vetëm zëri dëgjohe. Nxënësit do të identifikojnë burimin e zërit, pa e shikuar pamjen.

Videoja gjendet te vegëza: https://www.youtube.com/watch?v=pzw2_PAWjUw.

Bëhet e ditur se do të mësohet për burimet e zërit.



3.9. PËRHAPJA E ZËRIT

Valët e zërit dhe përhapja e tyre

Kur trupat dridhen, krijohet tingulli (zëri). Dridhjet, që krijohen nga objekti, në formë të valëve barten deri te veshi ynë dhe ne i dëgjojmë ato si zë. Sa më të forta të jenë dridhjet, aq më i fortë është zëri dhe anasjellas. Duke u larguar nga burimi, valët e zërit e humbin energjinë dhe ndihen gjithnjë e më pak.

Valët e zërit udhëtojnë nëpër materiale të ndryshme (ajër, lëngje dhe trupa të ngurtë). Ato përhapen më shpejt në trupa të ngurtë, më ngadalë në mjedis të lëngshme (ujë), edhe më ngadalë në ajër. Zë krijohet objekte të ndryshme, p.sh., instrumentet e ndryshme muzikore, kafshët e ndryshme, buria e makinave, kur ju flisni ose këndonni etj.

Fjalët kyçe

zëri, përhapja, valët, zhurma, jehona.



Përhapja e zërit përmes ajrit

Përhapja e zërit përmes ujit

Përhapja e zërit përmes trupave të ngurtë

Valët e zërit

Zëri i lartë, i çregullt dhe i përzier quhet zhurmë. Zhurma është e dëmshme për shëndetin. Nëse zëri godet ndonjë objekt të fortë (p.sh., ndonjë shpat të malit), kthehet mbrapsht dhe pas pak ju e dëgjoni përsëri këtë zë. Kjo dukuri quhet jehonë.



Zhurma



Jehona

Pyetjet

1. Përshkruaj krijimin dhe përhapjen e zërit.
2. Në cilat materiale zëri përhapet më shpejt?
3. Çfarë quajmë zhurmë?

Të mbajmë mend

- Zë krijohet objekte të ndryshme. Zëri krijohet kur trupat (objektet) dridhen.
- Sa më të forta të jenë dridhjet, aq më i fortë është zëri dhe anasjellas.
- Valët e zërit udhëtojnë nëpër materiale të ndryshme (ajër, lëngje dhe trupa të ngurtë).

PROCESI FIZIKË



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Diagrama piramidale

Lexohet mësimi në faqen 59. Shpërndahen pyetjet për secilin nxënës. Pyetjet ndodhen në një fletushkë, e cila ngjitet në fletore, dhe më pas shkruhen përgjigjet.

- Çfarë është zëri?
- Në cilat mjedise përhapet zëri?
- Kush krijon zë, apo është burim zëri?
- Ku dallon zhurma nga zëri?
- Rendit mjediset nga ajo që përhapet zëri më mirë deri tek ajo ku zëri përhapet më pak.
- Kur është zëri më i fortë?

Përgjigjet kontrollohen nga mësuesja gjatë kohës kur plotësohen ato.

Më pas, vizatohen në tabelë dy drejtkëndësha që përfaqësojnë majën e piramidës. Kërkohet nga nxënësit të përcaktohet një titull i përshtatshëm i piramidës. Më pas, emërtohen kategoritë e tjera dhe vijohet me plotësim.

ZËRI				
Dridhja e trupave krijon disa valë që arrijnë në veshin tonë në formë të zërit				
Burimet e zërit	Mjediset ku përhapet zëri	Jehona	Zhurma	Mjedisi ku përhapen më mirë



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënës Lojë me role

Ndahen grupet. Secili nxënës brenda grupit ka një rol. Nxënësi A prodhon zë me trokitje të këmbëve; nxënësi B prodhon zë duke goditur lehtë bankën me duar, kurse nxënësi C duke duartrokitur. Mësuesi kujdeset që të gjithë brenda grupit ta mbajnë ritmin dhe të jenë të koordinuar.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për identifikim të saktë të burimeve të zërit, si dhe dallimin e saktë të zërit, jehonës dhe zhurmës.

Detyrë:

Të tregohet një rast kur ke dëgjuar zhurmë dhe një rast kur ke dëgjuar jehonën e zërit tënd.

Reflektim përvojën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Bashkëveprimi mes trupave

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Paraqet shembuj për vlerësimin e lidhjes së burimeve të dritës me temperaturë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1; II.6; III.3; V.9.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Burimet e dritës

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon Diellin si burim kryesor drite dhe nxehtësie;
- Kategorizon burimet natyrore nga ato artificiale të dritës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Etiketa me fakte rreth diellit, fletë pune me tabelën me kode, gërshtë, ngjitës.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
 Përvijim i të menduarit

Në tabelë, shkruhen disa fakte për Diellin, por nuk përmendet fjala Diell. Fjalitë lexohen të gjitha nga nxënësit me zë të lartë. Kërkohet që të mos jepet përgjigjja, edhe nëse e gjejnë deri kur mësuesja kërkon përgjigje.

Ja disa fakte të mundshme që mund të shkruhen:

E shohim pothuajse çdo ditë.

Rreth 25 % e njerëzve teshtijnë kur e shikojnë.

BASHKËVEPRIMI I TRUPAVE

3.10. BURIMET E DRITËS

Fjalët kyçe
 drita, burimi, dielli, natyror, artificial.

Dhoma me ndriçim dhe e errët

Burimet e ndryshme të dritës

Zjarri si burim i dritës dhe nxehtësisë

Të mbajmë mend

- Rrezet e diellit nuk ndriçojnë gjithkund njësoj, por ato edhe nuk ngrohin gjithkund dhe gjithmonë njëjtë. Kjo varet a është ditë apo natë, nga stina e vitit, ekspozicioni i vendit, lartësia mbidetare, se a qëndron ndonjë trup si pengesë që absorbon atë apo/dhe krijon hije etj.
- Burimet e dritës mund të jenë natyrore dhe artificiale.

PROCESET FIZIKE

60

Drita është një formë e energjisë, burimi kryesor i së cilës është Dielli. Ajo na mundëson që të shohim se pse drita në disa trupa depërton, në disa të tjerë pasqyrohet, ndërsa të tjerët e përthyejnë ose absorbojnë atë. P.sh., ne e shohim Diellin ose ndonjë llambë, sepse liron dritë. Mund të shohim edhe brenda dhomës, sepse drita kalon nëpër xhama të dritareve. Nëse dhoma nuk ka dritare, ne nuk mund të shohim, meqë drita nuk kalon aty, sepse muret e absorbojnë dritën.

Drita është edhe burim i nxehtësisë. Kështu, vendet e ndriçuara janë të ngrohta, ndërsa ato të errëtat janë të freskëta. P.sh., i njëjti vend gjatë ditës është i ngrohtë, sepse ndriçohet nga dielli, ndërsa natën është freskët, sepse nuk ndriçohet.

Drita e Diellit është e rëndësishme për të gjithë organizmat e gjallë. Bimëve dhe kafshëve u ofron ngrohtësinë që u nevojitet, ndërsa bimët e përdorin dritën për të krijuar ushqimin e tyre përmes fotosintezës. Burimet e dritës janë të ndryshme. Ato mund të jenë natyrore, p.sh., drita e Diellit dhe e yjeve të tjera, e vetëtimës, kandilave të detit, xixëllonjave etj. Burimet e dritës mund të jenë edhe artificiale, të krijuara nga njeriu, p.sh., llambat e ndryshme elektrike, qirinjtë, llamba me vajguri, zjarri etj.

Burim artificial i dritës dhe nxehtësisë, i krijuar nga njeriu, është zjarri.

Pyetje

1. Cili është burimi kryesor i dritës?
2. Pse rrezet e diellit nuk ndriçojnë gjithkund njësoj dhe nuk ngrohin gjithkund dhe gjithmonë njëjtë?
3. Identifiko burimet natyrore dhe artificiale të dritës.


3.10. BURIMET E DITËS

Fjalët kyçe

drita, burimi, dielli, natyror, artificial.



Dhoma me ndriçim dhe e errët



Burimet e ndryshme të dritës



Zjarri si burim i dritës dhe nxehtësisë

Të mbajmë mend

- Rrezet e diellit nuk ndriçojnë gjithkund njësoj, por ato edhe nuk ngrohin gjithkund dhe gjithmonë njëjtë. Kjo varet a është ditë apo natë, nga stina e vitit, ekspozicioni i vendit, lartësia mbidetare, se a qëndron ndonjë trup si pengesë që absorbon atë apo/dhe krijon hije etj.
- Burimet e dritës mund të jenë natyrore dhe artificiale.

PROCESET FIZIKE

Go

Drita është një formë e energjisë, burimi kryesor i së cilës është Dielli. Ajo na mundëson që të shohim se pse drita në disa trupa depërton, në disa të tjerë pasqyrohet, ndërsa të tjerët e përthyejnë ose absorbojnë atë. P.sh., ne e shohim Diellin ose ndonjë llambë, sepse liron dritë. Mund të shohim edhe brenda dhomës, sepse drita kalon nëpër xhama të dritareve. Nëse dhoma nuk ka dritare, ne nuk mund të shohim, meqë drita nuk kalon aty, sepse muret e absorbojnë dritën.

Drita është edhe burim i nxehtësisë. Kështu, vendet e ndriçuara janë të ngrohta, ndërsa ato të errëtat janë të freskëta. P.sh., i njëjti vend gjatë ditës është i ngrohtë, sepse ndriçohet nga dielli, ndërsa natën është freskët, sepse nuk ndriçohet.

Drita e Diellit është e rëndësishme për të gjithë organizmat e gjallë. Bimëve dhe kafshëve u ofron ngrohtësinë që u nevojitet, ndërsa bimët e përdorin dritën për të krijuar ushqimin e tyre përmes fotosintezës. Burimet e dritës janë të ndryshme. Ato mund të jenë natyrore, p.sh., drita e Diellit dhe e yjeve të tjera, e vetëtimës, kandilave të detit, xixëllonjave etj. Burimet e dritës mund të jenë edhe artificiale, të krijuara nga njeriu, p.sh., llambat e ndryshme elektrike, qirinjtë, llamba me vajguri, zjarri etj.

Burim artificial i dritës dhe nxehtësisë, i krijuar nga njeriu, është zjarri.

Pyetje

1. Cili është burimi kryesor i dritës?
2. Pse rrezet e diellit nuk ndriçojnë gjithkund njësoj dhe nuk ngrohin gjithkund dhe gjithmonë njëjtë?
3. Identifiko burimet natyrore dhe artificiale të dritës.

Pas këtyre informacioneve të dhëna, pyeten nxënësit se për kë bëhet fjalë. Në rast që nuk gjendet, shtohen informacione.

Kur kuptohet që është Dielli, pyeten se çfarë na jep ai. Si përgjigje e mundshme pritet të jetë: dritë dhe nxehtësi.

Shpjegohet se do të mësohet për burimet e dritës dhe nxehtësisë.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Lexim me kodim

Lexohet mësimi në faqen 60. Paralelisht me leximin, shpërndahet një fletë e punës, në të cilën është e paraqitur një tabelë me kode.

Shembulli i tabelës:

BD = Burim drite; BN = Burim nxehtësie; VN = Vendet e ndriçuara; VE = Vendet e errëta; BA = Burime artificiale; BN = Burime natyrore; NKB = Nevojat e kafshëve dhe bimëve për diell.

Kodet e dhëna shkruhen në libër gjatë leximit, pastaj përshkruhen në tabelë.

	BD	BN	VN	VE	BA	BN	NKB
Burim drite janë: Dielli, yjet, zjarri.		Dielli, zjarri, llamba.	Vendet e ndriçuara janë më të ngrohta.				



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Mendo – puno në grup - diskuto

U shpërndahet një fletë ku janë disa fotografi të ndryshme që paraqesin burime natyrore dhe artificiale. Ato priten dhe vendosen në kornizën e duhur. Puna bëhet në tandem.

Burime natyrore	Burime artificiale



Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për identifikimin e saktë të burimit kryesor të dritës dhe nxehtësisë, si dhe për kategorizim të burimeve në natyrore dhe artificiale.

Detyrë:

Të shpjegohet cilat burime të dritës dhe nxehtësisë shfrytëzohen në shtëpi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Bashkëveprimi mes trupave

Rezultatet e të nxënit të temës:

Trajton përhapjen e zërit në ajër, ujë dhe në trupa të ngurtë;

Paraqet shembuj për vlerësimin e lidhjes së burimeve të dritës me temperaturë.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.6; III.3.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përhapja e zërit - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon burimet e zërit dhe shpejtësinë e përhapjes, në varësi nga mjedisi;
- Përcakton burimet natyrore të dritës nga burimet artificiale;
- Bën dallimin mes koncepteve të sakta dhe atyre të pasakta.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë pune A3, fletushka, ngjyra.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Shoqëria dhe mjedisi, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Në formatin A3, printohen disa fleta, në të cilat vendosen burime të dritës dhe të zërit. Nxënësit punojnë në grupe. Ngjyrosin me të kaltër burimet e zërit dhe me të kuqe burimet e dritës. Vendoset edhe një figurë tjetër që nuk është as burim drite, as zëri dhe ajo udhëzohet të ngjyroset me të gjelbër. Grupi i parë që punon saktë dhe është më i shpejtë, vlerësohet me notë.



3.9. PËRHAPJA E ZËRIT

1. Në cilët trupa përhapet zëri më shpejt dhe në cilët më ngadalë?
Lidheni me vizë përgjigjen e saktë me figurë.



të ngurtë

të lëngët

të gaztë

BURIMET E DRITËS

2. Jepni disa shembuj për burimin e dritës dhe të temperaturës.

Burimi i dritës	natyror	artificial
Dielli	√	

PROCESI FIZIKE

37

Shembull i fletës së punës:



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Punë e pavarur

Hapet fletorja e punës, faqe 37. Plotësohen të dyja ushtrimet në mënyrë individuale. Përgjigjet e bëra vlerësohen me notë.



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Dy gënjeshtër, një e saktë

Vendosen në tabelë disa fletushka që kanë brenda dy gënjeshtër dhe një të pohim të saktë. Përzgjidhen disa nxënës. Lexohen fjalitë dhe jep- en përgjigjet. Përgjigjja e saktë rrethohet me një ngjyrë.

Shembuj të fletushkave:

1. Zëri përhapet më mirë në trupa të ngurtë.
2. Zëri i lartë i rregullt është zhurmë.
3. Zëri arrin më shpejt se drita.

1. Aty ku ka mure kalon drita, sepse muret nuk e absorbojnë dritën.
2. Në Tokë më shpejt arrin drita se zëri.
3. Procesi i fotosintezës nuk e ka të nevojshme dritën e diellit.

Vlerësimi i nxënësve:

Vlerësohen për identifikimin e saktë të burimeve të zërit, shpejtësisë së përhapjes së tij në varësi të mjedisit, për përcaktim të burimeve natyrore - artificiale dhe për dallim të saktë të koncepteve të pasakta nga e sakta.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Bashkëveprimi mes trupave

Rezultatet e të nxënit të temës:

Demonstron ngritjen sa më të lehtë të barrës me lloz, duke zmadhuar krahun e veprimit të forcës F (duart) ndaj krahut të barrës Q nga pika mbështetëse O;

Demonstron baraspeshimin mes dy trupave të vendosur në krahët e kundërt të llozit dykrahësh ndaj pikës mbështetëse të tij.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: II.1; II.4; II.7; III.1; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Llozi dhe përdorimi i tij

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Dallon rëndësinë e llozit në punën e njeriut;
- Përshkruan përdorimin e llozit;
- Demonstron baraspeshën në mes dy trupave.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shkathësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim për njohuritë paraprake

Nxiten nxënësit për pjesëmarrje aktive në diskutim përmes pyetjeve:

- Cila është njësia themelore për matjen e peshës?
- Si mund t'i lëvizim trupat që kanë peshë të madhe?



3.11. LLOZI DHE PËRDORIMI I TIJ

Njeriu, për të lehtësuar punën e vet, vazhdimisht krijon makina të ndryshme. Një nga makinat më të thjeshta që njeriu ka ndërtuar është llozi. Ai përbëhet nga një trup i ngurtë (zakonisht shkop), që mund të rrotullohet rreth një pike të caktuar dhe të palëvizshme.

Fjalët kyçe

llozi, makina, baraspesha, peshorja.



Llozi

Baraspesha mes dy trupave

Një nga makinat e thjeshta që bazohet në parimin e llozit është edhe peshorja me krahe të barabartë. Te kjo peshore, pika mbështetëse e llozit është e vendosur në mes të shufrës. Shërben për matjen e masës së objekteve të ndryshme, duke i krahasuar ato mes vete. Baraspesha mes dy trupave arrihet kur në pjatat e dy kraheve të peshores vendosen trupa me masa të njëjta.



Peshorja me dy krahe

Pyetje

1. Përshkruaj përdorimin e llozit.
2. Si mund të caktohet baraspesha mes dy trupave?

Të mbajmë mend

- Llozi është trup i ngurtë në formë shufre, me anën e të cilit, me forcë më të vogël, fitohet punë më e madhe.
- Baraspesha mes dy trupave arrihet kur në pjatat e peshores me krahe të barabartë, vendosen trupa me masa të njëjta.

PROCESI FIZIKE

61

- A mendoni ju që duhet ndihmë për të zhvendosur një dollap apo një gur me peshë të madhe?
- Pse? Si?

Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes

Pyetja sjell pyetjen

Hapet libri. Lexohet teksti dhe zhvillohet diskutimi me pyetje:

- Çfarë është llozi?
- Pse na duhet ai?
- Si është i ndërtuar?
- Si duhet ta përdorim atë?
- A mendoni që e lehtëson punën e njeriut në jetë?
- Tregoni një rast ku na duhet ndihma e llozit.
- Si mund të caktohet baraspesha në mes dy trupave?

Ja disa përgjigje të mundshme: *Llozi është trup i ngurtë, i cili na duhet për të lëvizur objekte me peshë të madhe; ai vendoset në pikën mbështetëse, më pas tërhiqet nga duart e njeriut; lehtëson punën e zhvendosjes së trupave me peshë; me anë të peshores mund ta caktojmë baraspeshën e dy trupave.*

Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët
Punë praktike

Bashkë me nxënësit praktikohet baraspesha e trupave në peshore (me krahe të barabartë), duke vendosur mbi krahe molla dhe pesha (1 kg dhe 2 kg).

Sqarohet që:



te kjo peshore, pika mbështetëse e llozit është e vendosur në mes të shufrës. Shërben për matjen e masës së objekteve të ndryshme, duke i krahasuar ato mes vete. Baraspesha mes dy trupave arrihet kur në pjatat e dy kraheve të peshores, vendosen trupa me masa të njëjta.

Pas punës praktike, nxënësit mbajnë shënime për ecurinë e punës gjatë vërtimit.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, dallimin e rëndësisë së llozit dhe peshores në punën e njeriut, për demonstrimin e baraspeshës së trupave në peshore.

Detyrë:

Plotësohet në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Bashkëveprimi mes trupave

Rezultatet e të nxënit të temës:

Demonstron punën me gërshërë dhe me darë dhe identifikon në to krahun e barrës, pikën mbështetëse dhe krahun e veprimit të forcës (duarve).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.8; III.2; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përdorimi i makinave të thjeshta

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Liston disa makina të thjeshta;
- Tregon rolin e makinave të thjeshta në jetën e njeriut;
- Shpjegon mënyrën e funksionimit të tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Rikujtim i njohurive paraprake

Nxiten nxënësit të marrin pjesë në diskutim përmes pyetje të shtruar, si:

- Çfarë është llozi?
 - Për çfarë e përdorim atë?
 - Nëse në njërin krahu të peshores vendoset peshë 2 kg, çfarë peshe duhet të vendoset në krahu tjetër që të kemi baraspeshim?
 - Pra, si mund të caktohet baraspesha mes dy trupave?
 - A mendoni që njeriu, për të lehtësuar punën e tij, ka krijuar makina të tjera të thjeshta? Nëse po, cilat janë ato?
- Në fund, theksohet që llozi dhe peshorja janë makina të thjeshta.

BASHKËVEPRIMI I TRUPAVE

3.12. PËRDORIMI I MAKINAVE TË THJESHTA

Njerëzit në përditshmëri përdorin mjete të ndryshme për kryerjen e punëve të caktuara. Shumica e atyre mjeteve kanë ndërtim shumë të thjeshtë, prandaj dhe quhen makina të thjeshta.

Makinat e thjeshta	Përdorimi i tyre
Pyka	Zakonisht përdoret si pajisje prerëse ose çarëse. Një teh sëpate është një shembull i një pyke.
Gërshërët	Janë makina e thjeshtë, të cilat shumëfishojnë forcën në objektin që pritet, duke i bërë ato më të lehta për t'u përdorur dhe më efektive se një thikë.
Vidha	Është një makinë e thjeshtë cilindrike rrethore, me një brinjë spirale të vazhdueshme, që mund të futet në një objekt.
Arrëthyeset	Janë makinë e thjeshtë që ndihmojnë për të thyer një arrë.
Hapësi i shisheve	Është një nga makinat më të thjeshta të shpikura ndonjëherë. Ndihmon në hapjen e kapakëve të shisheve shpejt dhe lehtë.
Dërrasa	Është një makinë e thjeshtë që na mundëson të bartim më lehtë objektet me peshë të rëndë nga një nivel më i ulët në një më të lartë.

Të mbajmë mend

- Njerëzit në përditshmëri, për të kryer punë të caktuara, përdorin mjete të ndryshme që quhen makina të thjeshta.
- Ndër makinat e thjeshta më të përdorura janë: sëpata, gërshërët, vidha, arrëthyeset, hapësi i shisheve, dërrasa etj.

Fjalët kyçe

makina e thjeshta, pyka, gërshërët, vidha, arrëthyesit, hapësi i shisheve, dërrasa.







Pyetje

1. Pse shumë nga mjetet që ne përdorim në përditshmëri quhen makina të thjeshta?
2. Shëno disa nga makinat e thjeshta dhe përshkruaj përdorimin e tyre.

PROCESET FIZIKE

3.12. PËRDORIMI I MAKINAVE TË THJESHTA

Njerëzit në përditshmëri përdorin mjete të ndryshme për kryerjen e punëve të caktuara. Shumica e atyre mjeteve kanë ndërtim shumë të thjeshtë, prandaj dhe quhen makina të thjeshta.

Makina e thjeshta	Përdorimi i tyre
 Pyka	Zakonisht përdoret si pajisje prerëse ose çarëse. Një teh sëpate është një shembull i një pyke.
 Gërshërët	Janë makinë e thjeshtë, të cilat shumëfishojnë forcën në objektin që pritet, duke i bërë ato më të lehta për t'u përdorur dhe më efektive se një thikë.
 Vidha	Është një makinë e thjeshtë cilindrike rrethore, me një brinjë spirale të vazhdueshme, që mund të futet në një objekt.
 Arrëthyeset	Janë makinë e thjeshtë që ndihmojnë për të thyer një arrë.
 Hapësi i shisheve	Është një nga makinat më të thjeshta të shpikura ndonjëherë. Ndihejmon në hapjen e kapakëve të shisheve shpejt dhe lehtë.
 Dërrasa	Është një makinë e thjeshtë që na mundëson të bartim më lehtë objektet me peshë të rëndë nga një nivel më i ulët në një më të lartë.

Të mbajmë mend

- Njerëzit në përditshmëri, për të kryer punë të caktuara, përdorin mjete të ndryshme që quhen makina të thjeshta.
- Ndër makinat e thjeshta më të përdorura janë: sëpata, gërshërët, vidha, arrëthyeset, hapësi i shisheve, dërrasa etj.

PROCESET FIZIKE

Fjalët kyçe

makinat e thjeshta, pyka, gërshërët, vidha, arrëthyesit, hapësi i shisheve, dërrasa.

Pyetje

- Pse shumë nga mjetet që ne përdorim në përditshmëri quhen makina të thjeshta?
- Shëno disa nga makinat e thjeshta dhe përshkruaj përdorimin e tyre.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Harta e konceptit

Njerëzit, në përditshmëri, për të kryer punë të caktuara, përdorin mjete të ndryshme që quhen makina të thjeshta. Makinat e thjeshta më të përdoruar janë: sëpata, vidha, arrëthyesja, pyka, gërshërët, dërrasa, hapësja e shisheve etj.

Hapen librat dhe lexohet teksti në libër. Pas leximit, nxënësit u përgjigjen pyetjeve:

- Pse përdoren makinat e thjeshta?
- Cilat janë ato?
- Për çfarë përdoren pyka, gërshërët, vidha, arrëthyesja etj.

Përgjigjet e nxënësve shënohen në hartën e konceptit në tabelë, kurse ata plotësojnë në fletore.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Pyetje – përgjigje

Udhëzohen nxënësit t'u përgjigjen pyetjeve të shtruara, duke bërë një përmbledhje të funksioneve të makinave të thjeshta. Puna e nxënësve lexohet dhe plotësohet aty ku ka nevojë.

- Pse shumë nga mjetet që përdorim në përditshmëri quhen makina të thjeshta?
- Përshkruaje përdorimin e makinave të thjeshta.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, dallimin dhe listimin e makinave të thjeshta, si dhe për shpjegimin e funksionit të tyre.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Bashkëveprimi mes trupave

Rezultatet e të nxënit të temës:

Demonstron punën me gërshërë dhe me darë dhe identifikon në to krahun e barrës, pikën mbështetëse dhe krahun e veprimit të forcës (duarve);

Demonstron tërheqjen e trupit të lidhur nëpër rrafsh të pjerrët dhe hulumton vartësinë e tërheqjes më të lehtë nga lartësia e tij (dërrasë e vendosur në disa libra, spango, tullë, dinamometër).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3,8; II.8; III.2; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.1; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Përdorimi i makinave të thjeshta - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Emërton makinat e thjeshta;
- Demonstron përdorimin e tyre.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Vidhë, arrëthyese, pykë, gërshërë, letra, arra, dërrasa, shishe, kapak.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Matematikë, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Diskutim me termat paraprakë

Paraqiten para nxënësve makinat e thjeshta, si: pyka, arrëthyesja, gërshërët, dërrasa, llozi, vidha dhe hapësja e shisheve.

Kërkohet nga nxënësit t'i emërtojnë dhe të tregojnë funksionin e tyre, duke rikujtuar mësimin paraprak.

Përkujtim: Makinat e thjeshta janë mjete të krijuara nga njeriu, për kryerjen e një pune të caktuar me lehtësi.

BASHKËVEPRIMI I TRUPAVE

3.10. PËRDORIMI I MAKINAVE TË THJESHTA

1. Prej çfarë materiali përbëhet llozi?

2. Kur arrihet baraspesha mes dy trupave? Shiko figurën dhe trego rezultatit.

Baraspesha e dy trupave

Pika mbështetëse

3. Në figurë janë paraqitur disa makina të thjeshta. Shëno emrat e tyre.

Numri	Makina
1	
2	
3	
4	
5	
6	

38

3.10. PËRDORIMI I MAKINAVE TË THJESHTA

1. Prej çfarë materiali përbëhet llozi?



2. Kur arrihet baraspesha mes dy trupave? Shiko figurën dhe trego rezultatin.


Baraspesha e dy trupave



Pika mbështetëse

3. Në figurë janë paraqitur disa makina të thjeshta. Shëno emrat e tyre.

Numri	Makina
1	
2	
3	
4	
5	
6	



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes

Punë praktike

Nxënësit e ndarë në grupe praktikojnë punën me makina të thjeshta, duke pasur parasysh funksionin që kryejnë ato.

Grupi 1 - Arrëthyesen (thyen arra).

Grupi 2 - Gërsërët (ndajnë letrat në pjesëza).

Grupi 3 - Hapësen e shisheve (hapin kapakët e shisheve).

Grupi 4 - Vidhën (duke ushtruar forcë, fusin vidhën në një copëz të dërrasës).

Gjatë punës, kryesuesi i grupit mban shënime për ecurinë e punës. Secili grup para klasës shpjegon punën e praktikuar.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve

Vlerësim në dyshe

Kërkohet nga nxënësit të plotësohet në fletore pune, faqe 38.

1. Prej çfarë materiali përbëhet llozi?

2. Kur arrihet baraspesha mes dy trupave? Shiko figurën dhe trego rezultatin.

3. Në figurë, janë paraqitur disa makina të thjeshta. Shëno emrat e tyre.

Pas përfundimit të plotësimit, puna kontrollohet dhe vlerësohet nga nxënësi i bankës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, emërtimin e makinave të thjeshta dhe demonstrimin e përdorimit të tyre në jetë.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan Tokën, Diellin, Hënën dhe planetët si trupa të Sistemit Diellor.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: I.3; II.5; III.4; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Planetët në Sistemin Diellor

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon rolin e Diellit në jetën e njeriut;
- Emërton planetët e Sistemit Diellor;
- Përshkruan rëndësinë e Diellit për planetin Tokë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Karrigia e autorit

Në mes të klasës vendoset një karrige, e cila shërben për nxënësin (autor) që shpreh mendimin.

- Si e mendoni jetën pa Diell?

Nxënësit mendohen për disa minuta, më pas disa nga ta ulen në karrigen e autorit me radhë, duke shprehur mendimin e tyre për pyetjen e shtruar. Nxitet diskutim në klasë.

Nga diskutimet, arrihet në përfundim që Dielli luan rol të rëndësishëm në jetën tonë, pasi dritën dhe nxehtësinë e marrim prej tij.

VENDI DHE HAPËSIRA

4.1. PLANETËT NË SISTEMIN DIELLOR

Fjalët kyçe
planetët, Sistemi Diellor, Toka, Dielli.

Sistemi Diellor
Dielli është një yll, sikurse yjet e tjera që i shohim në qiell gjatë natës. Ai gjendet në qendër të Sistemit Diellor dhe rreth tij sillen planetët dhe trupat e tjerë. Ai ngroh planetin tonë dhe u jep gjallesave energji të mjaftueshme për t'u zhvilluar. Pa dritën dhe nxehtësinë e Diellit, nuk do të kishte jetë në Tokë.

Sistemi Diellor ka tetë planetë. Planeti më i afërt me Diellin është Mercuri, pastaj duke u larguar nga ai vijin Venera, Toka, Marsi, Jupiteri, Saturni, Urani dhe Neptuni.

Sistemi Diellor

Planeti më i madh në Sistemin Diellor është Jupiteri, ndërsa planeti më i vogël dhe më i afërt me Diellin është Mercuri. Planeti më i largët me Diellin është Neptuni, siç shihet në figurë. Edhe rreth planetëve sillen trupa të ndryshëm, të cilët quhen satelitë. Satelitët mund të jenë natyrorë, p.sh., Hëna, e cila sillet rreth Tokës, dhe artificiale, të cilët janë objekte të ndryshme të krijuara nga njeriu, për të mbledhur informacione ose për komunikim.

Të mbajmë mend

- Dielli është ylli në qendër të Sistemit Diellor, që prodhon dritë dhe nxehtësi, rreth të cilit në mënyrë eliptike sillen planetët e caktuar.
- Planetët që e përbëjnë Sistemin Diellor janë: Mercuri, Venera, Toka, Marsi, Jupiteri, Saturni, Urani dhe Neptuni.

Hëna **Sateliti artificial**

Pyetje

1. Përshkruaj rëndësinë e Diellit për planetin Tokë.
2. Shëno planetët e Sistemit Diellor.
3. Cilët trupa sillen rreth planetëve?

TOKA, MJEDISI DHE GJITHËSIA

66

4.1. PLANETËT NË SISTEMIN DIELLOR

Fjalët kyçe

planetët, Sistemi Diellor, Toka, Dielli.

Sistemi Diellor

Dielli është një yll, sikurse yjet e tjera që i shohim në qiell gjatë natës. Ai gjendet në qendër të Sistemit Diellor dhe rreth tij sillen planetët dhe trupat e tjerë. Ai ngroh planetin tonë dhe u jep gjallesave energji të mjaftueshme për t'u zhvilluar. Pa dritën dhe nxehtësinë e Diellit, nuk do të kishte jetë në Tokë.

Sistemi Diellor ka tetë planetë. Planeti më i afërt me Diellin është Merkuri, pastaj duke u larguar nga ai vijnë Venera, Toka, Marsi, Jupiteri, Saturni, Urani dhe Neptuni.



Sistemi Diellor

Planeti më i madh në Sistemin Diellor është Jupiteri, ndërsa planeti më i vogël dhe më i afërt me Diellin është Merkuri. Planeti më i largët me Diellin është Neptuni, siç shihet në figurë. Edhe rreth planetëve sillen trupa të ndryshëm, të cilët quhen satelitë. Satelitët mund të jenë natyrorë, p.sh., Hëna, e cila sillet rreth Tokës, dhe artificiale, të cilët janë objekte të krijuara nga njeriu, për të mbledhur informacione ose për komunikim.

Të mbajmë mend

- Dielli është ylli në qendër të Sistemit Diellor, që prodhon dritë dhe nxehtësi, rreth të cilit në mënyrë eliptike sillen planetët e caktuar.
- Planetët që e përbëjnë Sistemin Diellor janë: Merkuri, Venera, Toka, Marsi, Jupiteri, Saturni, Urani dhe Neptuni.



Hëna



Sateliti artificial

Pyetje

1. Përkruaj rëndësinë e Diellit për planetin Tokë.
2. Shëno planetët e Sistemit Diellor.
3. Cilët trupa sillen rreth planetëve?

TOKA, MJEDISI DHE GJITHËSIA



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Mbajtja e strukturuar e shënimeve

Theksohet që Dielli është një yll që gjendet në qendër të Sistemit Diellor.

Sistemi Diellor ka 8 planetë: Merkuri, Venera, Toka, Marsi, Jupiteri, Saturni, Urani dhe Neptuni. Rreth planetëve sillen trupa të tjerë që quhen satelitë. Satelitët mund të jenë natyrorë, Hëna, dhe artificiale, të krijuar nga dora e njeriut.

Më pas, shfaqet një video, e cila gjendet në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=B-Kt-d0OFEV4>

Pas videos, mbahen shënime të strukturuar në tabelë.

Çfarë është Dielli?	Ku gjendet Dielli?	Cilët planetë e përbëjnë Sistemin Diellor?	Çfarë janë satelitët?
Dielli është yll, prej të cilit e marrim dritën dhe nxehtësinë.	Dielli gjendet në qendër të Sistemit Diellor.	Sistemin Diellor e përbëjnë 8 planetë: Merkuri, Venera, Toka, Marsi, Jupiteri, Saturni, Urani dhe Neptuni.	Satelitët janë mjete të krijuara nga natyra dhe njeriu, të cilët shërbejnë për marrjen e informacioneve.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Shkrim i shpejtë

Udhëzohen nxënësit të përshkruajnë në fletore rëndësinë e Diellit për planetin Tokë. Shkrimet lexohen dhe vlerësohen.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, emërtimin e planetëve në Sistemin Diellor, si dhe për përshkrimin e rëndësisë së Diellit për planetin Tokë.

Detyrë:

Modelojnë nga një planet të Sistemit Diellor.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon planetët që përbëjnë Sistemin tonë Diellor dhe identifikon planetin më të madh dhe më të vogël, më të afërt dhe më të largët me Diellin, si dhe objektet që shohim natën në qiell (Hënën, yjet).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.5; III.4; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Planetët në Sistemin Diellor - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon planetët që përbëjnë Sistemin Diellor;
- Identifikon planetët që gjenden afër dhe larg Diellit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Matematikë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënësit

Rrjeta e merimangës

Udhëzohen 10 nxënës që të marrin nga një fletë, ku janë shënuar emrat e plantëve, satelitëve dhe Dielli. Nxënësit vihen në formë rrethi të kthyer me shpinë nga njëri-tjetri. Nis lojën nxënësi që e ka Diellin, ku tregon disa karakteristika të Diellit, p.sh.:

- Unë jam Dielli, top i zjarrtë që dritë dhe nxehtësi Tokës i jap.

Më pas, vjen nxënësi që është planeti i parë në Sistemin Diellor:


- Merkuri jam, më afër Dielli mua më ka.

Nxënësit renditen sipas vendndodhjes së planetëve në Sistemin Diellor, duke treguar të veçantat e tyre. Në këtë rast, rikujtohet mësimi paraprak.

VENDI DHE HAPËSIRA

4.1. PLANETËT NË SISTEMIN DIELLOR

1. Çka marrim ne nga Dielli që është shumë e nevojshme për jetën në Tokë?



2. Shkruaj, në vendet boshe, emrat e secilit planet.

3. Lidhni me shigjetë planetët me përshkrimet e sakta.

	Merkuri
	Venera
	Toka
	Marsi
	Jupiteri
	Saturni
	Urani
	Neptuni


	Planeti më i largët nga Dielli
	Planeti më i vogël dhe më i afërt me Diellin
	Planeti i gjashtë për nga largësia
	Planeti më i madh
	I vetmi planet në të cilin ka jetë
	Planeti i kuq
	Planeti i shtatë për nga largësia
	Planeti që gjendet mes Tokës dhe Merkurit



4. Hëna, a është planet, yll apo satelit?

4.1. PLANETËT NË SISTEMIN DIELLOR

1. Çka marrim ne nga Dielli që është shumë e nevojshme për jetën në Tokë?



2. Shkruaj, në vendet boshe, emrat e secilit planet.

3. Lidhni me shigjetë planetët me përshkrimet e sakta.

Merkuri	Planeti më i largët nga Dielli
Venera	Planeti më i vogël dhe më i afërt me Diellin
Toka	Planeti i gjashtë për nga largësia
Marsi	Planeti më i madh
Jupiteri	I vetmi planet në të cilin ka jetë
Saturni	Planeti i kuq
Urani	Planeti i shtatë për nga largësia
Neptuni	Planeti që gjendet mes Tokës dhe Merkurit



4. Hëna, a është planet, yll apo satelit?



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathhtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Punë praktike - modelim**

Nxënësit ndahen në 4 grupe të punës. Dy grupet modelojnë nga 4 planetë, kurse dy grupet e tjera ngjyrosin dhe ndërtojnë Sistemin Diellor, duke u bazuar në video, e cila gjendet në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=Zq3EF7ZYv6c> Shfaqet videoja, më pas grumbullohen materialet dhe mjetet e nevojshme dhe fillohet puna me modelim.

Sqarim: Gjatë punës përshkruhet pozita dhe roli i secilit planet në Sistemin Diellor.

Puna në grupe vëzhgohet, drejtohet dhe vlerësohet.




**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve
Vlerësim i njohurive të fituara**

Kërkohet nga nxënësit të plotësojnë në mënyrë individuale në fletore pune. Puna kontrollohet dhe vlerësohet.

1. Çka marrim ne nga Dielli që është shumë e nevojshme për jetën në Tokë?

2. Shkruaj, në vendet boshe, emrat e secilit planet. (Plotësohet ilustrimi.)

3. Lidh me shigjetë planetët me përshkrimet e sakta.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, emërtimin e planetëve që e përbëjnë Sistemin Diellor, saktësinë e modelimit dhe për përcaktimin e vendndodhjes së planetëve në Sistemin Diellor.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultatet e të nxënët të temës:

Përshkruan Tokën, Diellin, Hënë dhe planetët si trupa të Sistemit Diellor.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1; II.5; III.4; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Toka dhe Hëna

Rezultatet e të nxënët të orës mësimore:

- Përshkruan planetin Tokë dhe Hënë;
- Përcakton pasojat e rrotullimit të Tokës dhe Hënës;
- Krahason të veçantat dhe të përbashkëtat e Tokës dhe Hënës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:


Përgatitja për të nxënët

Dil rrotull - fol rrotull

Nxiten nxënësit të mendojnë rreth pyetjes:

- Çfarë është Toka dhe Hëna?

Mendohet përgjigjja në heshtje për disa minuta, më pas nxënësit lëvizin dhe shkojnë në një vend ku ka hapësirë në klasë. Nxënësit ecin rrotull derisa të dëgjohet përplasja e duarve nga mësuesja; në atë moment, ata ndalojnë dhe flasin me shokun afër rreth pyetjes. Ky proces përsëritet dy-tri herë. Kërkoheq që disa nxënës të japin mendimet e tyre para klasës.




4.2. TOKA DHE HËNA

Fjalët kyçe


Toka, Hëna, rrotullimi, boshti, stinë.

Toka, prej 8 planetëve, është i pesti për nga madhësia në Sistemin tonë Diellor. Toka në hapësirë ka një pozitë të pjerrët dhe rrotullohet brenda një dite (24 orë) rreth boshtit të saj. Në anën që gjendet e kthyer nga Dielli është ditë (shih figurën), ndërsa në anën tjetër është natë.



Toka sillet rreth boshtit të saj

Përveçse rrotullohet rreth boshtit të vet, Toka rrotullohet edhe rreth Diellit. Për t'u rrotulluar rreth Diellit, Tokës i nevojitet një vit ose 365 ditë e 6 orë. Toka afrohet dhe largohet vazhdimisht nga Dielli. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, paraqiten stinët në Tokë.




365 = 1
ditë vit



Stinët e vitit

Hëna shpeshherë shihet në qiell gjatë netëve të vitit. Hëna nuk është planet e as yll, por ajo është sateliti i vetëm natyror i Tokës dhe trupi qiellor më i afërt me planetin tonë dhe i vetmi në të cilin ka arritur të shkelë njeriu. Madhësia e Hënës është vetëm sa një e katërta Tokës. Duket më e madhe se trupat e tjerë qiellorë, sepse është trupi më i afërt qiellor me planetin tonë. Hëna nuk ka kushte të favorshme për jetë.



Rrotullimi i Hënës rreth boshtit të vet dhe rreth Tokës

Zakonisht, ne e shohim vetëm një pjesë të sipërfaqes së Hënës, sepse edhe Hëna rrotullohet rreth boshtit të vet dhe Tokës në të njëjtën kohë.

Të mbajmë mend

• Toka është njëri prej 8 planetëve të Sistemit Diellor, i pesti për nga madhësia në Sistemin Diellor. Ajo rrotullohet rreth boshtit të vet, por edhe rreth Diellit.

• Hëna nuk është planet e as yll, por ajo është sateliti i vetëm natyror i Tokës dhe trupi qiellor më i afërt me planetin tonë.

Pyetje

1. Krahaso madhësinë e Tokës me planetët e tjerë.
2. Çfarë pozite ka Toka në hapësirë. Shpjego rrotullimin e saj.
3. Çfarë është Hëna dhe pse neve na duket si trupi më i madh qiellor?

TOKA, MJEDISI DHE GJITHËSIA

67



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Pyetja sjell pyetjen


Hapet libri. Lexohet teksti dhe bashkë me nxënësit zhvillohet diskutimi në klasë, duke u bazuar në ilustrimet e librit dhe përmes pyetjeve të shtruar:

- Në çfarë pozite ndodhet Toka në hapësirë?
- Sa rrotullime bën Toka?
- Si rrjedhë e rrotullimit të Tokës ndaj Diellit, kush paraqitet?
- Për sa kohë rrotullohet Toka rreth boshtit të vet? Po rreth Diellit?
- Pse kemi ditë dhe natë?
- A rrotullohemi ne bashkë me Tokën?
- Cilat janë stinët e vitit?
- Moti nëpër stinë a ndryshon? Po pse?
- Çfarë është Hëna?
- Çfarë madhësie ka Hëna?
- Sa rrotullime bën Hëna?
- A mendoni që ka jetë në Hënë?
- Si e mendoni ndërtimin e Hënës?
- Cili është roli i Hënës për planetin Tokë?



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Diagrami i Venit

Punohet në dyshe. Shënohen të veçantat dhe të përbashkëtat që kanë Toka dhe Hëna.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, përshkrimin e planetit Tokë dhe Hënës, përcaktimin e pasojave të rrotullimit të tyre, si dhe krahasimin - të veçantat dhe të përbashkëtat e Tokës dhe Hënës.

Detyrë:

Vizatimi i Tokës dhe i Hënës në fletore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan Tokën, Diellin, Hënë dhe planetët si trupa të Sistemit Diellor.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1; II.5; III.4; V.8; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Toka dhe Hëna - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Demonstron rrotullimin e Tokës dhe të Hënës;
- Argumenton rëndësinë e ditës - natës në jetë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Llamba, globi.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shkathhtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë


Rikujtimi i njohurive paraprake

Nxiten nxënësit të japim mendime rreth fjalëve *Tokë dhe Hënë*. Mendimet e tyre shënohen në tabelë.

Toka

Hëna

Më pas, plotësohen në fletore pune ushtrimi 1, 2 dhe 3.



4.2. TOKA DHE HËNA

1. Trego se sa kohë i nevojitet Tokës të rrotullohet rreth boshtit të vet dhe sa rreth Diellit?

- a) Toka rrotullohet rreth boshtit të vet për _____.
- b) Toka rrotullohet rreth Diellit për _____.

2. Tokën ndryshe e quajmë edhe planeti i kaltër. Trego pse.



3. Shkruaj më poshtë emrat e stinëve të vitit.

- a) _____
- b) _____
- c) _____
- d) _____

4. Hëna është i vetmi trup qiellor në të cilin ka shkuar njeriu.

Rretho: **e saktë** **e pasaktë**



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Pyetja sjell pyetjen

Demonstrohen para nxënësve lëvizja e Tokës rreth boshtit të saj dhe lëvizja rreth Diellit, sipas ilustrimit.



Rrotullimi i Tokës



Rrotullimi i Hënës

Theksohet:

Toka rrotullohet brenda një dite (24 orë) rreth boshtit të saj. Në anën që gjendet e kthyer nga Dielli është ditë, ndërkaq në anën tjetër është natë. Toka rrotullohet rreth Diellit për 365 ditë e 6 orë. Toka afrohet dhe largohet vazhdimisht nga Dielli. Si rezultat i këtyre ndryshimeve, paraqiten stinët në Tokë.

Po ashtu, Hëna rrotullohet rreth boshtit të vet dhe rreth Tokës në të njëjtën kohë.

Pas demonstrimit dhe shpjegimit të rrotullimeve që bëjnë Toka dhe Hëna, mbahen shënime të tjera të strukturuar në tabelë.

Pse formohen stinët e vitit?	Për sa kohë rrotullohet Toka rreth boshtit të saj?	Cili është roli i Hënës për Tokën?	Trego pse Tokën e quajmë Planeti i kaltër.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Ruaje fjalën e fundit për mua

Kërkohet nga nxënësit të mendojnë rreth pyetjes: *Si do të ishte jeta nëse nuk do të kishte ditë - natë?* Mendimet e tyre tregohen para klasës dhe kërkohen komente nga të tjerët. Secili nxënës dëgjon mendimet e dhëna dhe në fund jep një konkludim.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, në saktësinë e demonstrimit të mënyrës së rrotullimit të Tokës dhe të Hënës, argumentimin e mendimit për rëndësinë e ditës dhe natës.

Detyrë:

Plotësohet në fletore pune.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultatet e të nxënit të temës:

Kupton se objektet, pjesët e sipërfaqes dhe Toka mund të paraqiten në letër, në glob, të zvogëluara dhe me shenja të veçanta, si dhe përse shërben hartimi i planit të një vendi ose ndërtese.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1; III.2, III.4; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Harta, globi dhe plani

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Tregon elementet e hartës dhe globit;
- Shpjegon përdorimin e hartës, globit dhe planit;
- Demonstron, me anë të vizatimit, planin e klasës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Hartë, glob, ngjyra, vizore.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:


Përgatitja për të nxënësit

Stuhi mendimesh

Vendoset mbi bankë globi dhe në tabelë harta. Nxiten nxënësit të marrin pjesë në diskutim përmes pyetjeve të shtruara, si:

- Për çfarë na shërbejnë harta dhe globi?
- Si përdoren?
- Si mund të orientohemi me hartë?

Nga diskutimi arrihet në përfundim që harta paraqet sipërfaqen e Tokës me shkallë zvogëlimi, po ashtu edhe globi, por në formë të rrumbullakët.





Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Harta e koncepteve

Theksohet që:

Për të paraqitur objekte natyrore të Tokës ose objekte të ndërtuara nga njeriu, përdorim modele të ndryshme. Modele të tilla janë: harta, globi dhe plani. Nxënësve u shpërndahet fleta e punës në të cilën është punuar harta e konceptit. Hapen librat dhe lexohet mësimi në mënyrë zinxhimore. Më pas, plotësohet tabela me të informacionet e marra.

Harta

- Paraqitja e sipërfaqes së Tokës me shkallë zvogëlimi.
- Na ndihmon të orientohejmë në natyrë.

Globi

- Tregon sipërfaqen e Tokës ashtu siç është.
- Demonstron rrotullimin e Tokës rreth boshtit të saj dhe rreth Diellit.

Plani

- Vizatim i detajuar i një vendi.
- Paraqet karakteristikat gjeometrike të një vendi ose objekti.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Provo veten

Në skemën e dhënë në libër, kërkohet nga nxënësit ta plotësojnë me anë të vizatimit planin e

klasës, ku duken banka, tabela, karriget etj., duke përdorur lapsin dhe ngjyrat. Puna vëzhgohet dhe vlerësohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, mënyrën e përdorimit të hartës, globit dhe planit dhe demonstrimin e planit me anë të vizatimit.

Detyrë:

U përgjigjet pyetjeve 1, 2 dhe 3, në libër.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Vendi dhe hapësira

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Kupton se objektet, pjesët e sipërfaqes dhe Toka mund të paraqiten në letër, në glob, të zvogëluara dhe me shenja të veçanta, si dhe përse shërben hartimi i planit të një vendi ose ndërtese.

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.1; III.2, III.4; V.8.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Harta, globi dhe plani - fletore pune

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Plotëson tabelën me njohuritë e fituara;
 - Demonstron rrotullimin e Tokës me anë të globit;
 - Përcakton vendndodhjen e qyteteve në hartë.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:


Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Gjuhë amtare, Shkathhtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
Analizë e tipareve semantike

Udhëzohen nxënësit të punojnë në grupe. Secili grup, pasi ka përvetësuar njohuri rreth hartës, globit dhe planit, plotëson tabelën e dhënë, në fletë A4.

	Letër	Shenja	Vizatim i lirë	Shkallë zvogëlimi	Sipërfaqja e Tokës	
Harta						
Globi						
Plani						



3. Në figurën më poshtë, lidhi numrat nga 1 deri në 10. Ngjyrose figurën që krijove!



4. Lidh me vizë përgjigjen e saktë me figurën në katror.

Plani është:



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes**
Pyetje – përgjigje

Vazhdohet puna në mënyrë individuale, duke plotësuar faqen në fletore pune.

1. Ngjyros hartën e Kosovës, duke përdorur ngjyrat e duhura.
2. Plotëso:

Shteti: Republika e Kosovës	Banorë: Përafërsisht 2 milionë
Kryeqyteti: Prishtina	Kontinenti: Evropë
Gjuha: Shqip	Ngjyrat e flamurit: Kaltër, verdhë dhe bardhë

3. Rretho përgjigjen e saktë. Është në formë rrethore dhe ngjason me formën e Tokës:
Harta Globi

4. Lidh numrat nga 1 deri në 10. Ngjyros figurën që formove.
5. Lidh me shigjetë përgjigjen e saktë.

Plani është:

Pas plotësimit, shkëmbehen librat me njëritjetrin, ku kontrollohet puna dhe vlerësohet.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit**
Punë praktike

Para nxënësve paraqiten globi dhe harta e Kosovës, me të cilat praktikohen orientimi dhe pozita e vendeve.

Demonstrohen, së bashku me nxënësit, rrotullimet e Tokës me glob, gjendet hemisfera jugore dhe veriore, si dhe ekuatori.



Nxënësve u caktohet nga një qytet apo fshat i Kosovës, të cilin do ta gjejnë në hartë.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, demonstrimin e rrotullimit të Tokës me glob dhe përcaktimin e vendndodhjes së qyteteve në hartë.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Sistemet fizike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan, identifikon, dallon dhe krahason elementet natyrore në mjedisin ku jeton; format kryesore të relievit (malet, fushat, lumenjtë, liqenet etj.) në mjedisin ku jeton; udhëtimin nga shtëpia në shkollë, ose nga vendi i banimit në piknik dhe anasjellas; motin (me diell, shi, erë etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.4, II.7; III.1, III.2; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Format e relievit

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon format kryesore të relievit;
- Përshkruan elementet natyrore të formave të relievit;
- Krahason format kryesore të relievit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Projektor, laptop.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:

Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Mendo - thuaje

Para nxënësve paraqitet ilustrimi me anë të projektorit.

Shtrohen pyetjet:

1. Çfarë vëreni në ilustrim?
2. A janë të njëjta sipërfaqet e Tokës?

SISTEMET FIZIKE

4-4. FORMAT E RELIEVIT

Fjalët kyçe
relievi, moti.

Relievi

Toka nuk është e rrafshët sikurse duket në hartë. Në Tokë ka male, vargmale, kodra, pyje, fusha, lugina, lumenj, kanione, ujëvara etj. Dhe këtu shtrohet pyetja: si të paraqiten të gjitha këto në një hartë? Në hartë, këto mund të paraqiten përmes ngjyrave të ndryshme, duke treguar edhe lartësinë mbidetare, siç tregon figura më poshtë.

Relievi i një zone në Bjeshkët e Nemuna (Alpet Shqiptare)

Në vendin ku ju jetoni, ngjiteti në majën më të lartë dhe nga aty vizatoni format e relievit që vëreni dhe shkruani emërtimet e tyre. Në gjeografi, relievi i një zone është ndryshimi midis pjesëve të saj më të larta (malet, kodrat) dhe më të ulëta (fushat, luginat). Për shembull, Bjeshkët e Nemuna (Alpet Shqiptare) me kodrat dhe luginat janë mbresëlënëse, siç tregohet në figurë.

Çfarë ndikimi ka relievi në motin e një vendbanimi?

Moti është gjendja e atmosferës në një vend dhe kohë të caktuar. Ai përcaktohet nga temperatura, shtypja atmosferike, era, lagështia, retë dhe reshjet. Zakonisht, nëpër lugina dhe rrafshina temperaturat janë më të larta sesa nëpër lartësitë e mëdha mbidetare (male dhe kodra), në lartësitë e mëdha ka edhe reshje më shumë. P.sh., derisa në lugina dhe rrafshina kemi gjelbërim, në male dhe kodra mund të ketë reshje bore.

Të mbajmë mend

- Toka nuk është e rrafshët. Në të ka male, vargmale, kodra, pyje, fusha, lugina, lumenj, kanione, ujëvara etj.
- Relievi i një zone është ndryshimi midis pjesëve të saj më të larta (malet, kodrat) dhe më të ulëta (fushat, luginat).
- Moti zakonisht dallon nëpër lugina dhe rrafshina, në krahasim me malet dhe kodrat.

Moti i një vendi

Pyetje

1. Çfarë është relievi?
2. Përmend format e relievit në Tokë.
3. Shpjego dallimin e motit në lugina dhe rrafshina.

TOKA, MJEDISI DHE GJITHËSIA

70



4.4. FORMAT E RELIEVIT

Fjalët kyçe
relievi, moti.



Relievi

Toka nuk është e rrafshët sikurse duket në hartë. Në Tokë ka male, vargmale, kodra, pyje, fusha, lugina, lumenj, kanione, ujëvara etj. Dhe këtu shtrihet pyetja: si të paraqiten të gjitha këto në një hartë? Në hartë, këto mund të paraqiten përmes ngjyrave të ndryshme, duke treguar edhe lartësinë mbidetare, siç tregon figura më poshtë.



Relievi i një zone në Bjeshkët e Nemuna (Alpet Shqiptare)

Në vendin ku ju jetoni, ngjytuni në majën më të lartë dhe nga aty vizatoni format e relievit që vëreni dhe shkruani emërtimet e tyre. Në gjeografi, relievi i një zone është ndryshimi midis pjesëve të saj më të larta (malet, kodrat) dhe më të ulëta (fushat, luginat). Për shembull, Bjeshkët e Nemuna (Alpet Shqiptare) me kodrat dhe luginat janë mbresëlënëse, siç tregohet në figurë.


Cfarë ndikimi ka relievi në motin e një vendbanimi?

Moti është gjendja e atmosferës në një vend dhe kohë të caktuar. Ai përcaktohet nga temperatura, shtypja atmosferike, era, lagështia, retë dhe reshjet. Zakonisht, nëpër luginat dhe rrafshina temperaturat janë më të larta sesa nëpër lartësitë e mëdha mbidetare (male dhe kodra), në lartësitë e mëdha ka edhe reshje më shumë. P.sh., derisa në luginat dhe rrafshina kemi gjelbërim, në male dhe kodra mund të ketë reshje bore.

Të mbajmë mend

- Toka nuk është e rrafshët. Në të ka male, vargmale, kodra, pyje, fusha, lugina, lumenj, kanione, ujëvara etj.
- Relievi i një zone është ndryshimi midis pjesëve të saj më të larta (malet, kodrat) dhe më të ulëta (fushat, luginat).
- Moti zakonisht dallon nëpër luginat dhe rrafshina, në krahasim me malet dhe kodrat.

Moti i një vendi



Moti i një vendi

Pyetje

1. Cfarë është relievi?
2. Përmend format e relievit në Tokë.
3. Shpjego dallimin e motit në luginat dhe rrafshina.

TOKA, MJEDISI DHE GJITHËSIA

70

3. Si emërtohen sipërfaqet e Tokës të paraqitura në ilustrim?

4. Keni pasur rastin të vizitoni ndonjë pjesë të këtyre sipërfaqeve?

Nga diskutimet arrihet në përfundim që në Tokë ka male, kodra, pyje, fusha, lugina, lumenj, ujëvara, bjeshkë etj. Të gjitha këto me një fjalë quhen RELIEV.

**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes***Tabela e koncepteve*

Pas diskutimit, emërtohen me radhë të gjitha format e sipërfaqes së Tokës. Lexohet njësia mësimore dhe, nga informacionet e marra, plotësohet tabela e paraqitur.

Koncepti	Shpjegimi
Reliev	Relievi është tërësia e pamjes së formave të sipërfaqes tokësore.
Mali	Formë e ngritur e sipërfaqes së Tokës. Malet kanë rrezen, shpatin dhe majën.
Kodra	Kodrat janë forma të ngritura të Tokës, por më të ulëta se malet.
Fusha	Sipërfaqe të rrafshëta të Tokës.
Liçeni	Thellësi i Tokës, sipërfaqja e së cilës është e mbuluar me ujë.
Lumi	Rrjedhë natyrore e ujit që është e kufizuar në të dyja anët me tokë. Uji qarkullon.
Ujëvara	Vend ku uji bie nga një lartësi.



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve**
Organizues grafik

Udhëzohen nxënësit për punë në grupe, ku secili grup gjen të veçantat dhe të përbashkëta të formave të sipërfaqeve të dhëna.

Grupi 1 – Mali dhe fusha

Grupi 2 – Kodra dhe mali

Grupi 3 – Lumi dhe liçeni

Grupi 4 – Ujëvara dhe lumi

Puna prezantohet para klasës, kontrollon dhe vlerësohet.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për saktësinë e identifikimit të formave të relievit, përshkrimin e elementeve natyrore të tyre, si dhe për krahasimin e formave kryesore të relievit.

Detyrë:

U përgjigjen pyetjeve 1,2 dhe 3 në fletore.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Sistemet fizike

Rezultatet e të nxënit të temës:

Përshkruan, identifikon, dallon dhe krahason elementet natyrore në mjedisin ku jeton; format kryesore të relievit (malet, fushat, lumenjtë, liqenet etj.) në mjedisin ku jeton; udhëtimin nga shtëpia në shkollë, ose nga vendi i banimit në piknik dhe anasjellas; motin (me diell, shi, erë etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: I.3; II.4, II.7; III.1, III.2; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Format e relievit - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon format kryesore të relievit;
- Përshkruan elementet natyrore të tyre;
- Interpretin qartë njohuritë e fituara.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Enciklopedi, ilustrime.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënë

Rikujtim i njohurive paraprake

Hapen fletoret e punës. Plotësohet faqja në dyshe. Secila dyshe ka mundësi të shkëmbejë mendimet lidhur me ushtrimet e paraqitura në libër.


1. Shkruaj në tabelë numrat e duhur, duke dalluar format e relievit.
2. Shëno. Si ndikon relievi në temperaturat e një vendbanimi? (Një fjali ose dy fjali.)

4-4. FORMAT E RELIEVIT

1. Paraqit, me anë të vizatimit, bleshkën që e keni vizituar, duke i dalluar me ngjyra ato që shihni (fushat, malet, kodrat etj.).

2. Shkruaj në tabelë numrat e duhur.

Format e relievit	Numri
Ujëvara	
Lumi	
Mali	
Fusha	
Kanioni	
Kodra	
Liqeni	




3. Si ndikon relievi në temperaturat e një vendbanimi?

4.4. FORMAT E RELIEVIT

1. Paraqit, me anë të vizatimit, bjeshtë që e keni vizituar, duke i dalluar me ngjyra ato që shihni (fushat, malet, kodrat etj.).

2. Shkruaj në tabelë numrat e duhur.

Format e relievit	Numri
Ujëvara	
Lumi	
Mali	
Fusha	
Kanioni	
Kodra	
Liçeni	



3. Si ndikon relievi në temperaturat e një vendbanimi?



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Të nxënësit në këmbim (Grup ekspertësh)

Duke u bazuar në njohuritë e fituara nga njësia e kaluar, udhëzohen nxënësit për punë grupore. Grupet emërohen sipas formave të relievit.

Grupi M - Identifikojnë informacione në enciklopedi dhe përshkruajnë elementet natyrore të malit. Emërtojnë malet e njohura në Kosovë.

Grupi L - Identifikojnë informacione në enciklopedi dhe përshkruajnë elementet natyrore të liqenit. Emërtojnë liqenet e Kosovës.

Grupi K - Identifikojnë informacione në enciklopedi dhe përshkruajnë elementet natyrore të kodrës. Emërtojnë kodrat e Kosovës.

Grupi U - Identifikojnë informacione në enciklopedi dhe përshkruajnë elementet natyrore të ujëvarës. Emërtojnë ujëvarat e Kosovës.

Puna në grupe udhëzohet, orientohet dhe ndihmohet me informacione të tjera shtesë.



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësit

Stacioni i trenit

Në katër këndet (stacionet) e klasës paraqitet punë e përfunduar. Grupet (treni) me radhë afrohen afër grupit 1, ku një përfaqësues nga ky grup prezanton punimin. Secili grup ka të drejtë të shtrojë pyetje apo të shtojë ndonjë informacion tjetër shtesë për grupin 1 në këtë rast. Vazhdohet kështu derisa të prezantohet grupi i fundit (grupi 4).

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, në identifikimin dhe përshkrimin e formave kryesore të relievit.

Detyrë:

Plotësohet në fletore pune ushtrimi 1.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Bashkëveprimi i njeriut me natyrën

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Tregon për mënyrat e ndikimit të njeriut në natyrë (si të ruhet cilësia e ajrit, ujit dhe tokës) dhe rëndësinë e ruajtjes së mjedisit (me figura, me shenja të informimit etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: 1.3; II.1, II.4; V.9; IV.4.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.5.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ruajtja e mjedisit

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përcakton ndotësit e mjedisit;
 - Identifikon mënyrat për ruajtjen e mjedisit jetësor.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënë
 Parashikim me terma paraprakë

Në tabelë shënohen fjalët *mjedis*, *mbeturina*, *ndotje*. Nxiten nxënësit të mendojnë për 3-4 minuta një tekst të shkurtër lidhur me fjalët e dhëna.
 Nxënësit shprehin mendimet para klasës. Arrihet në përfundim që me mjedis jetësor kuptojmë çdo gjë të gjallë (organizmat e gjallë) dhe jo të gjallë (uji, ajri, toka etj.) që gjendet rreth nesh. Njeriu e zhvillon jetën në mjedisin e vet dhe ai duhet të kujdeset për të.

4.5. RUAJTJA E MJEDISIT

Me mjedis jetësor kuptojmë çdo gjë të gjallë (organizmat e gjallë) dhe jo të gjallë (përfshirë këtu ajrin, tokën, ujin etj.) që gjendet rreth nesh. Njeriu e zhvillon jetën në mjedisin e vet, d.m.th. nga mjedisi merr gjërat e nevojshme (ujin, ajrin, ushqimin etj.), por edhe hedh produkte të ndryshme, të cilat ai i krijon. Disa prej këtyre produkteve janë të larta për mjedisin (plastika, qelqi etj.), ose janë në sasi më të larta se zakonisht dhe shkaktojnë ndotje (dyoksidi i karbonit, pluhuri etj.). Kështu, aktivitetet e njeriut kanë ndikuar në ndotjen e ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit (botës së gjallë).

Fjalët kyçe
 mjedisi, mbeturinat, ndotja.



Ndotja e mjedisit

Mendo dhe analizo: nëse, për shembull, ti nuk kujdesesh për mjedisin, kjo nuk do të jetë vetëm në dëm tënd, por edhe në dëm të njerëzve të tjerë. Pra, një pakujdesi ndaj mjedisit nga ti do ndikojë edhe te të tjerët, megjë mjedisi është i përbashkët.

Si mund ta bëjmë këtë?

Duke i hedhur mbeturinat vetëm nëpër vendet e caktuara; duke e bërë ndarjen e mbeturinave; duke i ruajtur pyjet nga zjarret; duke përdorur transportin publik sa më shumë që është e mundur; duke kursyer energjinë elektrike; duke kursyer ujin e pijshëm, duke organizuar aktivitete të ndryshme pastrimi etj.



Mbeturinat nuk duhen hedhur gjithkund

Grumbullimi i mbeturinave

Ndarja e mbeturinave

Pyetje

1. Çfarë kuptojmë me mjedis?
2. Si bashkëvepron njeriu me mjedisin?
3. Identifiko mënyrat e mundshme të mbrojtjes së mjedisit nga ne.

Të mbajmë mend

- Mjedis jetësor është çdo gjë e gjallë (organizmat e gjallë) dhe jo e gjallë (ajri, toka, uji etj.) që gjendet rreth nesh.
- Njeriu me aktivitetet e veta po ndikon vazhdimisht në ndotjen e ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit.
- Ne mund të bëjmë shumë për mbrojtjen e mjedisit.

4-5. RUAJTJA E MJEDISIT

Me mjedis jetësor kuptojmë çdo gjë të gjallë (organizmat e gjallë) dhe jo të gjallë (përfshirë këtu ajrin, tokën, ujin etj.) që gjendet rreth nesh. Njeriu e zhvillon jetën në mjedisin e vet, d.m.th. nga mjedisi merr gjërat e nevojshme (ujin, ajrin, ushqimin etj.), por edhe hedh produkte të ndryshme, të cilat ai i krijon. Disa prej këtyre produkteve janë të reja për mjedisin (plastika, qelqi etj.), ose janë në sasi më të lartë se zakonisht dhe shkaktojnë ndotje (dyoksidi i karbonit, pluhuri etj.). Kështu, aktivitetet e njeriut kanë ndikuar në ndotjen e ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit (botës së gjallë).

Fjalët kyçe

mjedisi, mbeturinat, ndotja.



Ndotja e mjedisit

Mendo dhe analizo: nëse, për shembull, ti nuk kujdesesh për mjedisin, kjo nuk do të jetë vetëm në dëm të tënd, por edhe në dëm të njerëzve të tjerë. Pra, një pakujdesi ndaj mjedisit nga ti do ndikojë edhe te të tjerët, meqë mjedisi është i përbashkët.

Si mund ta bëjmë këtë?

Duke e hedhur mbeturinat vetëm nëpër vendet e caktuara; duke e bërë ndarjen e mbeturinave; duke i ruajtur pyjet nga zjarret; duke përdorur transportin publik sa më shumë që është e mundur; duke kursyer energjinë elektrike; duke kursyer ujin e pijshëm, duke organizuar aktivitetet e ndryshme pastrimi etj.



Mbeturinat nuk duhen hedhur gjithkund

Grumbullimi i mbeturinave

Ndarja e mbeturinave

Të mbajmë mend

- Mjedis jetësor është çdo gjë e gjallë (organizmat e gjallë) dhe jo e gjallë (ajri, toka, uji etj.) që gjendet rreth nesh.
- Njeriu me aktivitetet e veta po ndikon vazhdimisht në ndotjen e ajrit, ujit, tokës dhe biodiversitetit.
- Ne mund të bëjmë shumë për mbrojtjen e mjedisit.

Pyetje

- Çfarë kuptojmë me mjedis?
- Si bashkëvepron njeriu me mjedisin?
- Identifiko mënyrat e mundshme të mbrojtjes së mjedisit nga ne.

TOKA, MJEDISI DHE GJITHËSIA

71



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Tabela e koncepteve

Hapen librat. Lexohet njësia mësimore nga nxënësit e më pas plotësohet tabela e koncepteve nga ta.

Mjedis	Ndotësit	Pasojat
Tokë Ajër Ujë	Mbeturinat Tymi i fabrikave Makinat Plehrat kimike	Ndotet ushqimi dhe uji i pijshëm që shkaktojnë shumë sëmundje. Dëmtohen gjallesat etj.

Puna kontrollohet dhe vlerësohet.

Më pas, nxiten nxënësit për diskutim përmes pyetjes:

- Nëse ti nuk kujdesesh për mjedisin, kujt i bën dëm?

Nga diskutimi arrihet në përfundim që një pakujdesi ndaj mjedisit nga ti do të ndikojë në shëndetin e të tjerëve, sepse mjedisi është i përbashkët.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Punë në dyshe

Udhëzohen nxënësit të punohet në dyshe, në fleta A4.

Ne konsumojmë çdo ditë sasi të mëdha ushqimi dhe njëkohësisht prodhojmë shumë mbeturina.

- Çfarë do të bëhet me to?
- Cilët hapa duhen marrë në këtë rast?
- Si mund të kontribuojmë ne që ta mbrojmë mjedisin nga mbeturinat?

Idetë e tyre lexohen para klasës. Puna vlerësohet nga dyshja më e afërt.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, në përcaktimin e ndotësve të mjedisit, si dhe në identifikimin e mënyrave për ruajtjen e mjedisit jetësor.

Detyrë:

U përgjigjet pyetjeve të dhëna në libër.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Bashkëveprimi i njeriut me natyrën

Rezultatet e të nxënësve të temës:
 Tregon për mënyrat e ndikimit të njeriut në natyrë (si të ruhet cilësia e ajrit, ujit dhe e tokës) dhe rëndësinë e ruajtjes së mjedisit (me figura, me shenja të informimit etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës:

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës:

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ajri dhe ndotja e tij

Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:

- Përcakton përbërësit e ajrit;
- Identifikon ndotësit e ajrit;
- Përshkruan pasojat e qëndrimit në mjedise të ndotura;
- Harton tri këshilla për mbrojtjen e organeve të frymëmarrjes.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Laptop, fleta A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Edukatë figurative, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësit
Stuhi mendimesh

Kërkohej nga nxënësit të mbajnë hundën dhe gojën mbyllur për 30 sekonda. Shtrohen pyetjet:

- Si u ndiet gjatë 30 sekondave?
- Për çfarë na shërben hunda dhe goja?
- Çfarë marrim përmes hundës dhe gojës?

Nga diskutimi arrihet në përfundim që njeriu merr frymë nga hunda dhe goja; nga hunda marrim ajrin, kurse nga goja e lirojmë atë; pa ajër nuk mund të jetohej.

BASHKËVEPRIMI I NJERIUT ME NATYRËN

4.6. AJRI DHE NDOTJA E TIJ

Fjalët kyçe
 ajri, ndotësit, sëmundjet.

Ajri është përzjerje e gazeve të ndryshme (azot, oksigjen, dyoksid karboni, avuj të ujit, pluhur etj.), i cili është i domosdoshëm për jetën e organizmave të gjallë. Përbërësit e tij kanë një përqindje të caktuar, p.sh., azoti (78%), oksigjeni (21%), dyoksidi i karbonit (0.038%) etj. Shtimi i ndonjë përbërësi të ri, ose ndryshimi i madh i përqindjes së ndonjë përbërësi ekzistues të ajrit shkakton ndotje.

Ndotësit kryesorë të ajrit janë: tymi, grimcat e pluhurit dhe gazet e shkarkuara nga industritë, termocentralet, qarkullimi i automjeteve, oxhaqet e shtëpive, djegia e mbeturinave etj. Ndotësit e ajrit kanë efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe mund të shkaktojnë sëmundje të organeve të frymëmarrjes, siç janë: pneumonia, astma, kanceri i mushkërive etj. Ndotësit gjithashtu dëmtojnë bimët dhe shtazët, ndërtesat, monumentet etj.



Ndotësit kryesorë të ajrit

Të mbajmë mend

• Ajri është përzjerje e gazeve me një përqindje të caktuar. Çdo shtim i ndonjë përbërësi të ri, ose ndryshimi i madh të përqindjes së ndonjë përbërësi ekzistues të ajrit shkakton ndotje.

Pyetje

1. Identifiko ndotësit kryesorë të ajrit.
2. Përshkruaj efektet e dëmshme të ndotjes së ajrit për shëndetin e njeriut.

TOKA, MJEDISI DHE GJITHËSIA

4.6. AJRI DHE NDOTJA E TIJ

Fjalët kyçe
ajri, ndotësit, sëmundjet.

Ajri është përzierje e gazeve të ndryshme (azot, oksigjen, dyoksid karboni, avuj të ujit, pluhur etj.), i cili është i domosdoshëm për jetën e organizmave të gjallë. Përbërësit e tij kanë një përqindje të caktuar, p.sh., azoti (78%), oksigjeni (21%), dyoksidi i karbonit (0.038%) etj. Shtimi i ndonjë përbërësi të ri, ose ndryshimi i madh i përqindjes së ndonjë përbërësi ekzistues të ajrit shkakton ndotje.

Ndotësit kryesorë të ajrit janë: tymi, grimcat e pluhurit dhe gazet e shkarkuara nga industritë, termocentralet, qarkullimi i automjeteve, oxhaqet e shtëpive, djegia e mbeturinave etj. Ndotësit e ajrit kanë efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut dhe mund të shkaktojnë sëmundje të organeve të frymëmarrjes, siç janë: pneumonia, astma, kanceri i mushkërive etj. Ndotësit gjithashtu dëmtojnë bimët dhe shtazët, ndërtesat, monumentet etj.



Ndotësit kryesorë të ajrit

Të mbajmë mend

- Ajri është përzierje e gazeve me një përqindje të caktuar. Çdo shtim i ndonjë përbërësi të ri, ose ndryshimi i madh të përqindjes së ndonjë përbërësi ekzistues të ajrit shkakton ndotje.

Pyetje

- Identifiko ndotësit kryesorë të ajrit.
- Përshkruaj efektet e dëmshme të ndotjes së ajrit për shëndetin e njeriut.

TOKA, MJEDISI DHE GJITHËSIA

72



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive: Përpunimi i përmbajtjes Pyetja sjell pyetjen

Hapet libri. Lexohet teksti dhe zhvillohet diskutimi me pyetje:

- Çfarë është ajri?
- Cilët janë përbërësit e tij?
- Cilët janë ndotësit e ajrit?
- Si ndikon ajri i ndotur në organizmin e njeriut?

Ja disa përgjigje të mundshme: *Ajri është përzierje e gazeve; përbëhet nga azoti, oksigjeni dhe dyoksidi i karbonit; ndotësit e ajrit janë tymi, mbeturinat, makinat, gazet; ndotësit kanë efekt të dëmshëm në organizmin e njeriut dhe mund të shkaktojnë sëmundje të organeve të frymëmarrjes.*

Shfaqet një video, e cila paraqet ndotësit e ajrit dhe ndikimin e tyre në shëndetin tonë. Shih në vegëzën: https://www.youtube.com/watch?v=t7Q7y_xjR5E Shtrohen pyetje kohë pas kohe, gjatë shikimit të videos.



Përforcimi: Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit Mendo – modelo – shëno

Udhëzohen nxënësit që të punohet në grupe. Secili grup do të shkruajë nga tri këshilla për

mbrojtjen e organeve të frymëmarrjes. Nga fletët A4, formojnë forma të ndryshme, priten dhe në to shënohen këshillat e tyre.



Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, për identifikimin e ndotësve të ajrit, përshkrimin e saktë të pasojave të qëndrimit në mjedise të ndotura, si dhe hartimin e këshillave për ruajtjen e organeve të frymëmarrjes.

Detyrë:

Krijo një poster për ruajtjen e mjedisit dhe një poster për mbrojtjen e shëndetit nga tymi.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Bashkëveprimi i njeriut me natyrën

Rezultatet e të nxënit të temës:
 Tregon për mënyrat e ndikimit të njeriut në natyrë (si të ruhet cilësia e ajrit, ujit dhe e tokës) dhe rëndësinë e ruajtjes së mjedisit (me figura, me shenja të informimit etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: 1.8; II.2; III.4; IV.4; V.9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ruajtja e mjedisit dhe e ajrit - fletore pune

- Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:**
- Përshkruan ndotësit e mjedisit dhe ajrit;
 - Shpjegon sëmundjet që shkaktohen nga ndotja.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore:
 Gjuhë amtare, Shkathësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:
Përgatitja për të nxënët
 Diskutim për njohuritë paraprake

Në fillim të orës, paraqiten disa nga posterat (këshilla për mbrojtjen e organeve të frymëmarrjes) e dhënë si detyrë shtëpie.
 Këshillat lexohen dhe diskutohen bashkë me nxënësit në klasë.



4-5. RUAJTJA E MJEDISIT DHE E AJRIT

1. Si mund të kontribuosh në mbrojtjen e mjedisit? Trego me disa shembuj.





2. Lidh, me shigjeta, se në cilin kosh të plehrave duhet të hidhen mbeturinat:



3. Cilat sëmundje mund të shkaktohen nga ndotja e ajrit?



**Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Pyetje - përgjigje**

Hapen librat. Plotësohen ushtrimet e dhëna.

Ushtrimi 1. Duke u bazuar në ilustrimet e paraqitura, përgjigju pyetjes së shtruar.

- Si mund të kontribuosh në mbrojtjen e mjedisit?

Ushtrimi 2. Lidh me shigjeta se në cilin kosh të plehrave duhet të hidhen mbeturinat:

Ushtrimi 3. Cilat sëmundje mund të shkaktohen nga ndotja e ajrit?



**Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënët
Loja - Blic**

Udhëzohen nxënësit të formojnë një rreth. Loja fillon kur hidhet topi nga një nxënës te nxënësi tjetër. Në momentin që ai kap topin, përgjigjet në

pyetjen e shtruar nga hedhësi i topit. Përgjigja nuk vonohet më shumë se 30 sekonda. Nëse nuk ka përgjigje për pyetjen e shtruar, topi kalohet te nxënësi tjetër. Loja zhvillohet kështu derisa të përfshihen të gjithë pjesëmarrësit.

Sqarim: Pyetjet shtrohen duke u bazuar në dy njësitë e fundit të zhvilluara.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, për saktësinë e dhënies së përgjigjeve, përshkrimin e ndotësve të mjedisit dhe ajrit, si dhe për shpjegimin e sëmundjeve që shkaktohen nga ndotja e ajrit dhe mjedisit.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Bashkëveprimi i njeriut me natyrën

Rezultatet e të nxënësve të temës:
 Tregojnë për mënyrat e ndikimit të njeriut në natyrë (si të ruhet cilësia e ajrit, ujit dhe tokës) dhe rëndësinë e ruajtjes së mjedisit (me figura, me shenja të informimit etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: 1.8; II.2; III.4; IV.4; V.9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndotja e ujit

- Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**
- Përshkruan rëndësinë e ujit në jetën tonë;
 - Identifikon shkaktarët e ndotjes së ujit;
 - Shpjegon si duhet parandaluar ndotja e ujit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.


Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fleta A4, laptop, projektor.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS

Parashikimi:
Përgatitja për të nxënësve
 Harta e mendjes

Nxiten nxënësit të japin mendime rreth ujit. Mendimet e tyre shënohen në tabelë. P.sh.:



4.7. NDOTJA E UJIT




Ndotja e ujit nga mbeturinat e ndryshme

Fjalët kyçe
 uji, ndotja, kimikate.

Uji është i domosdoshëm për jetën e njeriut, bimëve dhe kafshëve. Pa ujë nuk ka jetë. Ne, pos që e përdorim ujin për pije, atë e përdorim edhe për pastrim dhe në industri. Uji sot është jashtëzakonisht i ndotur si rezultat i hedhjes së mbeturinave, shkarkimit të ujërave të zeza që vijnë nga amvisëritë, ujërat e fabrikave, termocentraleve, nga kimikatet e hedhura në tokat bujqësore etj.

Ndotja e ujit nga të gjitha këto aktivitete të njeriut ndikon edhe në ndotjen e tokës dhe mjedisit në përgjithësi. Që ta parandalojmë ndotjen e ujit, duhet të kemi kujdes që të mos i hedhim mbeturinat dhe helmimet e ndryshme në ujë, të trajtohen (pastrohen) ujërat e ndotura në fabrikat për pastrim të ujit dhe, vetëm pasi të pastrohen, ato të derdhen në lumenj etj.



Fabrikat për pastrim të ujit

Të mbajmë mend

- Uji është i domosdoshëm për njeriun, bimët dhe kafshët, prandaj pa të nuk ka jetë.
- Ndotja e ujit sot është shumë e lartë nga hedhja e mbeturinave, ujërave të zeza, kimikateve bujqësore etj.
- Që të parandalojmë ndotjen e ujit, duhet t'i zvogëlojmë aktivitetet ndotëse dhe të bëjmë ngritjen e fabrikave të pastrimit të ujit.

Pyetje

1. Për çfarë e përdorim ujin?
2. Identifiko shkaktarët e ndotjes së ujit.
3. Si duhet parandaluar ndotjen e ujit?

4.7. NDOTJA E UJIT




Ndotja e ujit nga mbeturinat e ndryshme

Fjalët kyçe

uji, ndotja, kimikate.

Uji është i domosdoshëm për jetën e njeriut, bimëve dhe kafshëve. Pa ujë nuk ka jetë. Ne, pos që e përdorim ujin për pije, atë e përdorim edhe për pastrim dhe në industri. Uji sot është jashtëzakonisht i ndotur si rezultat i hedhjes së mbeturinave, shkarkimit të ujërave të zeza që vijnë nga amvisëritë, ujërat e fabrikave, termocentraleve, nga kimikate e hedhura në tokat bujqësore etj.

Ndotja e ujit nga të gjitha këto aktivitete të njeriut ndikon edhe në ndotjen e tokës dhe mjedisit në përgjithësi. Që ta parandalojmë ndotjen e ujit, duhet të kemi kujdes që të mos i hedhim mbeturinat dhe helmet e ndryshme në ujë, të trajtohen (pastrohen) ujërat e ndotura në fabrikat për pastrimin e ujit dhe, vetëm pasi të pastrohen, ato të derohen në lumenj etj.



Fabrikat për pastrimin e ujit

Të mbajmë mend

- Uji është i domosdoshëm për njeriun, bimët dhe kafshët, prandaj pa të nuk ka jetë.
- Ndotja e ujit sot është shumë e lartë nga hedhja e mbeturinave, ujërave të zeza, kimikateve bujqësore etj.
- Që të parandalojmë ndotjen e ujit, duhet t'i zvogëlojmë aktivitetet ndotëse dhe të bëjmë ngritjen e fabrikave të pastrimit të ujit.

Pyetje

1. Për çfarë e përdorim ujin?
2. Identifikoj shkaktarët e ndotjes së ujit.
3. Si duhet parandaluar ndotjen e ujit?

TOKA, MJEDISI DHE GJITHËSIA

73

Në fund theksohet:

Uji është i domosdoshëm për jetën e njeriut, bimëve dhe kafshëve. Pa ujë nuk ka jetë. Uji përdoret për pije dhe pastrim. Uji sot është shumë i ndotur, si rezultat i hedhjes së mbeturinave, shkarkimit të ujërave të zeza etj.



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
Kubimi

Shfaqet videoja para nxënësve, e cila tregon ndotësit e ujit dhe pasojat në shëndetin e njeriut, bimëve dhe kafshëve. Videoja gjendet në vegëzën: <https://www.youtube.com/watch?v=Om42Lppkd9w>.

Pas videos, formohen 5 grupe punuese. Kryesuesi i grupi hedh zarin, në faqet e të cilit janë shënuar kërkesat si më poshtë.

Grupi 1 – Përshkruaj ndotësit e ujit.

Grupi 2 - Krahaso. Ndotja e ujit me kë ngjason dhe ndryshimet.

Grupi 3 - Shoqëro. Çfarë të vjen në mendje?

Grupi 4 - Zbato. Përse shërben uji?

Grupi 5 - Argumento. Argumentojnë rëndësinë e ujit në jetën e njeriut.



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit
Stacioni i trenit

Në katër këndet (stacionet) e klasës, paraqitet puna e përfunduar në fleta A4. Grupet (treni) me radhë afrohen afër grupit 1, ku një përfaqësues nga ky grup prezanton punimin. Secili grup ka të drejtë të shtojë pyetje apo të shtojë ndonjë informacion tjetër shtesë për grupin 1 në këtë rast. Vazhdohet kështu derisa të prezantojë grupi i fundit (grupi 5).

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në punën grupore, përshkrimin e rëndësisë së ujit në jetën e njeriut, identifikimin e ndotësve të ujit dhe shpjegimin se si duhet parandaluar ndotja e tij.

Detyrë:

U përgjigjet tri pyetjeve të dhëna në libër.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës
Lënda: Njeriu dhe natyra
Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III
Tema: Bashkëveprimi i njeriut me natyrën

Rezultatet e të nxënësve të temës:
 Tregojnë për mënyrat e ndikimit të njeriut në natyrë (si të ruhet cilësia e ajrit, ujit dhe e tokës) dhe rëndësinë e ruajtjes së mjedisit (me figura, me shenja të informimit etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkollës: 1.8; II.2; III.4; IV.4; V.9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Toka dhe ndotja e saj

- Rezultatet e të nxënësve të orës mësimore:**
- Identifikon përbërësit e Tokës;
 - Shpjegon efektet e dëmshme të ndotjes së Tokës;
 - Formulon tri këshilla për mbrojtjen e Tokës.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shkathtësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS



Parashikimi:

Përgatitja për të nxënës

Alfabeti i njëpasnjëshëm në tryezë të rrumbullakët

Udhëzohen nxënësit për punën në grupe. Secilit grup punues i jepet një kopje e pashkruar e tabelës së alfabetit të njëpasnjëshëm të tryezës së rrumbullakët. U kërkohet që të japin një term që fillon me secilën shkronjë të alfabetit rreth temës TOKA. Nxiten nxënësit që të plotësohet sa më shumë kutia në tabelë. Pas përfundimit, grupet shkëmbejnë termat me gjithë klasën. Diskutohet për termat e shënuar në fleta.

BASHKËVEPRIMI I NJERIUT ME NATYRËN

4.8. TOKA DHE NDOTJA SAJ

Fjalët kyçe
 toka, ndotja, shpyllëzimi, erozioni, djegia, ndërtimet.

Pesticidët

Shpyllëzimet

Të mbajmë mend

• Ruajtja e mjedisit është përgjegjësi e secilit. Të gjithë ne duhet të kontribuojmë në ruajtjen e mjedisit të pastër. Duhet të kujdesemi në mënyrë që mjedisi të ruhet edhe për gjeneratat e ardhshme. Që ta mbajmë mjedisin e pastër dhe të shëndetshëm, ne duhet t'i mbrojmë burimet natyrore, si: ajrin, ujin, tokën, botën e gjallë, të mbjellim bimë dhe/ose të krijojmë një kopsht në oborrin e shtëpisë, shkollës etj.

Djegja e hamallive

Ndërtimet në tokat bujqësore

Pyetje

1. Përshkruaj rëndësinë e tokës si mjedis jetësor.
2. Identifiko aktivitetet më të shpeshta që ndikojnë në ndotjen dhe dëmtimin e tokës.
3. Shpjego efektet e dëmshme të djegjes së hamallive për botën e gjallë.

TOKA, MJEDISI DHE GJITHËSIA

74

4.8. TOKA DHE NDOTJA SAJ

Fjalët kyçe

toka, ndotja, shpyllëzimi, erozioni, djegia, ndërtimet.



Pesticidet



Shpyllëzimet

Toka është mjedisi në të cilin jetojnë shumë njerëz, bimë e kafshë. Ajo është pjesë shumë e rëndësishme e mjedisit tonë jetësor. Ne vazhdimisht e punojmë tokën dhe shkaktojmë ndotje. Aktivitetet më të shpeshta që ndikojnë në ndotjen dhe dëmtimin e tokës janë: përdorimi i plehrave kimike dhe kimikateve që vrasin dëmtuesit e kulturave bujqësore (pesticideve). Këto ndotin drejtpërdrejt tokën, por edhe ujërat përreth. Ndërsa, nga toka dhe uji ndotet edhe ushqimi që ne hamë dhe uji që pimë. Kjo ndotje pastaj dëmton shëndetin tonë.

Prerja e pyjeve (shpyllëzimi), përpos që ndikon në dëmtimin e botës së gjallë, pasi të largohen bimët, bën që toka të gërryhet (ndodh erozioni) dhe vërshtirë pastaj është të kthehet në gjendjen e mëparshme ku mund të rriten bimët.

Hedhja dhe djegia e mbeturinave ndot ajrin, tokën dhe ujin. Djegia e hamallive (mbetjet nga korret e dritërrave) vret shumë organizma shtazorë, siç janë: krimbat tokës, urithi, këlyshi i dheut etj., të cilët kanë rëndësi të madhe në përpunimin dhe ajrosjen e tokës etj.



Djegia e hamallive

Ndërtimet në tokat bujqësore e dëmtojnë tokën, sepse humbet toka pjellore nga e cila ushqehemi ne.



Ndërtimet në tokat bujqësore

Të mbajmë mend

• Ruajtja e mjedisit është përgjegjësi e secilit. Të gjithë ne duhet të kontribuojmë në ruajtjen e mjedisit të pastër. Duhet të kujdesemi në mënyrë që mjedisi të ruhet edhe për gjeneratat e ardhshme. Që ta mbajmë mjedisin e pastër dhe të shëndetshëm, ne duhet t'i mbrojmë burimet natyrore, si: ajrin, ujin, tokën, botën e gjallë, të mbylletim bimë dhe/ose të krijojmë një kopsh të obortit e shtëpisë, shkollës etj.

Pyetje

1. Përshkruaj rëndësinë e tokës si mjedis jetësor.
2. Identifikoj aktivitetet më të shpeshta që ndikojnë në ndotjen dhe dëmtimin e tokës.
3. Shpjego efektet e dëmshme të djegies së hamallive për botën e gjallë.

TOKA, MJEDISI DHE GJITHËSIA

A	B	C	Ç	D	Dh
E	Ë	F	G	Gj	H
I	J	K	L	Ll	M
N	Nj	O	P	Q	R
Rr	S	Sh	T	Th	U
V	X	Xh	Y	Z	Zh



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:
Përpunimi i përmbajtjes
D.L.T.A

Lexohet njësia mësimore me paragrafe: pas çdo paragrafi, shtrohen pyetje, si:

Paragrafi 1

- Çfarë është Toka?
- Cilët janë shkaktarët e ndotjes së saj?
- A mendoni ju që vetë njeriu ndikon në ndotjen e Tokës?

Paragrafi 2

- Çfarë ndodh pasi nga Toka i largojmë bimët?
- Nëse ka erozion, a mund të kthehet Toka në gjendjen e mëparshme? Pse?
- A mendoni që ka erozion në vendin tonë?

Paragrafi 3

- Cilët janë ndotësit e tokës, ujit dhe ajrit?
 - Si ndikojnë ndotësit e tokës te qeniet e gjalla?
- Vazhdohet diskutimi, duke sqaruar mendimet dhe pyetjet e shtruara.



Përforcimi:
Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënësve
Shkrim i lirë

Nxënësit shkruajnë tri këshilla për mbrojtjen e Tokës. Shkrimet lexohen dhe diskutohen e më pas vendosen në këndin e klasës.

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në veprimtari, në përgjigjet e dhëna, shpjegimin e ndikimit të ndotjes së Tokës në organizmin e njeriut.

Detyrë:

Tri pyetjet nga libri bazë.

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore:

ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës

Lënda: Njeriu dhe natyra

Shkalla e kurrikulës: 2 **Klasa:** III

Tema: Bashkëveprimi i njeriut me natyrën

Rezultatet e të nxënit të temës:

Tregon për mënyrat e ndikimit të njeriut në natyrë (si të ruhet cilësia e ajrit, ujit dhe e tokës) dhe rëndësinë e ruajtjes së mjedisit (me figura, me shenja të informimit etj.).

Kontributi në rezultatet për kompetencat kryesore të shkallës: 1.8; II.2; III.4; IV.4; V.9; VI.2.

Kontributi në rezultatet e fushës së kurrikulës: 1.6; 2.1.

ASPEKTE SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: Ndotja e tokës dhe e ujit - fletore pune

Rezultatet e të nxënit të orës mësimore:

- Identifikon ndotësit kryesorë të ujit dhe tokës;
- Përshkruan mjedisin pa ndotësit e tokës dhe ujit.

Kriteret e suksesit: Përcaktohen me nxënësit në klasë.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore: Fletë A4.

Lidhja me lëndët e tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situatat jetësore: Gjuhë amtare, Shkathësi për jetë, Arsimi për zhvillim të qëndrueshëm.

METODOLOGJIA DHE VEPRIMTARIA ME NXËNËS




Parashikimi:

Përgatitja për të nxënët

Loja e asociacionit

Nxënësit e klasës ndahen në dy grupe. U tregohen rregullat e lojës së asociacionit. Qëllimi i lojës është rikujtimi i njësive të mësuara më parë.

A	B	C	D
lëng	azoti	punohet	plastikë
i domosdoshëm	oksigjeni	mbrohet	letër
i pjishëm	dyoksid karboni	jetohet	qelq
burim i jetës	avuj	planet	metal
Uji	Ajri	Toka	Riciklim
Ndotësit			



4.6. NDOTJA E TOKËS DHE E UJIT

1. Plotëso fjalitë.

- a. Për ta parandaluar ndotjen e ujit, duhet të kemi kujdes që të mos _____ dhe _____ në ujë.
- b. Ndotja e ujit nga aktivitetet e njeriut ndikon edhe në _____ dhe _____.
- c. Nga prerja e pyjeve ndodh _____.
- d. Hedhja dhe djegia e mbeturinave ndot _____.
- e. Aktivitetet më të shpeshta që ndikojnë në ndotjen dhe dëmtimin e tokës janë: _____

2. Rretho përgjigjen e saktë.

Ndërtimet në tokat bujqësore:

e dëmtojnë tokën

nuk e dëmtojnë tokën

3. Rretho përgjigjen e saktë.

Djegia e hamulloreve:

e ndot tokën

e pastron tokën



Ndërtimi i njohurive dhe i shkathtësive:

Përpunimi i përmbajtjes

Pyetja sjell pyetjen

Udhëzohen nxënësit t'i hapin fletoret e punës. Lexohen dhe plotësohen ushtrimet e dhëna.

1. Plotëso fjalitë - nga njohuritë e marra nxënësit plotësojnë hapësirat e zbrazëta me fjalën e duhur për të plotësuar kuptimin e fjalisë.

2. Rretho përgjigjen e saktë.

Ndërtimet në toka bujqësore:

e dëmtojnë tokë _____ nuk e dëmtojnë tokën

3. Rretho përgjigjen e saktë.

Djegia e hamulloreve:

e ndot tokën _____ e pastron tokën

Gjatë punës, shtrohen pyetje të tjera rreth temës dhe diskutohen bashkë me nxënësit.

- Si mund të parandalohet ndotja e ujit dhe tokës?
- Pse e dëmtojnë tokën ndërtimet në tokat bujqësore?
- Cilët organizma shtazorë vret djegia e hamulloreve?



Përforcimi:

Konsolidimi dhe zbatimi i të nxënit

Ditari dypjesësh

Nxënësit vizatojnë dhe shkruajnë se si do të ishte toka pa ndotësit aktualë. Disa punime lexohen dhe të gjitha ekspozohen në klasë.

Vizatimi	Shkrimi

Vlerësimi i nxënësve:

Nxënësit vlerësohen për pjesëmarrje aktive në punë grupore, përgjigjet e sakta në libër, vizatimin e përshkrimin e mjedisit të pastër.

Detyrë:

Reflektim për rrjedhën e orës mësimore.

